

STUDIMI I GRAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS (2021/2022)

**NJOHURITË PËR SHOQËRINË, FAMILJEN,
VLERAT, ARSIMIN, PUNËSIMIN, POLITIKËN,
SIGURINË DHE KUJDESHIN SHËNDETËSOR**

Besa Luzha
Nora Jusufi
Luljeta Demolli
Judita Krasniqi-Hajdari
Rrezarta Delibashzade-Krasniqi
Bardha Qirezi
Diana Lekaj
Hana Xhemajli
Kathrin Rief

IMPRESUM

Publikuar nga: Zyra e Fondacionit Friedrich-Ebert - Prishtinë,
Pashko Vasa nr.23, Prishtinë, 10 000 Republika e Kosovës
+383 38 600 108; info@fes-kosovo.org
www.fes-kosovo.org

Personi Përgjegjës: Rene Schlee

Dizajni i hulumtimit dhe metodologjia: Zyra e Fondacionit Friedrich-Ebert - Shkup / Marija Topuzovska (Pyetësi i reviduar nga autorët dhe IDRA)

Hulumtimi në terren dhe analiza e të dhënave: IDRA Research and Consulting, Kosovë. <https://www.idracompany.com/>

Autorët:

Besa LUZHA
Luljeta DEMOLLI
Judita KRASNIQI-HAJDARI
Rezarta DELIBASHZADE
Bardha QIREZI
Diana LEKAJ
Hana XHEMAJLI

Editimi: Rozafa Jahaj dhe Besa Luzha
Lektorimi (Anglisht): Përkthimi: Ilir Jakupi, (Shqip) Ferid Teliqi
(Serbisht) Konsulente e hulumtimit: Nora Jusufi, IDRA

Paraqitja dhe dizajni: Milky Way Creative
Shtypur nga: Studio Forma
Data: Janar 2023

Përdorimi komercial i të gjitha publikimeve të Fondacionit Friedrich-Ebert (FES) nuk lejohet pa pëlqimin paraprak me shkrim nga FES.

Autori mban përgjegjësi të plotë për përmbajtjen e publikimit.
Opinionet e shprehura nuk janë domosdoshmërisht të Friedrich Ebert Stiftung.

PARATHËNIE	11
HYRJE	13
2. QASJA METODOLOGJIKE	15
2.1 TEKNIKAT E HULUMTIMIT	15
2.2 DIZAJNIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT DHE MBLEDHJA E TË DHËNAVE	16
2.3 ANALIZA E TË DHËNAVE	17
2.4 PROFILI I PJESËMARRËSEVE	17
3. VLERAT, FEJA, DHE BESIMI	21
3.1 VLERAT, QËNDRIMET PËR BARAZINË GJINORE, STEREOTIPET, DHE ROLET SHOQËRORE	21
VLERAT	22
QËNDRIMET PËR BARAZINË GJINORE	24
ROLET SHOQËRORE	26
3.2 KËNAQSHMËRIA DHE PAKËNAQSHMËRIA NË MESIN E GRAVE	28
3.3 BESIMI	29
3.4 RËNDËSIA DHE PRAKTIKIMI I FESË	32
KONKLUDIME	35
REKOMANDIME	37
FAMILJA DHE JETA SHOQËRORE	39
4. FAMILJA DHE MARTESA NË KONTEKSTIN E KOSOVËS	39
4.1 AKTIVITETET E GRAVE GJATË KOHËS SË LIRË	41
4.2 ORGANIZIMI I AMVISËRIVE DHE BARAZIA E PËRGJITHSHME E ROLEVE	44
4.3 GJETJA E PARTNERIT	53
4.4 GJENDJA E GRAVE GJATË COVID-19	53
4.5 KONKLUDIME	57
REKOMANDIME	59
ARSIMI DHE PUNËSIMI	61
5. QËNDRIMET PËR MJEDISIN E PUNËS	62
5.1 DISKRIMINIMI NË VENDIN E PUNËS	64
5.2 AVANCIMI NË POZITAT MENAXHERIALE	66
5.3 GRATË DHE QËNDRIMET PERSONALE PËR KARRIERËN	68
5.4 E PAPUNË DHE NË KËRKIM TË PUNËS	70
5.5 VETËPUNËSIMI	75
5.6 GJENDJA NË ARSIM	77
5.7 QËNDRIMET PËR ARSIMIN	77
5.8 ÇFARË NA MËSON SISTEMI ARSIMOR PËR ROLIN E GRAVE?	80
5.9 KONKLUDIME	86
REKOMANDIME	86

6.	POLITIKA DHE PJSËMARRJA	89
6.1	PERCEPTIMET PËR GJENDJEN AKTUALE TË BARAZISË SË GRAVE	89
6.2	INTERESIMI PËR POLITIKË DHE PJSËMARRJE POLITIKE	92
6.3	DEMOKRACIA, IDEOLOGJIA DHE VLERAT	99
6.4	PRITJET E ARDHSHME	102
	KONKLUDIME	104
	REKOMANDIME	105
7.	TË QENIT E SIGURT DHE SIGURIA	107
7.1	MBROJTJA FIZIKE DHE SIGURIA	111
	KONKLUDIME	114
	REKOMANDIME	115
8.	SHËNDETI DHE MIRËQENIA E GRAVE	117
8.1	ÇËSHTJET PERSONALE DHE SHËNDETËSORE	117
	ZBULIMI I HERSHËM I SËMUNDJEVE MALINJE	118
	SËMUNDJET KRONIKE	120
8.2	VARËSITË DHE STILET E JETËS	122
8.3	KUSHTET E JETESËS, FAKTORËT MJEDISORË DHE MIRËQENIA	124
8.4	KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMET SHËNDETËSORE	125
8.5	SHËNDETI MENDOR-PËRKUFIZIMI DHE STIGMA	127
8.6	COVID-19 DHE GRATË	128
	KONKLUDIME	129
	REKOMANDIME	130
	REFERENCA	131
	SHTOJCA – Demografia e pjesëmarrësit të Fokus grupit	134

Figura 1. Burimi i modelit vijues shpjegues	15
Figura 2. Pjesëmarrëset sipas rajoneve	17
Figura 3. Moshë	17
Figura 4. Përkatësia etnike	18
Figura 5. Niveli i arsimit	18
Figura 6. Gjendja Civile	18
Figura 7. Të kesh fëmijë	18
Figura 8. Sektori i punësimit	18
Figura 9. Punësimi	19
Figura 10. Prona	19
Figura 11. Jeton me...	19
Figura 12. Vlerat, më të rëndësishmet	22
Figura 13. Rëndësia e vlerave të mëposhtme në jetë për ato personalisht, sipas rajonit	23
Figura 14. Vlerat sipas moshës	24
Figura 15. Deklarata për barazinë gjinore	25
Figura 16. Deklaratat mbi barazinë gjinore sipas përkatësisë etnike	25
Figura 17. Pajtimet me deklaratat për rolet gjinore	26
Figura 18. Rolet gjinore sipas nivelit të arsimimit	26
Figura 19. Rolet gjinore sipas rajoneve	27
Figura 20. Rolet gjinore sipas grupmoshave	27
Figura 21. Kënaqshmëria dhe pakënaqshmëria	28
Figura 22. Kënaqëshmeria me...sipas rajonit	29
Figura 23. Kënaqëshmeria me...sipas rajonit	29
Figura 24. Kujt i besoni më shumë?	30
Figura 25. Besimi sipas rajoneve	30
Figura 26. Besimi sipas grupmoshave	31
Figura 27. Besimi sipas nivelit të arsimimit	31
Figura 28. Feja	32
Figura 29. Shpeshtësia e pjesëmarrjes në ceremonitë/ritualet fetare, përveç dasmave dhe funeraleve, sipas besimit fetar	32
Figura 30. Pranimi dhe përpjekja për të përmbushur kërkesën/pritjet nga feja nga grupet fetare	33
Figura 31. A jeni ndjerë ndonjëherë të diskriminuar në shoqërinë kosovare për shkak të fesë suaj?	33
Figura 32. Vendet ku jeni ndjerë të diskriminuar...	33
Figura 33. Pronësia	41
Figura 34. Aktivitetet e grave gjatë kohës së lirë	41
Figura 35. Aktivitetet e grave sipas grupmoshave	42
Figura 36. Koha e lirë sipas statusit të amësisë	43
Figura 37. Aktivitetet e grave sipas zonave urbane-rurale	43
Figura 38. Punët e shtëpisë (ndrysho vetëm ngjyrën)?	45
Figura 39. Punët e shtëpisë	46
Figura 40. Statusi financiar i gruas kundrejt "fjalës së fundit" të burrit	47
Figura 41. Punësimi i partnerit	47
Figura 42. Fitimet e partnerit	47
Figura 43. Gjendja financiare	48
Figura 44. Si e menaxhojnë ato shtëpinë e tyre	48
Figura 45. Kush në familjen tuaj i kryen këto detyra?	49
Figura 46. Kush kujdeset për fëmijët	49
Figura 47. Dakordimi që ndarja e punëve të shtëpisë të jetë e drejtë	50
Figura 48. Dakordimi që ndarja e punëve të shtëpisë është e drejtë, sipas rajonit	50
Figura 49. Puna e burrit/partnerit tuaj ndonjëherë ia kufizon kohën që ai kalon me familjen dhe miqtë	51

Figura 50. Koha për të zhvilluar interesimet e tyre, për t'u relaksuar dhe shoqëruar	51
Figura 51. Sa shpesh burri/partneri i juaj ka kohë për ju? Sipas punës së bashkëshortit/partnerit	51
Figura 52. Shkalla e barazisë gjinore në marrëdhëniet lidhje	52
Figura 53. Çështjet e përballje, diskutim? argumentimit midis bashkëshortëve/partnerëve	52
Figura 54. Gjetja e një partneri	53
Figura 55. Sfidat gjatë krizës me COVID-19	54
Figura 56. Sfidat gjatë krizës me COVID-19, sipas rajonit	55
Figura 57. Punësimi	61
Figura 58. Dakordimi me deklaratat në lidhje me vendin e punës	62
Figura 59. Kënaqshmëria me pagën	63
Figura 60. Kënaqshmëria me pagën, sipas rajonit	63
Figura 61. Qëndrimet ndaj punësimit	64
Figura 62. Diskriminimi në vendin e punës	64
Figura 63. Raportimet e përvojës së me diskriminimint	65
Figura 64. Raportimi i diskriminimit	66
Figura 65. Gatishmëria për të avancuar në pozita drejtuese	66
Figura 66. Arsyet për të mos marrë pozita drejtuese	67
Figura 67. Interesimi për t'u bërë menaxhere	67
Figura 68. Ndikimi i pushimit të lehonisë në pozitën drejtuese	68
Figura 69. Gatishmëria për arsimim të mëtejshëm	69
Figura 70. Planet e Karrierës	69
Figura 71. Gatishmëria për të sakrifikuar për avancimin në karrierë	70
Figura 72. Dakordimi me deklarata lidhur me gatishmërinë për arsimim të mëtejshëm	70
Figura 73. Niveli i proaktivitetit sipas moshës në zonat urbane	71
Figura 74. Niveli i proaktivitetit sipas moshës në zonat rurale	72
Figura 75. Vetë-perceptimi i proaktivitetit në kërkimin e punës	72
Figura 76. Gatishmëria për të investuar në arsimimin e mëtejshëm	73
Figura 77. Perceptimi për mundësitë e trajnimit	73
Figura 78. Burimet e përdorura për të gjetur një punë	74
Figura 79. Faktorë të rëndësishëm në gjetjen e një pune	74
Figura 80. Sektori me i përshtatshëm për punësim	75
Figura 81. Gatishmëria për të filluar një biznes sipas nivelit arsimor	75
Figura 82. Arsyet për të filluar një biznes	76
Figura 83. Financimi i biznesit tuaj	76
Figura 84. Pengesat për fillimin e një biznesi	77
Figura 85. Pikëpamjet mbi arsimin	77
Figura 86. Pikëpamjet arsimore sipas etnisë	78
Figura 87. Pikëpamjet për arsimin sipas vendbanimit	78
Figura 88. Pikëpamjet për arsimin sipas nivelit të arsimimit	79
Figura 89. Pikëpamje për arsimin sipas gjendjes financiare	79
Figura 90. Rëndësia e arsimimit	80
Figura 91. Mesazhet e imponuara nga institucionet arsimore Friedman Mean Rank	81
Figura 92. Një grua duhet të martohet dhe të ketë fëmijë në vend të karrierës, sipas grupmoshës	81
Figura 93. Një grua duhet të martohet dhe të ketë fëmijë në vend të karrierës, sipas nivelit arsimor	82
Figura 94. Mesazhet dominuese sipas grupeve etnike	82
Figura 95. Një grua nuk duhet të ndryshojë partnerët ose të ketë shumë, sipas grupmoshës	83
Figura 96. Mesazhet dominuese sipas grupmoshës	83
Figura 97. Gruaja është ajo që duhet të kujdeset për shtëpinë dhe fëmijët, sipas grupmoshës	84
Figura 98. Një grua duhet të jetë pasive dhe e qetë, sipas grupmoshës	84
Figura 99. Një grua duhet të jetë pasive dhe e qetë, sipas përkatësisë etnike	84
Figura 100. Një grua nuk duhet të rrezikojë, sipas grupmoshës	85
Figura 101. Mesazhet e imponuara gjatë arsimimit formal	85
Figura 102. Anëtarësimi në organizata	90
Figura 103. Perceptimi për pikëpamjet e veta politike	90
Figura 104. Ku i shprehni më shpesh pikëpamjet tuaja politike?	91
Figura 105. Qëndrimet për gratë kundrejt performancës politike të burrave ndryshe	92
Figura 106. Pikëpamjet politike në krahasim me anëtarët e familjes	93

Figura 107. Interesat e grave të përfaqësuar në nivele të ndryshme	93
Figura 108. Qëndrimet për më shumë gra në pozita të larta	94
Figura 109. Nëse bëhem anëtare e partisë politike	94
Figura 110. Pjesëmarrja e grave ka ndikim pozitiv	95
Figura 111. Nëse bëhem anëtare e partisë politike, do ta bëj	95
Figura 112. Votimi në zgjedhjet e fundit parlamentare	95
Figura 113. A do të pranoni një pozitë politike?	95
Figura 114. A do të merrni pjesë në protestë për të treguar mospajtimin tuaj me disa politika të caktuara?	96
Figura 115. Pse gratë politike përfshihen në politikë...	96
Figura 116. Arsyet për të mos votuar	97
Figura 117. Mendimet për të drejtën e votës	98
Figura 118. Kur votoj në zgjedhje	98
Figura 119. Deklarata për pozitën politike për gratë	98
Figura 120. Burimet e informacionit për ngjarjet politike	99
Figura 121. Pikëpamjet politike në lidhje me ideologjinë	100
Figura 122. Pozicionimi ideologjik	100
Figura 123. Kënaqshmëria me demokracinë	101
Figura 124. Dakordimi me deklaratat në lidhje me çështjet politike	101
Figura 125. Mënyrat e angazhimit politik	102
Figura 126. Pozicioni i gruas në vend, në 10 vitet e ardhshme	102
Figura 127. Efektet e anëtarësimit të vendit në BE	103
Figura 128. Vlerat më të rëndësishme për shoqërinë	103
Figura 129. Kërcënimet më të mëdha të perceptuara për sigurinë	108
Figura 130. Dëshmitare ose e ballafaquar me një konflikt të armatosur	108
Figura 131. Kërcënimet më të mëdha të perceptuara për sigurinë/ Dëshmitare e konfliktit të armatosur sipas moshës	109
Figura 132. Vendet më të sigurta të perceptuara të sigurta	109
Figura 133. Vendet më të perceptuara të sigurta sipas rajonit	110
Figura 134. Cila nga situatat e mëposhtme mendoni se është një kërcënim/rrezik potencial për sigurinë tuaj dhe në çfarë mase?	111
Figura 135. A është përpjekur dikush ndonjëherë t'ju lëndojë fizikisht?	111
Figura 136. Si është përpjekur ai/ajo t'ju lëndojë?	112
Figura 137. A keni frikë se dikush mund t'ju lëndojë?	112
Figura 138. A do të ndiheshit më të sigurt nëse gratë do të vendoseshin në pozicione vendimtare që lidhen me sigurinë e vendit (mbrojtja, ushtria, policia, CMC, etj.)	113
Figura 139. A do të ndiheshit më të sigurt nëse gratë do të vendoseshin..., sipas grupmoshës	114
Figura 140. Në përgjithësi, si do ta vlerësonit shëndetin tuaj/ sipas grupmoshave	118
Figura 141. A dini si të vetëkontrolloni gjinjtë tuaj?	119
Figura 142. Informacion në lidhje me zbulimin e hershëm të sëmundjeve malinje	119
Figura 143. Informacion rreth zbulimit të hershëm...sipas rajonit	120
Figura 144. Sëmundjet kronike	121
Figura 145. Numri i vakteve me perime...	122
Figura 146. Periudhat e ushtrimeve sipas moshës	122
Figura 147. Numri i pijeve me kafeinë	122
Figura 148. Lloji i ushtrimeve	123
Figura 149. Indeksi i perceptuar i masës	123
Figura 150. Indeksi i masës trupore sipas grupmoshës	124
Figura 151. Kushtet e jetesës	124
Figura 152. Ndotja sipas rajonit	125
Figura 153. Ndotja sipas përkatësisë etnike	125
Figura 154. Kënaqshmëria me shërbimet shëndetësore sipas rajoneve	126
Figura 155. Të kënaqur me shërbimet specifike shëndetësore sipas rajonit	126
Figura 156. Shëndeti mendor dhe problemet emocionale	127
Figura 157. Përdorimi i mjekësisë alternative	128
Figura 158. Gratë e vaksinuara	128
Figura 159. Niveli i njohurive në lidhje me masat mbrojtëse kundër Covid-19	128
Figura 160. Situata e shmangies së infektimit me Covid-19	129

PARATHËNIE

Në vitin 2020, Zyra e Fondacionit Friedrich Ebert në Maqedoninë e Veriut vendosi të kryejë një studim të grave, për të matur, përshkruar dhe shpjeguar statusin e grave karshi shoqërisë, familjes, vlerave, arsimit, punësimit, politikës, sigurisë dhe kujdesit shëndetësor. Sikurse në studimet e mëparshme të FES-it, siç është Studimi Gjithëpërfshirës i të Rinjve në të gjitha vendet e rajonit, zyrat e FES-it në vendet e tjera të Rajonit të Ballkanit Perëndimor do të kryejnë gjithashtu një studim të grave, në mënyrë që të jetë e mundur të analizohen dhe krahasohen rezultatet pasi të gjitha vendet të përfundojnë studimet e tyre kombëtare. Këto studime synojnë të sigurojnë të dhënat e nevojshme për të shërbyer si bazë për hartimin dhe zhvillimin e politikave dhe projekteve përkritazi me politikën e grave dhe barazinë gjinore.

Të dhënat e mbledhura në këtë hulumtim nuk janë paraqitur në tërësi në këtë publikim, por ato do të jenë në dispozicion të publikut. Studiuesit ose institucionet e interesuara mund të përdorin grupin tonë të të dhënave (Data Set) lirisht të disponueshme, për të kryer studime të tjera me një fokus specifik në një ose më shumë tema.

Ky studim ofron një pasqyrë dhe analizë gjithëpërfshirëse të të dhënave më relevante të mbledhura përmes një metodologjie të qartë, duke u fokusuar në çështjet më të rëndësishme që lidhen me situatën e grave në Kosovë.

Ky studim i grave paraqet një studim të plotë dhe të detajuar të perceptimeve, deklaratave dhe qëndrimeve të grave në shumë fusha të interesit dhe është i hapur për interpretime dhe analiza të mëtejshme. Dëshira e jonë është që rezultatet e studimit të merren parasysh nga institucionet përkatëse në Kosovë, në mënyrë që të punojmë së bashku për të arritur një nivel më të madh të barazisë gjinore dhe një jetë më të mirë për gratë dhe familjet në Kosovë.

Studimi e konfirmon atë që po ndodh në Kosovë, e kjo është një shoqëri e ndarë kryesisht sipas gjinisë, bazuar në norma patriarkale, shpesh të pranuar nga vetë gratë.

Për nga aspekti personal gratë vlerësojnë më shumë familjen dhe fëmijët dhe nuk e kanë problem të i bëjnë pothuajse të gjitha punët e shtëpisë, për aq sa burri fiton më shumë. Ato madje pajtohen se pjesa aktuale e angazhimit të tyre paraqet një ndarje mjaft të drejtë të roleve brenda familjes. Gratë më të reja nuk pajtohen me këtë, dhe rezultatet tregojnë se ato po sillen në mënyrë më progresive në këtë drejtim, duke i përfshirë partnerët e tyre më shumë

në ndarjen e përgjegjësi për familjen dhe fëmijët. Ato u besojnë anëtarëve të familjes dhe udhëheqësve fetarë më shumë se institucioneve, OJQ-ve dhe partive politike.

Vetëm pak gra kanë pronë të tyre (4%), ndërsa shumica e grave jetojnë me partnerin e vet dhe familjen e tij, në një gjendje financiare mjaft të dobët, ndërsa vetëm 4% e tyre e menaxhojnë buxhetin familjar. Kështu, ato shpesh janë të varura dhe nuk i njohin ose nuk i pranojnë stereotipet e diskriminimit gjinor dhe rolet e tyre në kontekstin familjar, si dhe nganjëherë në shoqëri dhe në vendin e tyre të punës. Vetëm 5% e tyre kanë deklaruar se ndihen të diskriminuara.

Pozita e tyre në tregun e punës vazhdon të jetë e pafavorshme, me vetëm 21% të grave të punësuar, dhe me më pak se 50% të grave që synojnë poste të larta drejtuese në vendin e tyre të punës. Ato e vlerësojnë arsimin si të rëndësishëm, por u mungon çdo arsim joformal që mund të rrisë gjasat e tyre për punësim.

Me më së paku vlerë për to është angazhimi politik, dhe ndonëse marrin pjesë në votim, ato megjithatë nuk janë të bindura se mendimi dhe kontributi i tyre do të pranohet, kështu që atyre nuk u duket interesante që të jenë aktive në parti politike ose në format e tjera të aktivizmit politik. Për sa i përket zhvillimeve politike, ato informohen kryesisht përmes mediave, por këtyre të fundit nuk u besojnë.

Shumë rezultate të tjera interesante janë dhënë në çdo kapitull, falë kontributit të secilit autor, të gjithë specialistëve të fushës, të cilët i analizuan dhe i interpretuan të dhënat dhe pastaj i shkruan kapitujt specifikë.

Ne i jemi mirënjohës ekipit të IDRA Kosovë për mbledhjen e të dhënave në mënyrë profesionale dhe etike dhe për mbështetjen e tyre edhe në fazat e analizës dhe interpretimit, duke i ndihmuar autorët të qartësojnë ose të kryejnë analizën e kërkuar shtesë.

Një kontribut të veçantë në finalizimin e raportit me një punë profesionale e ka dhënë praktikantja e jonë Kathrin Rief, e cila e kontrolloi çdo faqe, grafik dhe tabelë për të siguruar që çdo kapitull të paraqitet në mënyrë të drejtë dhe të saktë në raportin përfundimtar.

Ed.D Besa Luzha, Koordinatore e Programit të FES-it, janar 2023

HYRJE

Për shumë vite me radhë, gratë kanë luftuar kundër zbrazëtirave dhe pengesave mbizotëruese gjinore në sektorë të ndryshëm të jetës: në shtëpi, në vendin e tyre të punës dhe veçanërisht në pozitat udhëheqëse dhe vendimmarrëse. Barazia gjinore, jo vetëm që është një e drejtë themelore e njeriut, por është gjithashtu thelbësore për të pasur një botë paqësore, të përparuar dhe të qëndrueshme. Duhet të ketë qasje të barabartë në burime, mundësi dhe mbrojtje, si dhe përfaqësim të barabartë, pjesëmarrje në politikë dhe vendimmarrje, pavarësisht nga gjinia. Në vitet e kaluara, ka patur përparim në fushën e barazisë gjinore. Një numër më i madh i vajzave po vijonin shkollimin, numri i martesave të hershme të vajzave po zvoglohet dhe reformat e ligjeve të barazisë gjinore e kanë përmirësuar efektivitetin e tyre.

Megjithatë, ka ende shumë sfida në lidhje me ligjet diskriminuese dhe normat shoqërore; përfaqësimi i grave në lidershipin politik nuk është në nivel të kënaqshëm, krahasuar me burrat, ndërsa ka ende raste kur gratë raportojnë dhunën fizike ose seksuale të ushtruar nga partneri, tendencë kjo e cila veçanërisht ishte intensifikuar gjatë masave të mbylljes në të gjithë botën (OKB, 2022). Problemi kryesor është se gratë nuk janë të informuara për të drejtat e tyre. Në shumë shtete, shumica e grave nuk janë të vetëdijshme për të drejtat e tyre ligjore, ndërsa abuzimet e ndryshme, si dhuna në familje dhe diskriminimi në punësim, ndodhin çdo ditë. Për më tepër, raportimet për krimet e tilla janë të rralla. Kjo është kryesisht për shkak se në shumë vende ligjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore janë të kohës së fundit (UNICEF, 2020).

Pabarazia gjinore, shihet si nga vajzat ashtu edhe nga djemët në shtëpitë e tyre, në shkolla dhe në komunitetet e tyre. Në shumicën e familjeve, ka përgjegjësi të pabarabartë për punët e papaguara të shtëpisë, ku në shumicën e rasteve kjo barrë bie mbi gratë. Për vazhdimin e studimeve vajzat kanë më pak mbështetje sesa djemët, e kjo bën që vajzat pastaj të mbesin të pa punësuar, ose të bëjnë punë të thjeshta ose punë të papaguar. Ka një rritje në numër të vajzave që ndjekin dhe e përfundojnë shkollimin. Ka më pak raste të vajzave që martohen dhe bëhen nëna ndërsa vetë janë ende fëmijë. Gjithnjë e më shumë gra po e ngrejnë zërin kundër pabarazisë gjinore (UNICEF, 2020).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (e miratuar në vitin 2008) vë në dukje dokumentet e shumta detyruese kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore, konventa që ndalojnë diskriminimin gjinor, siç është Karta Sociale Evropiane e Këshillit të Evropës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron bazë ligjore për parimet e barazisë gjinore dhe e përcakton atë si e drejtë themelore kushtetuese. Sipas nenit 15 të Kushtetutës, “shteti duhet të garantojë barazinë midis grave dhe burrave dhe të zhvillojë politika për mundësi të barabarta”.

Në vitin 2015, u miratua “Ligji për Barazi Gjinore”, duke u kërkuar të gjitha autoriteteve publike që të respektojnë parimet e barazisë gjinore. Për më tepër, Republika e Kosovës ka përmbushur njërin nga objektivat e përcaktuara në Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit - Rezolutën e SZhM, të nënshkruar nga Kuvendi i Kosovës, përkatësisht në “SZhM Veprimi III - Promovimi i Barazisë Gjinore dhe i Fuqizimit të Grave” (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2016). Megjithatë, në praktikë, gratë ende nuk e gëzojnë trajtimin e barabartë, siç është e përcaktuar me ligj.

Fondacioni Friedrich-Ebert (FES) – Zyra e Prishtinës, kontraktoi agjencinë IDRA Research and Consulting në Kosovë për të kryer një studim empirik mbarëkombëtar të grave në Kosovë. Studimi shqyrton literaturën mbi temat përkatëse dhe i identifikon në mënyrë specifike sfidat me të cilat përballen gratë në Kosovë brenda familjeve të tyre, mjedisit të punës dhe shoqërisë në përgjithësi.

Ky studim kërkimor ofron një pasqyrë dhe analizë gjithëpërfshirëse të të dhënave më relevante. Ky studim i grave është ndërdisiplinor dhe shpresojmë se do të përdoret për zhvillimin e politikave për barazinë gjinore në Republikën e Kosovës. Shoqëria kosovare ende konsiderohet patriarkale, me traditë si një vlerë shumë e rëndësishme; dhe duke pranuar mënyrën se si bëhen gjërat, veçanërisht në lidhje me punët e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijët dhe të moshuarit. Megjithatë, ndërgjegjësimi i grave është rritur për të luftuar për të drejtat e tyre dhe për më shumë barazi në familjet dhe rrethin e tyre ku jetojnë. Vlerat që gratë në Republikën e Kosovës i shohin më të

rëndësishme janë që të kenë familje dhe fëmijë, të martohen, të kenë shtëpi/pronë, të jetojnë në një vend të sigurt, të përparuar, të pavarura, duke jetuar një jetë si fetare dhe duke pasur një punë të sigurt. Ka një përparim në qëndrimet e grave në lidhje me perceptimin e roleve gjinore sociale në shoqëri.

Shumica e grave janë dakord se nuk duhet të ketë dallime midis gjinive; dhe kështu, përgjegjësitë nuk duhet të caktohen dhe të ketë dallime mes burrave dhe grave. Jeta familjare dhe shoqërore janë diskutuar brenda kontekstit kombëtar të Republikës së Kosovës. Kosova ende konsiderohet të ketë një shoqëri patriarkale të ngurtë, në të cilën për çështje të ndryshme burrat e kanë fjalën e fundit, si dhe kanë qasje në burime sociale dhe ekonomike. Gratë raportojnë se aktivitetet e tyre të kohës së lirë pothuajse gjithmonë ose shpesh përfshijnë kalimin e kohës me familjen. Për më tepër, gratë perceptuan një lidhje të dobët me COVID-19 në përgjithësi, që do të thotë se jo shumë prej tyre kanë hasur në probleme, sfida dhe rreziqe gjatë kohës së kësaj krize. Shumica e grave në këtë studim janë amvise dhe të punësuar. Midis deklaratave lidhur me mjedisin e punës, shumica patën qëndrime pozitive për besimin dhe respektin e ndërsjellë. Gratë raportuan se deri diku ishin të kënaqura me mundësitë për ngritje në detyrë në vendin e tyre të punës.

Është gjithashtu shumë e rëndësishme të theksohet se gratë nuk kanë hasur ndonjëherë në diskriminim, pasi 95% e tyre deklaruan se nuk janë ndjerë kurrë të diskriminuara në punë. Ato nuk kanë ambicie të larta për të filluar biznesin e tyre, duke vënë në dukje çështjet e mëposhtme, si: financimi, mungesa e burimeve, mungesa e masave pozitive, mungesa e grave në biznes, mungesa e përvojës, mungesa e njohjes me tregun dhe mundësitë në treg, mosgatishmëria për të marrë një rrezik të konsiderueshëm ndërmarrës, mungesa e përvojës së nevojshme për të drejtuar biznesin e vet, mungesa e aftësive të ndërmarrësisë dhe menaxhuese, njohuritë,

shkathtësitë, dhe aftësia për të drejtuar një biznes, dhe mungesa e mbështetjes nga burri dhe/ose familja e ngushtë. Gratë janë të vetëdijshme për vlerën që ka arsimi dhe besojnë se arsimi nuk duhet të varet nga gjinia. Mesazhet më dominuese të komunikuar nga institucionet arsimore përfshijnë, "një grua duhet të martohet dhe të ketë fëmijë, në vend të një karriere" dhe "një grua duhet të jetë e bukur dhe tërheqëse". Gratë në Republikën e Kosovës nuk janë të përfaqësuara në politikë në nivel të kënaqshëm, meqë vetëm 3% prej tyre deklaruan se janë aktive në politikë.

Edhe pse pjesëmarrja e grave në politikë është parakusht për barazi gjinore dhe demokraci të mirëfilltë, gjetjet nga ky hulumtim tregojnë se gratë nuk janë të angazhuara drejtpërdrejt në vendimmarrjen publike dhe zhvillimin e politikave. Pak prej të anketuarve respondenteve e dinë se çfarë po ndodh me barazinë e grave në rrafshin global, dhe vetëm deri diku dinë për platformën politike 50/50. Kur vlerësojnë performancën politike, shumica e grave pajtohen se gratë politikanë janë më të paragjykuara se burrat politikanë. Por, ato gjithashtu pajtohen se gratë politikanë janë më të zellshme, punëtore, të ndershme dhe më të guximshme sesa burrat politikanë.

Shumica e grave të anketuara deklaruan se kanë votuar, sepse mendojnë se ky është obligim i çdo qytetari, dhe është anonim. Sipas tyre, arsyeja kryesore pse ato votojnë në zgjedhje është për shkak të bindjeve të tyre personale politike dhe vlerave politike.

Përveç kësaj, gratë besojnë se pozita e tyre do të përmirësohet në 10 vitet e ardhshme, si dhe kur Kosova të anëtarësohet në BE. Efektet e anëtarësimit të Kosovës në BE do të ishin pozitive për ekonominë, barazinë gjinore si edhe sistemin politik.

2.

QASJA METODOLOGJIKE

2.1 TEKNIKAT E HULUMTIMIT

Ky studim përfshin metodat dhe teknikat e hulumtimit kuantitativ dhe kualitativ (dizajn i metodave të kombinuara), si dhe analizën e të dhënave primare dhe sekondare, më saktësisht, katër teknika hulumtuese janë përdorur për mbledhjen e të dhënave:

- Rishikimi i materialit
- Analiza e dokumenteve
- Hulumtimi (CAPI) përmes intervistimit ballë për ballë me ndihmën e kompjuterit duke e përdorur mostrën e përfaqësimit kombëtar (metoda kuantitative)
- Fokus grupe me diskutime gjysëm të strukturuar, duke përdorur mostrën e kuotave (metoda kualitative).

Figura 1:
Burimi i modelit vijues shpjegues



Burimi: (Creswell, 2009)

Të dyjat, pyetësi i hulumtimit CAPI dhe diskutimet e fokus grupeve përbëhen prej prej seksioneve tematike në vazhdim:

- TË DHËNAT DEMOGRAFIKE
- VLERAT, BESIMI, DHE FEJA
- FAMILJA DHE JETA SHOQËRORE
- ARSIMI DHE PUNËSIMI
- POLITIKA DHE PJESËMARRJA
- PARREZIKSHMËRIA DHE SIGURIA
- SHËNDETI I GRAVE

Diskutimet e Fokus grupit të gjysëm strukturuar bëhen me anë të dy pyetësorëve, të cilët dallojnë pak për nga niveli i tyre i abstraksionit. Të dy pyetësorët përfshijnë pyetje të tipit të hapur dhe nënpyetje të renditura sipas shtatë kapitujve tematik të pyetësit të hulumtimit CAPI.

Pyetësi nr. 1 përdoret për dy diskutimet e para të fokus grupeve, të zhvilluara me qytetareë femra, përbërja e fokus grupeve përputhet me një mostër përfaqësuese kombëtare. Ky pyetësor i parë synon të eksplorojë më tej përvojat dhe perceptimet individuale të grave, duke i përmbledhur gjetjet kuantitative me përshtypjet individuale. Pyetësi nr. 2 zbatohet për diskutimin e tretë të fokus grupit, duke përfshirë aktivistët e OSHC-ve dhe përfaqësuesit e OJQ-ve, si dhe diskutimin e katërt të Fokus grupit, të mbajtur me përfaqësuesit e institucioneve publike të nivelit qendror. Pyetësi i dytë synon të marrë perspektiva kontekstualizuese mbi gjendjen e grave në lidhje me të gjitha seksionet tematike të hulumtimit CAPI nga gratë eksperte, që punojnë në fushën e barazisë gjinore. Të gjitha diskutimet e grupeve të fokusit u mbajtën në internet përmes platformës ZOOM, me pjesëmarrëset e kyçura me audio dhe video.

2.2 DIZAJNIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT DHE MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Hulumtimi CAPI përmes sondazhit përdor metodën e mostrimit shumëfazor të grupimeve (cluster) me qëllim të gjenerimit të mostrës së kuotave të shtresëzuara në bazë të të dhënave zyrtare nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011¹ për veçoritë e

popullsisë, të publikuara në faqen e internetit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës të Republikës së Kosovës (ASK)². Popullsia e synuar përfshin gratë e moshës prej 18 deri 65+ vjeç të cilat në datën e regjistrimit kanë qenë me vendbanim në Kosovë.

MOSTRA E HULUMTIMIT

Rajoni	Grupmosha	Etnia	Niveli i arsimit	Statusi i punësimit
Vendbanimi	Besimet fetare		Statusi i marrëdhënies	Ka fëmijë
Sipas vendbanimit			Mosha	
Rural		637	18-24	209
Urban		363	25-34	191
Gjithsej		1000	35-44	183
			45-54	206
			55-64	107
			65+	104
			Total	1000

Regjistrimi i popullsisë i paraparë për vitin 2021 është shtyer për 2022. Prandaj, në kohën e mbledhjes të të dhënave, regjistrimi i 2011 mbetet si pike referimi.
regjistrimi 2011 _ (rks-gov.net)

Mostrimi shumëfazor i grupimeve përdor si njësi primare të marrjes së mostrave Zonat e Regjistrimit (ZR) gjatë Regjistrimit në vitin 2011, dhe prej aty zonat gjeografike ishin përcaktuar sipas qendrave të votimit. Numri i ZR-ve, të përzgjedhura rastësisht brenda secilit rajon statistikor (gjithsej shtatë në vend) është proporcional me numrin e amvisërive brenda atij rajoni dhe merr parasysh madhësinë totale të mostrës prej 100 ZR-ve. Për të arritur një mostër përfaqësuese, studimi më pas përdor një probabilitet të shtresëzuar me dy faza të metodologjisë së marrjes së mostrave të rastësishme sipas madhësisë (PPS).

Në këtë mënyrë, shtresëzimi i parë është sipas rajonit, si dhe për nga ndarja në mjedise urbane-rurale, i gjeneruar përmes algoritmit sistematik PSS. Shtresimi i dytë bëhet sipas numrit të amvisërive brenda shtresave, me qëllim përzgjedhjen e ZR-ve që mbulojnë 70-150 amvisëri në rrethet e komunave. Në fazën e dytë të marrjes së mostrave të grupimeve, anketuesi zgjedh njësitë e banimit sipas një procesi përzgjedhës të rastësishëm derisa të arrihet numri i caktuar i intervistave në qendrën e votimit. Në fazën e tretë të marrjes së mostrave në grupim, anëtarja femër, datëlindja e së cilës është më e afërt me datën e intervistës, zgjedhet të jetë respondente për këtë njësi banimi. Nëpërmjet kësaj metode, gjithsej N = 850 respondente

shqiptare u regjistruan për kërkimin në terren sipas CAPI gjatë periudhës 09 shkurt - 04 prill 2022.

Për të qenë në përputhje me kuotat etnike të përshkruara në vlerësimet e regjistrimit të vitit 2011, gratë rome, ashkalinje dhe egjiptiane (N= 50), si dhe gratë serbe të Kosovës (N = 100) u mbimostruan duke synuar ato ZR, të cilat regjistruan numrin më të madh të banorëve që i përkisnin përkatësisë etnike përkatëse. Më tej, peshat e pas-shtresimit u shtuan për të llogaritur një shpërndarje të grupmoshave të shpallur sipas regjistrimit.

Me një popullsi të vlerësuar prej 1,873,000 banorëve në dhjetë komunitat e Republikës së Kosovës, llogaritet një gabim marginal prej 3.1% duke pasur parasysh mostrën përfaqësuese prej N = 1000. Pyetësi u administrua në gjuhën shqipe dhe në atë serbe, për gratë serbe, duke përdorur teknologjinë elektronike të kapjes së të dhënave. Me ndihmën e pajisjeve mobile (tabletëve), regjistruarit nga IDRA Research and Consulting realizuan sondazhet CAPI ballë për ballë, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Koha mesatare për të përfunduar çdo sondazh ishte 90 minuta.

Për diskutimin gjysëm të strukturuar të fokus grupit, mostra përbëhet nga 27 banorë femra. Për dy fokus diskutimet e para, mostra përbëhet prej 6/7 qytetareve femra të moshës 18-55 vjeç, të cilat ishin përzgjedhur me të njëjtën metodë të mostrimit të grupimeve (multiclustër) dhe mostrimit sipas kuotave etnike me shtresim bazuar në të

¹ Kryerja e regjistrimit të popullsisë të planifikuar për vitin 2021 është shtyer për në fund të vitit 2022. Rrjedhimisht, në kohën e mbledhjes së të dhënave, vlerësimet e vitit 2011 përfaqësonin më të fundit.² Census 2011_ (rks-gov.net).

dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, të përdorura edhe për hulumtimin kuantitativ CAPI. Për Fokus grupin e tretë, mostra përbëhet nga 7 përfaqësues të OSHC-ve dhe OJQ-ve nga rajonet e ndryshme të Kosovës të cilat merren drejtpërdrejt me çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave. Për Fokus grupin e katërt, mostra përbëhet prej 7 përfaqësuesëve të institucioneve publike të cilët kanë njohuri mbi temën ose janë në pozita që lidhen me gjendjen e grave në Kosovë. Regjistruerit realizuan me sukses katër fokus diskutime gjysëm të strukturuar përmes platformës ZOOM, të cilat koincidojnë me kohën e hulumtimit kuantitativ.

2.3 ANALIZA E TË DHËNAVE


Studimi i Grave në Kosovë 2022, ka nxjerrë analiza të shumëfishta (ndër-)sektoriale nga të dhënat e mbledhura

gjatë sondazheve kualitative si dhe diskutimeve kualitative. Në vazhdim janë dhënë dimensionet që e karakterizojnë këtë studim hulumtues:

- Hulumtues
- Përkrahues
- Krahues
- Sqarues

Të dhënat kuantitative nga sondazhet CAPI janë analizuar në nivelet univariate, bivariate, dhe multivariate, duke i përdorur procedurat përkatëse statistikore (përkrahuese dhe të konkluzionit) në SPSS, të vizualizuara si imazhe, tabela, diagrame, dhe grafika, dhe të interpretuara lidhur me kontekstin specifik të vendit. Të dhënat kualitative të nxjerra nga diskutimet e fokus grupeve gjysëm të strukturuar janë anonimizuar, kontekstualizuar, dhe janë përfshirë si anekdota dhe citate.

Figura 2:
Pjesëmarrëset
sipas rajoneve



2.4 PROFILI I PJESËMARRËSEVE

Seksioni i parë i këtij raporti ofron informacion të detajuar për profilin e respondentit. Shumica e respondentëve i përkasin grupmoshës 18-54 vjeç (79%). Një numër domethënës i respondentëve janë me arsim të mesëm (36%), arsim fillor (27%), dhe me diplomë universitare rreth (rreth 18%). Shumica e respondentëve janë nga zonat mjediset rurale (64%). Lidhur me rajonin, shumica e tyre janë nga Prishtina (26%) dhe Prizreni (22%). Mostra përfshin 83% të shqiptarëve të Kosovës, ndërsa me 17% janë përfshirë grupet tjera etnike.

Mostra ka përfshirë këta pjesëmarrës: 21% grupmosha 18–24 vj, 19% grupmosha 25–34 vj, 18% grupmosha 35–44 vj, 21% grupmosha 45–54 vj, dhe një pjesëmarrje më të ulët me 11%, të grupmoshës 55–64 vj, dhe 10% të grupmoshës 65 vj, ose më shumë. Edhe pse mosha e respondentëve është e balancuar mirë, prapëseprapë shumica e respondentëve bien në kategorinë e grupmoshës 18-54 vjeç.

Figura 3:
Mosha




Figura 4:
Përkatësia etnike




Figura 5:
Niveli i arsimit




Figura 6:
Gjendja Civile




Figura 7:
Të kesh fëmijë




Figura 8:
Spektori i punësimit




Figura 9:
Punësimi




Figura 10:
Pronar i banesës/shtëpisë





Figura 11:
Jeton me...



3.

VLERAT, FEJA, DHE BESIMI

3.1 VLERAT, QËNDRIMET PËR BARAZINË GJINORE, STEREOTIPET, DHE ROLET SHOQËRORE

Barazia gjinore është një nga indikatorët më të rëndësishëm të nivelit të demokracisë dhe të zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë. Si e tillë, ajo mbetet çelësi për zhvillimin progresiv shoqëror. Sipas udhëzimeve të Fondacionit Friedrich Ebert për barazinë gjinore, theksohet se ato paraqesin një numër “parakushtesh për demokraci, zhvillim të qëndrueshëm, reduktim të varfërisë dhe ruajtje të paqes” (Friedrich Ebert Stiftung, 2021)

Stereotipet gjinore janë modele ose ide shoqërore dhe kulturore, të parakrijura në mentalitetin e shoqërisë ku gratë dhe burrat kanë caktuar role të kufizuara nga ide të ndërtuara shoqërore që bazohen dhe kufizohen nga gjinia e tyre ose roli gjinor i tyre. Këto stereotipe paraqesin një pengesë për arritjen e barazisë gjinore dhe ushqehen me diskriminimin gjinor dhe mund të pengojnë seriozisht zhvillimin e vajzave dhe djemve, grave dhe burrave, si dhe arsimin e tyre dhe mundësitë jetësore (Këshilli i Evropës, 2018). Ato janë gjithashtu rrënja dhe shkak i qëndrimeve, vlerave, normave dhe paragjytimeve, që justifikojnë marrëdhëniet e pushtetit midis grave dhe burrave, dhe qëndrimet seksiste që ndikojnë në gjendjen e grave në hapësirën private dhe publike. Qëndrimet stereotipike krijojnë pabarazi strukturore, që prekin gratë dhe vajzat në arsim dhe në të gjitha sferat e jetës, e deri te tregu i punës.

Për shkak të roleve të tilla gjinore të përcaktuara, vlera e grave gjithmonë lidhet me burrat në jetën e tyre (babai, vëllai, burri ose djali), ose zhvlerësohet nëse mungon ndonjëri prej burrave në ciklin e jetës (vajza pa baba, nëna pa bir, vëllai pa motër ose gruaja pa burrë). Ndërkohë, gratë shihen si figura të nënës, duke i vënë ato në role mbështetëse, ndërsa burrat konsiderohen si ofruesit e të ardhurave, duke mbajtur rolin e autoritetit qendror në familje dhe rrjedhimisht edhe në shoqëri. Përkufizimi i stereotipeve gjinore i dhënë nga Zyra e Komisionerit të Lartë të të Drejtave të Njeriut (OHROH) tregon shtrirjen e ndikimit të dëmshëm mbi gratë dhe vajzat që mund të shfaqen nëse stereotipet e tilla normalizohen dhe institucionalizohen:

“Një stereotip gjinor është një pikëpamje e përgjithësuar ose parakrijim për atributet ose karakteristikat, ose rolet që janë ose duhet të posedohen ose të kryhen nga gratë dhe burrat. Një stereotip gjinor është i dëmshëm kur kufizon aftësinë e grave dhe burrave për të zhvilluar aftësitë e tyre personale, për të ndjekur karrierën e tyre profesionale dhe/ose për të bërë zgjedhje për jetën e tyre. Pavarësisht nëse janë haptazi armiqësore si (“gratë janë të paarsyeshme”) ose në dukje dashamirëse (“gratë janë inkurajuese”), stereotipet e dëmshme i përjetësojnë pabarazitë. Për shembull, pikëpamja tradicionale për gratë si ofruese të kujdesit do të thotë se përgjegjësitë e kujdesit për fëmijët shpesh bien ekskluzivisht mbi gratë.” (Kombet e Bashkuara, 2020)

Historikisht, roli i gruas në familje është i lidhur me aftësinë e saj riprodhuese. Grave ju besohet që të rrisin fëmijët dhe për të kryer punët e shtëpisë. Nga ana tjetër, burrat janë përgjegjës për vendimet që merren brenda familjes, si dhe për gjenerimin e të ardhurave për të mbështetur familjet e tyre. Ka familje që kanë braktisur këto norma shoqërore, veçanërisht ato që jetojnë në qytete të Kosovës (UNICEF, 2017).

Normat dhe stereotipet e dëmshme shoqërore ndaj vajzave dhe grave duhet të zbuten, dhe një mënyrë për ta bërë këtë është përballja me to për të arritur ndryshime transformuese. Për më tepër, politikat miqësore ndaj familjes dhe ndërhyrjet për një prindërim pozitiv e përmirësojnë mirëqenien e fëmijëve dhe rrisin angazhimin e baballarëve në përgjegjësitë shtëpiake (UNICEF, 2020).

Normat dhe vlerat shoqërore, konsiderohen barriera kryesore për barazinë gjinore. Në shumë raste, normat shoqërore dhe kulturore nxisin sjellje që çojnë në pabarazi gjinore, ndërsa përqendrimet e pushtetit krijuan çekuilibra që kapen nga elitat patriarkale dominuese. Vlerat njerëzore përcaktohen si parime udhëheqëse në jetën e popujve. Normat patriarkale shpesh bëhen burim i dhunës gjinore (Kebingin & Riyanto, 2022).

Në këtë kapitull të studimit, analizohen dhe raportohen qëndrimet e grave të Kosovës për barazinë gjinore, stereotipet e bazuara në gjini, dhe rolet shoqërore, si dhe cilat vlera janë më të rëndësishme për ato personalisht dhe për shoqërinë në përgjithësi.

VLERAT


Vlerat dallojnë mes njerëzve në bazë të synimeve të tyre motivuese, si siguria, arritja, dhe faktorët tjerë. Prioritetet të cilat u atribohen vlerave të ndryshme nga individët, e reflektojnë personalitetin e tyre, përvojën, dhe kulturën e rrethit (Prince-Gibson & Schwartz, 1998). Rëndësia e vlerave të caktuara të jetës për popullatën e targetuar rangohet duke e përdorur shkallën e rëndësisë duke filluar prej 1 (aspak e rëndësishme) deri në 5 (shumë e rëndësishme).

Sipas analizave, për gratë e Kosovës është shumë e rëndësishme të kenë **një familje/fëmijë (74%)**, të **martohen (73%)**, të **posedojnë një shtëpi/pronë (69%)**, të **jetojnë në një vend të sigurt, të përparuar, (68%)**, të **jenë të pavarura (65%)**, të **jetojnë sipas rregullave fetare (61%)** dhe të **kenë një punë të sigurt (60%)**.

Vlerat tjera jetësore, të cilat janë me rëndësi për gratë, përfshijnë si, të jetë e arsimuar (56%), të duket bukur (54%), të jetë e pasur (54%), të ketë karrierë të sukseshme (50%), ta respektojë traditën (49%), të kënaqet me jetën dhe të argëtohet (49%), si dhe të kalojë kohë me shoqëri (45%). Vlerat, të cilat gratë i konsiderojnë më pak të rëndësishme në jetë, përfshijnë **aktivizmin qytetar (11%)** dhe **angazhimin politik (7%)**.

Figura 12:

Vlerat, më të rëndësishmet



(Croson & Gneezy, 2009) theksojnë se gratë janë të prirura të jenë më dashamirëse dhe se e kundërshtojnë rrezikun dhe konkurrencën, si dhe janë të hapura që të diskutojnë për ndjenjat e tyre, ndërsa burrat janë të prirur të jenë më kategorikë, të vlerësojnë pushtetin, hedonizmin, dhe arritjet (Marcinkowska, et al., 2014).

Pastaj, gratë kanë më shumë synime jetësore, por u kushtojnë më pak rëndësi synimeve të lidhura me pushtetin, dhe kur krahasohen me burrat, ato nuk janë të prirura të përfitojnë nga rasti për avancim profesional (Gino, Wilmuth, & Brooks, 2015).

Analiza e korrelacionit tregon se është një korrelacion statistikisht i rëndësishëm në përgjigjet e lidhura me arsimin, përkatësinë etnike, moshën, dhe vendbanimin (urban dhe rural) për këto vlera jetësore:

- Arsimi është proporcionalisht në korrelacion me kalimin e kohës me miq ($r=.110$), të jesh politikisht aktive ($r=.127$), pjesëmarrja në aktivitete/iniciativat qytetare ($r=.140$), të argëtohen në jetë ($r=.125$), të kenë një karrierë të sukseshme ($r=.362$), të jenë të pavarura ($r=.191$), të jenë të arsimuara, ($r=.342$), të duken bukur ($r=.193$), të kenë një punë të sigurtë ($r=.330$), dhe të


jenë të pasura ($r=.134$), statistikisht të rëndësishme me $p<0.01$;

- Arsimi është i lidhur në mënyrë të kundërt me të jetuari e një jete sipas rregullave fetare ($r=-.253$), duke e respektuar traditën ($r=-.289$), duke u martuar ($r=-.125$), dhe duke pasur fëmijë ($r=-.111$), statistikisht

e rëndësishme në $p<0.01$. Kjo tregon se me rritjen e nivelit të arsimit, gratë u japin përparësi vlerave që lidhen me jetën e tyre shoqërore, duke kaluar kohë me miqtë, duke qenë të suksesshme, të pavarura dhe të arsimuara, ndërsa kanë më pak gjasa të mendojnë për traditën, martesën ose fëmijët, si vlerat më të rëndësishme të jetës.

Figura 13:

Rëndësia e vlerave të mëposhtme në jetë për ato personalisht, sipas rajonit



Analiza bivariate e të dhënave mbi vlerat e jetës ka treguar një korrelacion statistikisht të rëndësishëm midis moshës dhe vlerave të mëposhtme jetësore:


Vlerat jetësore si: Të jetuarit sipas rregullave fetare ($r=.166$), duke e respektuar traditën ($r=.210$), duke u martuar ($r=.168$) dhe duke pasur fëmijë ($r=.176$), kanë treguar një korrelacion të rëndësishëm pozitiv, statistikisht të rëndësishëm në $p<0.01$;

Vlerat jetësore si: Kalimi i kohës me miqtë ($r=-.213$), duke u kënaqur dhe duke u argëtuar në jetë ($r=-.259$), duke qenë politikisht aktive ($r=-.231$), duke marrë pjesë në aktivitete civile ($r=-.248$), duke pasur një karrierë të suksesshme ($r=-.350$), duke qenë e pavarur ($r=-.146$), duke qenë e arsimuar ($r=-.260$), të jetë e bukur ($r=-.251$), duke

pasur një punë të sigurt ($r=-.273$), dhe të jetë e pasur ($r=-.183$), kanë treguar një korrelacion të kundërt me moshën, statistikisht të rëndësishme në $p<0.01$).

Vlerësimi i vlerave të jetës bazuar në grupmoshën, tregon se rëndësia e vlerave të caktuara jetësore rritet ose zvogëlohet sipas moshës. Këto analiza tregojnë se me rritjen e moshës, gratë kanë më shumë gjasa të marrin parasysh se tradita, martesë dhe fëmijët janë më të rëndësishëm, duke i dhënë më pak rëndësi vlerave të tjera të jetësore, siç janë dukja, puna e sigurt, të jesh politikisht aktive, apo edhe të kesh një jetë shoqërore aktive. Ndërkohë, sa më të reja të jenë gratë, vlerat jetësore, si të jesh e bukur, duke u kënaqur dhe duke u argëtuar në jetë, arsimi dhe kalimi i kohës me miqtë, janë më të rëndësishme.

Figura 14:
Vlerat sipas moshës



QËNDRIMET PËR BARAZINË GJINORE

Shkalla në të cilën gratë pajtohen me deklaratat për barazinë gjinore dhe çështjet tjera, është vlerësuar në një shkallë nga 1 (aspak nuk pajtohem) deri në 5 (pajtohem plotësisht). Gratë në Kosovë shfaqin një mbështetje të moderuar për barazinë gjinore. Analiza e të dhënave të mbledhura në nivelin e pajtimit me qëndrimet rreth barazisë gjinore, në një shkallë nga 1 (aspak nuk pajtohem) deri në 5 (pajtohem plotësisht) tregon se gratë në Kosovë janë të vetëdijshme dhe mbështetëse ndaj barazisë gjinore, megjithatë, ato janë gjithashtu të kënaqura me nivelin e barazisë gjinore të arritur deri më tani.


Shumica e grave (53%) nuk pajtohen me deklaratën se, "Gratë dhe burrat janë kaq të ndryshëm, sa që barazia është e pamundur të arrihet" dhe shumica e grave (56%) gjithashtu nuk pajtohen me deklaratën se "barazia gjinore kërcënon familjen tradicionale". Kjo tregon se më shumë se gjysma e respondenteve janë shumë të vetëdijshme se barazia gjinore nuk varet nga dallimet midis grave dhe burrave, e as familja tradicionale nuk është më e rëndësishme.

Përafërsisht 39% dhe 31% përqind e grave u përgjigjën në shkallën 3 dhe 4 të pajtimit me deklaratën, "barazia gjinore tashmë është arritur në një nivel të kënaqshëm". Ky është perceptimi i pjesëmarrëseve, pavarësisht studi-

meve dhe raporteve që argumentojnë se barazia gjinore në Kosovë është ende e ulët, kur flitet për zbatimin e saj në praktikë (OECD, 2021).

Prandaj, mbetet e paqartë se si gratë në Kosovë e kuptojnë barazinë gjinore. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 (Agjencia e Kosovës për Barazi Gjinore, 2020), përcakton barazinë gjinore si një e drejtë themelore dhe faktor i rëndësishëm për zhvillimin dhe stabilitetin ekonomik, si dhe një parim themelor kushtetues i cili duhet të jetë në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në të gjitha strukturat, institucionet, politikat, procedurat, programet dhe praktikat qeveritare, të agjencive, të shoqërisë civile, si dhe midis sektorit privat dhe publik dhe të komunitetit të donatorëve.

Figura 15:


Deklarata për barazinë gjinore

Analiza e mëtejshme e korrelacionit ka treguar se ekziston një korrelacion statistikisht i rëndësishëm midis **arsimit** dhe **moshës** dhe deklaratave mbi barazinë gjinore dhe të çështjeve të tjera:

- Deklarata, "gratë dhe burrat janë aq të ndryshëm nga njëri-tjetri, sa që barazia gjinore është e pamundur të arrihet" është në korrelacion të kundërt me arsimin ($r=-.189$) dhe në mënyrë proporcionale me moshën ($r=.167$, statistikisht e rëndësishme në $p<0.01$).
- Deklarata, "barazia gjinore tashmë është arritur në një shkallë të kënaqshme" është në korrelacion të kundërt me arsimin ($r=-.138$) dhe në mënyrë proporcionale lidhet me moshën ($r=.141$, e rëndësishme në $p<0.01$).
- Deklarata, "barazia gjinore kërcënon familjen tradicionale" është në korrelacion negativ me arsimin ($r=-.118$) dhe korrelacion proporcional me moshën ($r=.101$, statistikisht e rëndësishme në $p<0.01$).

Të dhënat tregojnë se gratë më në moshë pajtohen më shumë me këto deklaratë lidhur me qëndrimet ndaj barazisë gjinore, por sa më i lartë të jetë niveli i arsimit, aq më i ulët është pajtimi me këto qëndrime. Kështu, me rritjen e arsimit, gratë kanë më pak gjasa të besojnë se barazia gjinore është arritur në një nivel të kënaqshëm, ose se barazia gjinore nuk është e mundur për shkak të dallimeve midis grave dhe burrave, dhe ato aspak nuk pajtohen se barazia gjinore kërcënon familjen tradicionale. Ndërkohë të dhënat e mëtejshme tregojnë se ekziston një dallim i rëndësishëm midis nivelit të marrëveshjes për qëndrimet e barazisë gjinore, midis grave që jetojnë në zonat urbane dhe në ato rurale. Shkalla në të cilën gratë pajtohen me deklaratat për barazinë gjinore dhe çështjet tjera, është vlerësuar në një shkallë nga 1 (aspak nuk pajtohem) deri në 5 (pajtohem plotësisht). **Gratë në Kosovë shfaqin mbështetje të moderuar për barazinë gjinore.**

Figura 16:

Deklaratat mbi barazinë gjinore sipas përkatësisë etnike

ROLET SHOQËRORE


Studimet e ndryshme të kryera nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë raportojnë për një ndarje të qartë të roleve gjinore në shoqëri, që fillojnë në familje dhe reflektohen pothuajse në të gjitha rrafshet e jetës. Studimi i Grave në Kosovë 2022, përdori Shkallën Likert për të matur perceptimet rreth roleve gjinore. Shtatë deklarata u përcaktuan për të matur nivelin e marrëveshjes dhe mosmarrëveshjes mbi ndarjet e rolit gjinor midis grave të cilat ishin respondentë. Sipas analizës, paradoksisht ekziston një pajtim i fuqishëm midis grave me deklaratën, “ne duhet të ndalojmë së menduari nëse njerëzit janë

meshkuj apo femra dhe të përqendrohemi në karakteristika të tjera” (42%) dhe “nënat duhet të marrin shumicën e vendimeve për mënyrën se si duhet rritur fëmijët” (39%) si dhe “përgjegjësia kryesore e një babai është të sigurojë financiarisht për fëmijët e tij”.

Më poshtë janë disa deklarata në lidhje me perceptimin e roleve gjinore sociale, duke përdorur një shkallë të përshtatur dhe të shkurtuar nga 1 (aspak nuk pajtohem) në 5 (pajtohem plotësisht), marrë nga një pyetësor i roleve shoqërore (Baber & Tucker, 2006), një model i përdorur në studimin e kryer në Maqedoninë e Veriut në vitin 2020.

Figure 17:

Pajtimet me deklaratat për rolet gjinore




Analiza e mëtejshme bivariate ka treguar korrelacion të rëndësishëm të kundërt midis arsimit dhe deklaratave të mëposhtme:

- Nënat duhet të marrin shumicën e vendimeve në lidhje me mënyrën se si duhet rritur fëmijët ($r = -.248$, $p < 0.01$)
- Nënat duhet të punojnë vetëm nëse është e nevojshme ($r = -.387$, $p < 0.01$)

- Përgjegjësia kryesore e babait është të sigurojë financiarisht për fëmijët e tij ($r = -.370$, $p < 0.01$)
- Disa lloje të punës nuk janë të përshtatshme për gratë ($r = -.278$, $p < 0.01$)
- Për shumë punë të rëndësishme, është më mirë të zgjidhni burra në vend të grave ($r = -.362$, $p < 0.01$)
- Përgjegjësitë në shtëpi nuk duhet të caktohen në bazë të gjinisë ($r = -.067$, $p < 0.01$).

Figura 18:


Rolet gjinore sipas nivelit të arsimit



Dallimet po ashtu vërehen edhe sipas rajoneve.

Figura 19:

Rolet gjinore sipas rajoneve




P4: Po, është një ndryshim i madh. Unë jetoj në qytet, por kam miq nga fshatrat dhe ata janë të habitur se si është e mundur që unë të dal lirshëm nga mëngjesi deri në mbrëmje, edhe pse jam nënë. Kjo është bërë e mundur falë mirëkuptimit që e kam me vjehrrit e mi.

Gjithashtu, jetesa në qytet ofron mundësi më të mëdha punësimi. Puna dhe fillimi i një familjeje është i mundur vetëm nëse keni mbështetjen e të gjithë anëtarëve të familjes, përndryshe është e vështirë.

Figura 20:

Rolet gjinore sipas grupmoshave



Analiza bivariate sipas moshës ka treguar korrelacion statistikisht të rëndësishëm midis moshave, me deklaratat e mëposhtme.

- Nënata duhet të marrin shumicën e vendimeve në lidhje me mënyrën se si duhet rritur fëmijët ($r = -.174$, $p < 0.01$)
- Nënata duhet të punojnë vetëm nëse është e nevojshme ($r = .319$, $p < 0.01$)
- "Përgjegjësia kryesore e

një babai është të sigurojë financiarisht për fëmijët e tij" (46%).267, $p < 0.01$)

- Disa lloje të punës nuk janë të përshtatshme për gratë ($r = -.221$, $p < 0.01$)
- Për shumë punë të rëndësishme, është më mirë të zgjedhësh burra në vend të grave.263, $p < 0.01$)


Në lidhje me deklaratat për rolet shoqërore dhe gjinore, të dhënat tregojnë se ekziston një shkallë në rritje e pajtimit sipas nivelit të arsimit, midis grave të moshës 18-34 vjeç, me deklarata që ato konsiderojnë se përfaqësojnë më pak ndarje të roleve gjinore (pajtueshmëria më e lartë është me deklaratën se karakteristikat gjinore duhet të eliminohen dhe mospajtueshmëria më e madhe është me deklaratën se nënat duhet të punojnë vetëm nëse është e nevojshme). Një dallim i vogël vërehet tek gratë e moshës 35-54 vjeç dhe gratë që janë 54 vjeç ose më shumë. Kjo tregon se sa më e re të jetë gruaja, aq më shumë ka gjasa që ajo të fuqizohet vetë.

3.2 KËNAQSHMËRIA DHE PAKËNAQSHMËRIA NË MESIN E GRAVE

Figura më poshtë tregon nivelin e kënaqshmërisë së grave ndaj çështjeve të ndryshme, sipas të dhënave të analizuara.

Shumica e grave janë të kënaqura ose shumë të kënaqura me jetën e tyre familjare (93%). Rezultatet tregojnë kënaqshmëri të lartë edhe për sa i përket jetës në përgjithësi (78%), jetës shoqërore (74%), dashurisë (68%) dhe vendit në të cilin jetojnë (68%). Kjo vazhdon me kënaqshmëri me gjendjen financiare (54%) dhe jetën/karrierën në punë (35%). Është e rëndësishme të tregohet se 40% e grave nuk iu përgjigjën deklaratës në lidhje me kënaqshmërinë me punën/karrierën në punë.

Rezultate të ngjashme për kënaqshmërinë mund të vërehen edhe në rajone të ndryshme. Kënaqshmëria më e madhe midis rajoneve është për jetën familjare, ndjekur nga kënaqshmëria me jetën shoqërore, jetën në përgjithësi dhe dashurinë. Gratë nga rajone të ndryshme janë mjaft të kënaqura me vendin ku jetojnë, me kënaqshmërinë më të lartë në Pejë ($m=4.4$) dhe kënaqshmërinë më të ulët në Ferizaj ($m=3.5$).




Sa i përket situatës financiare, niveli mesatar i kënaqshmërisë midis rajoneve është 3.6, që nuk është një nivel i kënaqshëm. Rajoni i Prishtinës është më i kënaquri ($m=4.0$), dhe Ferizaji ($m=3.2$) më pak i kënaqur. Niveli i kënaqshmërisë me gjendjen financiare tregon se në Prishtinë, kryeqytetin e Kosovës, ka më shumë mundësi pune, më shumë kujdes për fëmijët dhe institucione për t'u kujdesur për të moshuarit, gjë që u mundëson grave të punojnë. Rezultate të ngjashme janë arritur për kënaqshmërinë e jetës në punë/karrierë, me një mesatare prej 3.5 në të gjitha rajonet, kënaqshmëria më e lartë është në Prishtinë

($m=3.9$) dhe më e ulët në Prizren ($m=3.1$).

Analiza e mëtejshme tregon dallime të vogla midis grave në grupmosha të ndryshme. Gratë e moshës 18-54 vjeç janë më pak të kënaqura me vendin ku jetojnë ($m=3.9$), krahasuar me gratë e moshës 55 vjeç ose më shumë ($m=4.3$). Për jetën/karrierën e punës, ka një kënaqshmëri më të madhe midis grave të moshës 18-34 vjeç ($m=3.7$), krahasuar me ato 35-54 vjeç ($m=3.4$), ose 55 vjeç e më shumë ($m=3.3$).


Figura 22:
Kënaqëshmeria me...sipas rajonit



Analiza e korrelacionit ka treguar se ekziston një korrelacion statistiki i rëndësishëm (i kundërt) midis arsimit dhe nivelit të kënaqshmërisë me dashurinë ($r=-.116$, $p<0.01$), vendin ku jetoni ($r=-.195$, $p<0.01$) dhe jetën në përgjithësi ($r=-.112$, $p<0.01$) dhe një korrelacion proporcional midis

moshës dhe dashurisë dhe vendin ku jetoni dhe një korrelacion të kundërt me jetën shoqërore. Ndërkohë, të dhënat nuk tregojnë një ndryshim të rëndësishëm midis nivelit të kënaqshmërisë midis grave që jetojnë në zonat rurale dhe urbane.

Figura 23:
Kënaqëshmeria me...sipas grupmoshës



3.3 BESIMI

Besimi shoqëror lidhet me kapitalin shoqëror dhe shpesh i referohet marrëdhënies midis qytetarëve dhe institucioneve publike. Welch et al, 2005, besojnë se besimi shoqëror është një kërkesë për rendin shoqëror dhe për marrëdhëniet shoqërore:

ne besojmë se besimi shoqëror siguron kohezionin e nevojshëm për zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore


të kuptimplota, ne e trajtojmë besimin si pasqyrim të zemrës funksionale të një shoqërie të shëndetshme, ekonomisë dhe politikës demokratike. (Welch, et al., (2005), f. 454).

Të dhënat në këtë studim përfshijnë vlerësimet e grave për besimin në disa subjekte, në një shkallë nga 1 (asap nuk besoj), 5 (besim i plotë). Gratë në Kosovë e vendosin besimi

min e tyre më të madh tek anëtarët e ngushtë të familjes së tyre (98%), pasuar nga besimi tek anëtarët e familjes së gjerë (68%), udhëheqësit fetarë (58%) dhe miqtë (55%). Gratë treguan një nivel më të ulët besimi për njerëzit me besime të ndryshme fetare (37%), organet e administratës

shtetërore dhe institucionet shtetërore (35%), organizatat ndërkombëtare (29%), organizatat joqeveritare (29%), shokët e klasës, kolegët, bashkëpunëtorët (28%), njerëzit me preferenca tjera politike (26%), mediat (22%) dhe partitë politike (16%).


Figura 24:
Kujt i besoni më shumë?



Ka pak dallime midis grave në rajone të ndryshme në lidhje me besimin që kanë në subjektet e listuara. Besimi në anëtarët e ngushtë të familjes është i lartë në të gjitha rajonet, ku më i larti është në Pejë ($m=5.0$) dhe Gjakovë ($m=5.0$), ndërsa më i ulëti është në Ferizaj ($m=4.5$).

Besimi në miqtë është më i larti në rastin e Prishtinës (4.0) dhe më i ulëti në rastin e Ferizajt ($m=3.3$). Besimi në partitë politike nuk ishte në nivel të kënaqshëm, niveli më i ulët është në Gjakovë ($m=1.3$), pasuar nga Prizreni ($m=1.7$), Gjilani ($m=1.8$), Mitrovica ($m=2.0$), Ferizaj ($m=2.1$), Peja ($m=2.4$) dhe besimi më i lartë në Prishtinë ($m=2.9$).

Figura 25:
Besimi sipas rajoneve




Niveli i besimit në subjekte të ndryshme sipas grupmoshave është pothuajse i ngjashëm për të gjitha grupmoshat. Rezultatet janë të njëjta në të tri grupmoshat për besimin në anëtarët e ngushtë të familjes ($m=4.8$) dhe miqtë ($m=3.6$). Besimi në partitë politike është i ulët në të gjitha grupmoshat: për grupmoshën 54 vjeç i lartë, renditet në $m=2.3$, për grupmoshën 18-34 vjeç ($m=2.2$) dhe për grupmoshën 35-54 vjeç në ($m=2.1$). Besimi në organizatat ndërkombëtare është i ulët midis gjitha grupmoshave, më i ulëti në grupmoshën 35-54 vjeç ($m=2.8$), pasuar nga grupmosha 54 vjeç e më shumë ($m=2.9$) dhe

grupmosha 18-35 vjeç ($m=3.0$).

Analiza e mëtejshme bivariate tregon se ekziston një korrelacion i rëndësishëm midis moshës dhe besimit të grave në aspektet e mëposhtme: Besimi në familjen e ngushtë (anëtarët e ngushtë të familjes (nëna/ babai/motra/vëllai/ burri/partneri/ fëmijët); besimi tek udhëheqësit fetarë, organet dhe institucionet administrative shtetërore, dhe media, dhe një korrelacion i kundërt me organizatat ndërkombëtare.


Figura 26:

Besimi sipas grupmoshave

Është një korrelacion negativ i fuqishëm në mes të arsimit dhe besimit për aspektet në vazhdim: Familja e ngushtë,

udhëheqësit fetarë, organet e administratës shtetërore dhe institucionet shtetërore dhe media.

Figura 27:


Besimi sipas nivelit të arsimit

3.4 RËNDËSIA DHE PRAKTIKIMI I FESË

Ekziston një marrëdhënie komplekse midis fesë dhe barazisë gjinore. Feja gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në normat kulturore, shoqërore, ekonomike dhe politike, të cilat janë të rrënjësura në përvojat e njerëzve dhe ndikojnë në një masë të madhe në shoqëri. Institucionet fetare në mbarë botën priren të mbështesin dominimin patriarkal shoqëror brenda strukturave shoqërore. Statusi i grave në fe është më i komplikuar, zëri i tyre është më pak i dëgjuar për shkak të traditave patriarkale (Kombet e Bashkuara, p.d.).

Fetë anembanë botës e respektojnë rolin e grave në jetën familjare si nëna dhe gra, por megjithatë, ato nuk promovojnë emancipimin e grave në masën e kërkuar për barazi të plotë me burrat (Klingorová dhe Havlicek, 2015). Gratë e intervistuar në rajone të ndryshme janë kryesisht myslimane (88%), pasuar nga ortodokset (10%), katoliket (2%) dhe ateistet (0.3%).


Figura 28:
Feja



Kur u pyetën nëse ato marrin pjesë në ceremoni/rituale fetare të ndryshme përveç dasmave dhe varrimeve, shumica e tyre pothuajse kurrë nuk marrin pjesë (35%), ndërsa 38% e grave theksojnë se ato marrin pjesë vetëm për festa të caktuara fetare. Rezultatet e ngjashme janë gjithashtu

për shumicën e grave myslimane (39%) që u përgjigjën se ato pothuajse nuk marrin pjesë kurrë në ceremoni/rituale të tjera fetare dhe shkojnë vetëm për disa festa fetare (39%).

Figura 29:
Shpeshësia e pjesëmarrjes në ceremonitë/rituale fetare, përveç dasmave dhe funeraleve, sipas besimit fetar




Niveli i pranimit të grave dhe përpjekjeve të tyre për të përmbushur kërkesën/pritshmëritë e fesë është i ngjashëm midis feve të ndryshme. Mesatarisht, gratë myslimane (50%) dhe gratë ortodokse (47%) pranojnë dhe përpiqen të përmbushin kërkesat/pritjet nga feja. Një përqindje më e vogël e grave myslimane (23%) dhe e grave ortodokse (19%), pranojnë dhe përpiqen shumë për të përmbushur

këto kërkesa/pritje.

Krahasimi i dy pyetjeve zbulon se edhe pse ekziston një përqindje e lartë e grave myslimane (39%), të cilat pothuajse nuk marrin pjesë në ceremoni/rituale fetare, shumica e grave myslimane ende pranojnë dhe përpiqen të përmbushin kërkesat/pritjet e fesë.


Figura 30:

Pranimi dhe përpjekja për të përmbushur kërkesën/pritjet nga feja nga grupet fetare

Në i pyetëm gratë nëse janë ndjerë të diskriminuara nga shoqëria kosovare në bazë të fesë. Në rastin e grave muslimane, shumica e tyre nuk janë diskriminuar kurrë për shkak të fesë së tyre (93%).


Ndonëse, 37% e grave ortodokse ranë dakord se uk janë diskriminuar kurrë për shkak të fesë, 24% e grave ortodokse raportuan se janë diskriminuar shpesh dhe 24% të tjera thanë se janë diskriminuar të paktën një herë.

Figura 31:

A jeni ndjerë ndonjëherë të diskriminuar në shoqërinë kosovare për shkak të fesë suaj?

Lidhur me vendet ku ato ndiheshin më të diskriminuara, 76% e grave të anketuara raportuan se ishte në shoqëri, pasuar nga shkolla (12%), puna (5%) dhe të tjera (7%).

Figura 32:

Vendet ku jeni ndjerë të diskriminuar...

GJETJET NGA DISKUTIMET KUALITATIVE TË FOKUS GRUPIT

Siç u diskutua në metodologjinë e kërkimit, katër diskutime të grupeve të fokusit ishin gjithashtu për të kuptuar më thellë gjashtë modulet e sondazhit. Në të vërtetë, dy u mbajtën me gra të rastësishme nga rajone të ndryshme në Kosovë, të ndara në dy grupmosha të ndryshme, përkatësisht 18-35 vjeç dhe 36-55 vjeç. Një fokus grup u mbajt me përfaqësues të OSHC-ve që merren drejtpërdrejt ose tërthorazi me çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, dhe një tjetër u mbajt me përfaqësues të institucioneve publike të njohur me temën ose që janë në pozita që lidhen me temën.

Pjesëmarrëset iu përgjigjën pyetjeve në lidhje me vlerat, fenë dhe besimin e grave të moshës 18-35 vjeç që vinin nga rajone të ndryshme. Duke pasur parasysh se përqindja e banorëve fetarë është më e lartë në zonën e Prizrenit dhe Mitrovicës, besimi dhe feja janë shumë të rëndësishme. Disa pjesëmarrëse të tjera thanë se kjo është më pak e rëndësishme për brezat e rinj. Ritet fetare janë përgjithësisht të kufizuara në agjërimin e Ramazanit dhe shkuarjen në xhami për Bajram. Gratë raportuan gjithashtu se ato respektojnë fenë e shoqërisë dhe nuk mendojnë se ka diskriminim kundër atyre që nuk janë të të njëjtit besim. Gjetjet nga fokus grupi me përfaqësues të institucioneve publike, të njohur me temat ose në pozita që lidhen me temën, e ritheksuan perceptimin nga gratë që thonë se besimi dhe tradita janë faktorë shumë të rëndësishëm brenda shoqërisë së Republikës së Kosovës. Të tjerat pohuan se veçanërisht në vitet e fundit, ka patur një rritje të praktikuesve të fesë nga të rinjtë.

Sa i përket vlerave, disa gra besojnë se për shkak të mentalitetit, është më e rëndësishme të krijosh një familje sesa të punosh. Të tjerë theksuan se gratë duhet të punojnë dhe të krijojnë pavarësi financiare.

Në lidhje me shkallën e barazisë së grave, një pjesëmarrëse deklaroi se "Gruaja pritet të lajë, pastrojë, dhe të kujdeset për familjen. Përveç kësaj, gratë zakonisht nuk marrin pjesën e tyre nga trashëgimia, për shembull, një e anketuar tha: "Burri im më tha se nëse kërkoj pjesën time të trashëgimisë së familjes sime, ai nuk do të flasë më me mua".

Gratë besojnë se është e mundur të punosh dhe të krijosh një familje, me mbështetjen e anëtarëve të tjerë të familjes. Republika e Kosovës është ende një shoqëri patriarkale, por puna që po bëhet nga organizatat e ndryshme, të cilat synojnë të promovojnë barazinë gjinore, ka ndikuar shumë që situata në këtë drejtim të ndryshojë për të mirë.

Gratë theksojnë se barazia gjinore nuk është arritur në nivel të lartë dhe institucionet duhet të angazhohen më shumë për të luftuar pabarazinë. Një nga problemet kryesore, sipas tyre, vazhdon të jetë çështja e trashëgimisë së pronës, pasi aktualisht vetëm 17% e grave dhe vajzave trashëgojnë pronë. Një problem tjetër është mungesa e stimulimit financiar dhe mbështetjes për gratë. Gjithashtu, për shumë gra të papuna, një faktor kyç për të mos e ngritur çështjen e pabarazisë gjinore është mungesa e njohurive në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat konkrete që ato i kanë.

Më poshtë janë rezultatet e Fokus grupit nga përfaqësuesit e OSHC-ve që merren drejtpërdrejt ose tërthorazi me çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave. Një nga pjesëmarrësit deklaroi se gratë në Kosovë konsiderohen të suksesshme vetëm nëse martohen dhe lindin fëmijë. Kjo do të thotë se të kesh një punë është diçka e tepërt, por martesa është ajo që në shumicën e rasteve e karakterizon një grua si të suksesshme në sytë e komunitetit, dhe shoqërisë.

Ato identifikuan disa arsye si barra e kujdesit, diskriminimi i përgjithshëm, si dhe aksesit në tregun e punës. Meqenëse pushimi i lehonisë duhet të paguhet, punëdhënësi zgjedh burrin, edhe nëse gruaja është me të njëjtat kualifikime. Është me rëndësi thelbësore të shihen ndryshimet brenda shoqërisë, traditës dhe patriarkalitetit, në mënyrë që të nxitet punësimi, veçanërisht për të rinjtë. Ka paragjykime gjinore ndaj grave, veçanërisht ndaj nënave të divorcuara dhe beqare. Arritjet e tyre në karrierë do të shihen si një dështim, meqenëse shoqëria përqendrohet në atë se sa ato dalin dhe çfarë bëjnë. Në të kaluarën gratë kanë përjetuar paragjykime nga familja dhe miqtë bazuar në riprodhimin e tyre. Gratë shpesh janë divorcuar thjesht sepse nuk kanë qenë riprodhuese.

P6 F4: ...Mënyra e organizimit të familjeve dhe jeta familjare në Kosovë është reflektim i organizimit të përgjithshëm të shoqërisë. Nëse shohim prej perspektivës së roleve, 14% e grave janë të përqendruara në tregun e punës, dhe afërsisht 80% janë joaktive, ndërsa punësimi i burrave është shumë më i lartë. Prandaj, mendoj se kjo ndikon në marrëdhëniet familjare. Burri është ofruesi kryesor financiar në familje, kështu që ai vendos për çështjet financiare në familje. Sigurisht, ka anomali, pasi personalisht unë jam pjesë e 14% të grave që janë të punësuar, por është treguar se vendimet financiare merren nga ata që janë ofruesit kryesorë financiarë dhe zakonisht ata janë burrat. Ka studime, jo vetëm të MZHM (MCC), por edhe disa studime tona, që tregojnë se gratë janë më të përkushtuara dhe i kushtojnë më shumë vëmendje edukimit të fëmijëve, pasi kanë më shumë kohë të lirë – për sa i përket pagesës, siç tha P7. Por ato kanë më shumë kohë të lirë nëse nuk janë të punësuar, dhe kështu mbetet përgjegjësia e tyre për t'u kujdesur për rritjen e fëmijëve, edukimin, detyrat e shtëpisë. Si përfundim për të gjitha këto, organizimi i familjes është një reflektim i jetës shoqërore në përgjithësi në Kosovë.

P6F1: Unë mendoj se individit duhet të vendosë për veten e tij, pavarësisht nga feja, tradita, etj, që ajo do të fillojë një familje, të bëjë një karrierë, të bëjë të dyja ose asnjërën. Pra, është e drejta individuale e gjithsecilit të oriento-
het në jetë. Mendoj se është një shkallë dukshëm më e lartë e vajzave të arsimuara tani, në krahasim me periudhën e paraluftës, kështu që atyre u është dhënë një mundësi e barabartë për zhvillim.

P2: Unë mendoj se besimi është shumë i rëndësishëm. Sidomos këtu në Prizren, ku njerëzit janë shumë fetarë.

P5: Edhe në Mitrovicë njerëzit janë shumë fetarë, ka ankesa nga të huajt pasi që këtu gjatë muajit të Ramazanit alkooli nuk shërbehet në asnjë lokal.

Ndërsa tani ka një rënie në paragjyime të tilla, ka ende punë për t'u bërë në këtë drejtim.

P6 F2: Tradicionalisht në familjet tona ka një ndarje të tillë, që është disi "e natyrshme", sepse kjo është bërë nga familja. Pra, ne e dimë se një grua kujdeset për fëmijët, të moshuarit, punët e shtëpisë dhe ushqimin. Një ndarje e tillë mendoj se nuk duhet të ndodhë dhe deri në një masë kjo ka filluar të ndryshojë, por ende duhet shumë punë dhe kohë. Ndryshe nga e kaluara, kur gratë nuk punonin, por ishin plotësisht të angazhuara në punët e shtëpisë, sot gratë gjithashtu punojnë, por në të njëjtën kohë, ato kujdesen për të gjitha punët e mësipërme. Por diçka pozitive në këtë drejtim është se burrat tashmë kanë filluar të marrin më shumë përgjegjësi për punët e shtëpisë, që duhet të shihet si normale dhe jo si një ndihmë për gratë. Këto gjëra duhet të mësohen që në moshë të re, pra nga kopshti i fëmijëve.

P4F1: Po, për shembull nuk jam ndarë prej burrit nga mungesa e dashurisë. Unë jam e ndarë sepse familja e burrit tim nuk më lejonte të punoja, ata vendosën për mua. Unë nuk e pranoj këtë mentalitet. Edhe unë jam nga një fshat, por kam punuar më parë dhe kam mbështetur financiarisht familjen time. Unë nuk e mbarova fakultetin sepse fillova të punoja dhe kur u martova, ata më thanë se nusja e tyre nuk duhet të punonte. Mirëpo, ata i lejuan bijat e tyre të shkonin në fakultet. Pra, mentaliteti ndryshon nga familja në familje, jo vetëm nga fshati në qytet.

P6F1: Kam rastin e kundert. Kur fillova studimet, isha shumë e fokusuar, por më pas takova të dashurin tim, tani burrin tim, dhe mbeta shtatzënë. Për një periudhë të shkurtër pas lindjes, i ndërpreva studimet, por pas tre muajsh i vazhdova. Familja e bashkëshortit tim më mbështet shumë, ata kujdesen për vajzën time kur kam angazhime dhe nuk e kanë problem kur marr pjesë në trajnime të ndryshme, edhe pse jam nga një fshat i Gjilanit.

P3F1: Për një grua është shumë e rëndësishme të punojë, ajo duhet të ketë pavarësi financiare, duhet të ketë paratë e saj. Kjo e ndihmon dhe e plotëson një grua, kur ajo nuk varet nga anëtarët e familjes. "Mendoj se është shumë e rëndësishme për një grua të ketë punën e saj.

P2: Ka barazi, por jo dhe aq, ka akoma shumë dallime. Nga gruaja pritët që të lajë, të pastrojë, të kujdeset për familjen. Përveç kësaj, gratë zakonisht nuk marrin pjesën e tyre të trashëgimisë, për shembull, një e anketuar tha: "Burri im më tha se nëse kërkoj pjesën time të trashëgimisë së familjes, ai nuk do të flas më me mua".

KONKLUDIME

Ky kapitull diskutoi për qëndrimet ndaj barazisë gjinore, vlerave, kënaqshmërisë dhe pakënaqshmërisë së grave, besimit të tyre dhe rëndësisë/ praktikimit të fesë.

- Vlerat që gratë në Republikën e Kosovës konsiderojnë më të rëndësishmet janë të pasurit një familje/fëmijë, martesë, posedimi i një shtëpie/prone, jetesa në një vend të sigurt, të begatë, të qenit e pavarur, respektimi i fesë dhe të pasurit një punë të sigurt. Rezultatet e vlerave të jetës janë të ngjashme në bazë të rajonit. Për shkak të përbërjes etnike të Kosovës dhe pjesëmarrjes së pabarabartë të grave në bazë të përkatësisë etnike, analiza statistikore e grave në bazë të përkatësisë etnike në lidhje me vlerat e jetës nuk është kryer, veçanërisht për shkak të mostrës së ulët të grave nga komunitetet e tjera përveç komunitetit shqiptar dhe serb.

- Rëndësia e vlerave të veçanta në jetë ka treguar korrelacion të rëndësishëm (pozitiv) me vlerësimin e grave për të qenë politikisht aktive dhe për të marrë pjesë në aktivitete qytetare, për t'u argëtuar në jetë dhe për të shijuar kohën me miqtë, duke u arsimuar dhe duke pasur një punë të sigurt. Megjithatë në listën e përgjithshme këto vlera nuk janë më të vlerësuarat, numri i grave pjesëmarrëse në anketim bazuar në nivelin e arsimit gjithashtu nuk është proporcional me kategoritë e arsimit. Ndërkohë, të dhënat kanë treguar një korrelacion negativ midis arsimit dhe jetesës së një jete tradicionale dhe fetare, duke u martuar dhe duke pasur fëmijë, gjë që tregon se gratë më të arsimuara nuk i konsiderojnë këto vlera si më të rëndësishmet në jetën e tyre. Paralelisht, analiza e të dhënave ka treguar se gratë ndryshojnë qëndrimin e tyre ndaj vlerave të jetës,

sipas moshës që e kanë. Ndërsa gratë që janë të moshës 54+ vjeç dhe 25-35 vjeç, ende konsiderojnë se të kesh fëmijë dhe të martohesh janë vlerat më të rëndësishme të jetës, të dhënat tregojnë një korrelacion pozitiv me këto vlera, që do të thotë, se për gratë e moshuara këto vlera bëhen më të rëndësishme. Ndërkohë, me rritjen e moshës, kalimi i kohës me miqtë, shijimi i jetës, karrierës, pavarësisë, arsimit, pamjes, dhe aktivizmit politik janë gjithnjë e më pak të rëndësishme. Megjithatë, kjo gjithashtu tregon se gratë më të reja konsiderojnë se këto vlera janë të rëndësishme, ndërsa ndryshimi i intensitetit të ndërveprimeve dhe aktiviteteve për gratë në moshë më të madhe ndikon në dekurajimin e tyre dhe distancimin nga vlerat që i bëjnë ato të jenë më shumë pjesë e shoqërisë.

- Gratë në Republikën e Kosovës demonstrieran **mbështetje për barazinë gjinore vetëm deri në një masë**. Dakordimi më i lartë tregohet në deklaratën se barazia gjinore tashmë është arritur në një shkallë të kënaqshme. Nga ana tjetër, shumica e grave nuk pajtohen me deklaratën se gratë dhe burrat janë të ndryshëm, duke treguar një rritje të vetëdijes së grave se në të vërtetë ato duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.
- Veç kësaj, shumica e grave nuk pajtohen me deklaratën provokuese se barazia gjinore kërcënon familjet tradicionale. Analiza e të dhënave ka treguar se me rritjen e nivelit të arsimit, rritet edhe mospajtimi me deklaratat (duke pasur një korrelacion negativ midis arsimit dhe nivelit të marrëveshjes për deklaratat e barazisë gjinore), ndërsa korrelacioni midis moshës dhe nivelit të marrëveshjes është pozitiv, gjë që tregon se me rritjen e moshës rritet edhe marrëveshja me deklaratat për barazinë gjinore.
- Është e rëndësishme të vëzhgohet veçanërisht deklarata se “barazia gjinore kërcënon familjen tradicionale”, e cila tregon një përgjigje të dyfishtë, se familja tradicionale është e fortë dhe barazia gjinore nuk mund ta kërcënojë atë, si dhe nuanca e përgjigjes që barazia gjinore dhe familja tradicionale mund të bashkëjetojnë dhe se nuk paraqesin kërcënim për njëra tjetrën.
- Ka një përparim në qëndrimet e grave në lidhje me perceptimin e roleve gjinore shoqërore në shoqëri. Shumica e grave pajtohen se nuk duhet të ketë dallime midis gjinive dhe kështu, përgjegjësitë nuk duhet të caktohen ekskluzivisht dhe të diferencohen midis burrave dhe grave. Gjithashtu, ato duhet të punojnë jo vetëm kur është e nevojshme, por edhe për të përparuar në karrierën e tyre. Megjithatë, ende është një besim i fortë se gratë duhet të vendosin se si të rriten fëmijët; se disa punë duhet të merren vetëm nga gratë; se disa punë nuk janë të përshtatshme për gratë; dhe

është babai ai që duhet të jetë përgjegjës për stabilitetin financiar të fëmijëve.

- Kur krahasohen qëndrimet e grave mbi rolet gjinore shoqërore bazuar në rajon, gjetjet e hulumtimit tregojnë një balancë disi më të mirë të barazisë gjinore në rajonet e Prishtinës, Prizrenit, Mitrovicës, Ferizajt dhe Gjakovës krahasuar me Pejën dhe Gjilanin. Për më tepër, rezultatet tregojnë se gratë që janë më të arsimuara dhe ato më të reja mund të bëjnë gjykime më progresive mbi rolet gjinore shoqërore.
- Lidhur me nivelin e kënaqshmërisë për çështje të ndryshme, gratë shprehën kënaqshmëri më së shumti lidhur me jetën familjare, jetën në përgjithësi, jetën shoqërore, dashurinë dhe vendin ku jetojnë. Kënaqshmëri pak më e ulët raportohet në lidhje me situatën financiare të grave dhe karrierën. Rezultate të ngjashme për kënaqshmërinë me këto aspekte u vunë re në rajone të ndryshme. Vlera është më e lartë për gjendjen financiare në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë, pasi ka më shumë mundësi pune, institucione të përkujdesjes së fëmijëve dhe pleqve, të cilat u mundësojnë grave të punojnë. Gratë gjithashtu raportuan se besimin më të madh e kanë tek anëtarët e ngushtë të familjes dhe besimin e mëtejshëm tek anëtarët e zgjeruar të familjes, udhëheqësit fetarë dhe miqtë.
- Lidhur me partitë politike, besimi më i madh u raportua nga rajoni i Prishtinës. Analiza tregon se sa më të arsimuara janë gratë, ato janë më pak të kënaqura me konceptin e dashurisë në jetë dhe me vendin ku jetojnë, si dhe me jetën në përgjithësi, ndërsa gratë e moshuara janë më të kënaqura me konceptin e dashurisë në jetë dhe me vendin ku jetojnë, por më pak të kënaqura me jetën e tyre shoqërore.
- Në Republikën e Kosovës, shumica e njerëzve i përkaasin fesë myslimane. Po kështu, shumica e grave të intervistuar janë myslimane, ndërsa të tjerat përfshijnë pjesëtare të fesë katolike, ortodokse dhe ateistet.
- Gjetjet e hulumtimit tregojnë se gratë ortodokse praktikojnë fenë më shpesh se gratë myslimane, pasi marrin pjesë në ngjarje të tjera, përveç ceremonive/ritualeve fetare. Megjithatë, gratë myslimane pranojnë dhe përpikën të përmbushin kërkesat/pritjet në një nivel, edhe pse ato pothuajse kurrë nuk marrin pjesë në ngjarje të ndryshme fetare. Sa i përket ndjenjës së diskriminimit në bazë të besimit të tyre në shoqërinë kosovare, shumica e grave myslimane raportuan se nuk ishin diskriminuar, ndërsa disa gra ortodokse u shprehën të diskriminuara, veçanërisht nga shoqëria.
- Gjetjet nga fokus grupet tregojnë se për shkak të traditës, gratë në Republikën e Kosovës konsiderohen të

suksesshme nëse janë të martuara dhe kanë fëmijë. Edhe nëse kanë poste të larta në karrierën e tyre, ato nuk vlerësohen nëse janë beqare. Gjithashtu, pushimi i lehonisë duhet të paguhet nga punëdhënësi dhe për këtë arsye, punëdhënësit u japin përparësi kandidatëve burra, edhe në rastet kur kandidatët femra dhe kandidatët meshkuj janë me kualifikime të njëjta. Vlerësimi i të dhënave në vitin 2017, ka treguar se ekziston një hendek gjinor i pagesave në Kosovë, që do të thotë se gratë me arsim, prejardhje dhe kapacitete të njëjta paguheshin më pak se kolegët e tyre meshkuj. Ka paragjykime gjinore ndaj grave, veçanërisht ndaj nënave të divorcuara dhe beqare. Edhe nëse kanë poste të larta në karrierën e tyre, ato nuk vlerësohen nëse janë beqare. Gjithashtu, pushimi i lehonisë duhet të paguhet nga punëdhënësi

REKOMANDIME

- Një nga strategjitë kryesore për të gjithë aktorët relevantë duhet të jetë promovimi dhe praktikimi i roleve dhe përgjegjësi të barabarta midis vajzave dhe djemve, si dhe grave dhe burrave në familje dhe në gjithë shoqërinë;
- Për më tepër, akterët duhet të punojnë me prindërit dhe institucionet arsimore për të siguruar që fëmijët të kenë mundësi dhe zgjedhje të barabarta në nivel personal, si martesë dhe krijimi i familjes ose në rrafshin profesional, përmes ndjekjes së karrierave të ndryshme – si STEM ose shkencat shoqërore dhe pozitat udhëheqëse; Media në mënyrë specifike duhet të promovojë dhe praktikojë barazinë gjinore në mënyrë që të rrisë ndërgjegjen publike duke shqyrtuar në mënyrë kritike shembujt e stereotipeve gjinore dhe rolet gjinore.
- Ky studim ka treguar se ka stereotipe të forta gjinore që ekzistojnë në shoqëri, veçanërisht të pranishme në nivelin e ulët të arsimit dhe tek mosha më e vjetër. Prandaj, duhet të ndërmerren më shumë masa për të rritur nivelin e arsimit cilësor, veçanërisht në zonat rurale, dhe për të eliminuar të gjitha stereotipet gjinore nga tekstet shkollore.
- Shoqëria në përgjithësi duhet të përqendrohet në ndryshimin e përdorimit të gjuhës kur u dërgon mesazhe fëmijëve të vegjël, si bie fjala, sa të bukura janë vajzat ose sa të fortë janë djemtë, sepse këto mesazhe përjetësojnë dallimet në gjini që nga fëmijëria e hershme. Institucionet shtetërore duhet të formojnë një trekëndësh bashkëpunimi midis institucioneve, shkollave dhe prindërve, ku puna me prindërit është po aq e rëndësishme si puna me fëmijët dhe edukimi i tyre i duhur në kuptimin e barazisë gjinore.
- Për sa i përket mundësive të punësimit për pozita të ndryshme të punës, punëdhënësit duhet të përdorin gjuhë neutrale ndaj gjinisë, ose të përdorin emërtimet në numrin shumës për pozita që mund të konsiderohen tradicionalisht pozita mashkullore, si zyrtar policor, në vend të fjalës polic. Eliminimi i besimit në rolet gjinore lidhet gjithashtu me qëndrimin se “për disa pozicione është më mirë të punësohen burra sesa gra”, por gjithashtu të rëndësishme janë vlerat që gratë i konsiderojnë të jenë me rëndësi për jetën e tyre. Besimi i grave se vlera më e lartë për gratë është të kenë fëmijë dhe një familje, ndërsa pjesëmarrja dhe aktivizmi politik janë më pak prioritarë, është një tregues i nxitjes dhe promovimit të pamjaftueshëm të karrierës së suksesshme politike të grave në shoqëri, dhe që përqendrohet në natyrën e tyre të kujdesshme dhe emotive, në vend të fuqisë së vendimmarrjes.
- Agjencia për Barazi Gjinore duhet të ofrojë më shumë trajnime dhe programe për promovimin e barazisë gjinore, dhe të zbatojë procedurat e miratuara në rast të pabarazisë gjinore
- Gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë, të marginalizuara nga mitet dhe stereotipet tradicionale, të cilat bien ndesh me vlerat që promovon ligji dhe Kushtetuta e Kosovës. Prandaj, ky studim duhet të shërbejë veçanërisht si bazë për të identifikuar hendekun midis grave në zonat urbane dhe rurale, dhe për të hartuar politika specifike dhe të ndjeshme ndaj gjinisë në tregun e punës dhe politikat sociale.
- Organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare duhet të alokojnë më shumë fonde për fushatat e ndërgjegjësimit dhe aktivitetet që mbështesin gratë dhe promovojnë barazinë gjinore dhe duhet të përqendrohen më shumë drejt ndikimit të matshëm.
- Partitë politike duhet të promovojnë angazhimin e më shumë grave në të gjitha strukturat dhe nivelet e partisë, por edhe të promovojnë ndarjen e pushtetit me gratë.
- Partitë politike duhet të zbatojnë rreptësisht programet për të adresuar nevojat dhe shqetësimet e grave të Kosovës.
- Qeveria duhet të punojë ngushtë me OJQ-të në përpjekjet e tyre për të siguruar zbatimin e ligjeve ekzistuese që nxisin barazinë gjinore dhe ndryshojnë/amandamentojnë ato që bien ndesh me standardet ndërkombëtare për të drejtat e grave.

4.

FAMILJA DHE JETA SHOQËRORE

4.1 FAMILJA DHE MARTESA NË KONTEKSTIN E KOSOVËS

Familja është shumë e rëndësishme për qytetarët e Kosovës, pavarësisht përkatësisë etnike. Ajo shërben si një lloj rrjeti sigurie dhe shpesh si një “burim kryesor i solidaritetit të grupit dhe njësisë kryesore mbrojtëse dhe sulmuese, e organizuar në mënyrë rigoroze përgjatë linjave të korporatave dhe atyre patriarkale” (Duijzings, 2000, fq. 6). Studiuesit në kontekste të ndryshme kanë sugjeruar që grupet shoqërore të pafavorizuara, siç janë pakicat racore/etnike, mund të mbështeten në burime joformale të mbështetjes si, farefisi, sepse barrierat ekonomike dhe sociale e kufizojnë qasjen e tyre në burime më formale të ndihmës sociale (Landale, Orpesa, & Bradatan, 2006).

Shqiptarët e Kosovës tradicionalisht janë trajtuar si pakicë etnike në periudha të ndryshme nën regjime të ndryshme, dhe kjo është arsyeja pse familja ishte pothuajse një institucion dhe ndan elementet e “familjarizmit”, i cili përgjithësisht përdoret për të përshkruar rëndësinë e familjes në kontekstin e kulturës latine (Almeida, Molnar, Kawachi, & Subramanian, 2009). Ky koncept trajton interesat familjare që të kenë shumë më tepër rëndësi sesa interesat individuale. Kjo qasje transferohet edhe në nivele të tjera, me vlerat kolektive që janë më të rëndësishme se ato individuale.

Sociologu i famshëm Anthony Giddens (1997), sugjeron që familja duhet të analizohet në bazë të tre aspekteve kryesore: **farefisnisë, familjes dhe martesës**. Në Kosovë, familja tradicionale përbëhet nga prindërit dhe fëmijët, por edhe gjyshërit, dhe nganjëherë edhe tezet, axhallarët, apo edhe kushërinjtë janë pjesë e farefisnisë, që shpesh jetojnë së bashku. Zakonisht, burrat e familjes punonin jashtë shtëpisë dhe gratë e familjes kujdeseshin pothuajse për të gjitha punët e shtëpisë (fëmijët, ushqimi, mirëmbajtja, etj.). Gratë ndonjëherë u bashkoheshin burrave në punët e fushës, veçanërisht në zonat rurale.

Në të kaluarën, familjet shqiptare në Kosovë, ishin më shumë si një grup korporativ, ku vetëm burrat kishin të drejtë të sundojnë, dhe gratë të kujdesen dhe shërbejnë (Latifi, 2018, fq. 151).

“Gratë nuk konsideroheshin pjesë e grupit të korporatave dhe rrjedhimisht, ato nuk kishin të drejtë pronësie. Edhe tani, ka shumë pak raste kur ato kanë të drejta pronësore”.

Rëndësia e besueshmërisë dhe e imazhit të familjes është aq e lartë, sa që anëtarët janë të detyruar ose e ndiejnë një detyrim që të përpiqen t’u përmbahen dhe t’i mbrojnë, shpesh duke sakrifikuar dëshirat e tyre individuale.

.....një lidhje e fortë në familje ose në linjën e gjakut, mosbesimi ndaj atyre që nuk janë të afërm, një presion i fortë për të mbrojtur integritetin e familjes dhe për t’u hakmarrë për shkeljet mbi reputacionin e saj, një tendencë për të fshehur informacion ose për të ç’orientuar ose mashtruar të tjerët, që korrespondon me një pikëpamje instrumentale të marrëdhënieve jashtë familjes (po aty).

Familjet shqiptare janë shpesh të mëdha dhe **zakoni i të jetuarit së bashku** me prindërit (kryesisht të burrit) është ende gjerësisht i përhapur. Rezultatet nga Studimi i të Rinjve (FES, 2019), treguan se të rinjtë ende jetojnë në familje të mëdha, me 7 dhe më shumë anëtarë në një familje. Studimi argumentoi se “këto familje të zgjeruara janë faktori kryesor në transmetimin e vlerave të familjes nga gjenerata më e vjetër tek ato më të reja” (idem, fq.32). Në vitet e fundit, çiftet e reja po largohen nga familjet e mëdha dhe jetojnë vetëm me lidhjen më të afërt familjare (Prindërit+ Fëmijët) të ndikuar nga ofertat gjithnjë e më tërheqëse të industrisë së ndërtimit të apartamenteve të reja që mund të blihen me këste afatgjata në kombinim me kredi. Po bëhet gjithnjë e më e zakonshme në Kosovë që të dy prindërit të punojnë dhe në atë rast, gjyshërit që jetojnë në të njëjtën shtëpi ose në një shtëpi të veçantë, ende të kujdesen për fëmijët e çiftit, në mungesë të institucioneve të mjaftueshme të kujdesit për fëmijët (private ose publike).

Ka pasur 19,249 martesë sipas statistikave zyrtare në vitin 2021 (ASK, 2022), duke treguar pothuajse një trend pozitiv në rritje në baza vjetore që nga viti (2017), përveç në vitin 2020, ku është evidentuar një rënie, me 12,793 martesë të reja, shumë më pak se në vitet e mëparshme. Kjo mund të jetë ndikuar nga pandemia me COVID-19, duke parandaluar tubime të mëdha shoqërore, si pjesë e rritjeve të martesës në Kosovë. Në të njëjtën kohë, divorcet u rritën ndjeshëm në të njëjtën periudhë, nga 674 në 2017 deri në 1,987 në 2021.

Mosha mesatare e martesës për shtetasit e Kosovës është 29.7 vjeç (në përgjithësi), 31 vjeç për meshkujt dhe 28 vjeç për femrat (UNFPA, 2022). Kjo gamë e moshës konfirmohet edhe nga Studimi i të Rinjve nga FES-i që i pyeti të rinjtë në Kosovë se kur ata do të preferonin të martoheshin. Rezultatet e studimit tregojnë se: “Djemtë preferojnë një moshë më të ulët për martesë, si për meshkujt ashtu edhe për femrat. Vajzat preferojnë mesatarisht një moshë 26 vjeç për veten e tyre dhe 29 vjeç për martesën e meshkujve” (FES, 2019, fq. 37). Fenomeni i martesës së fëmijëve është relativisht i rrallë në Kosovë, por disa raste janë evidentuar në mesin e komuniteteve dhe/ose grupeve etnike, më së shumti, por jo ekskluzivisht, romët, ashkalinjtë, egjiptianët e Ballkanit dhe goranët. (UNFPA, 2022).

Fëmijët, siç pamë në kapitullin e vlerave, janë të rëndësishëm për gratë - vlera më e renditur lart në një nivel personal. Numri i fëmijëve të dëshiruar është ende i lartë dhe numri i fëmijëve të lindur, sipas statistikave zyrtare ka qenë në trend pozitiv çdo vitë, që nga viti 2017. 28,549 fëmijë kanë lindur në vitin 2022 (14, 36 djem dhe 13,713 vajza). Të rinjtë e anketuar në studimin e FES-it (2019), treguan se rreth 41% e të rinjve në Kosovë duan të kenë tre ose më shumë fëmijë.


Struktura e familjes në Kosovë po transformohet shumë më ngadalë se në vendet e tjera, kryesisht për shkak të rrethanave ekonomike të cilat kërkojnë që familjet të jetojnë së bashku në mungesë të politikave efektive të strehimit të përballeshëm. Një arsye tjetër për ndryshimin e ngadalë është roli i grave brenda familjes në lidhje me kujdesin e papaguar, p.sh., pastrimi, gatimi dhe kujdesi për fëmijët, të moshuarit, të sëmurët etj. Një ndryshim i mundshëm që mund të ndodhë përmes politikave shtetërore është krijimi i politikave miqësore për familjet, për shembull, lejimi i pushimit të barabartë prindëror, një koncept i propozuar nga organizatat e shoqërisë civile, në ndryshimet e neneve të pushimit të lehonisë në Ligjin e Punës (Rrjeti i Grave të Kosovës., 2022). Organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët besojnë se kjo do t'u mundësonte grave të jenë më aktive në tregun e punës. Megjithatë, ky proces i diskutimit ka vazhduar për shumë vite dhe ligji ende nuk është ndryshuar në mënyrë të duhur.

Në Kosovë, **banimi** dhe **prona** janë një e drejtë e rëndësishme individuale, dhe megjithëse shteti nuk ka rol në sigurimin e saj, legjislacioni mbron të drejtat pronësore të qytetarëve. Shteti shpesh planifikon të adresojë qytetarët e pafavorizuar me politikat e banimit social, të cilat janë ende duke u zhvilluar dhe monitoruar. Në mungesë të politikave dhe mekanizmave adekuat të banimit social, solidariteti i familjes dhe rrjetit social i adreson ato grupe më shpejt sesa institucionet shtetërore. Shumë aktivitete humanitare të organizuara vetë ose në grup i kanë pajisur njerëzit në nevojë me kushte të përshtatshme për jetesë.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se shumica e pjesëmarrësve në studim janë të **martuar** ose **jetojnë me një partner**, dhe vetëm 1% e tyre kanë deklaruar se janë të divorcuar. **66% e të anketuarave të studimit kanë fëmijë**, ndërsa 34% e tyre nuk kanë. **Shumica e grave kanë 3-4 fëmijë** (45%) dhe 1-2 fëmijë (41%), të ndjekur nga më shumë se 4 fëmijë në 14% të rasteve. Mosha e fëmijëve ndryshon, ku shumica i kanë më shumë se 23 vjet (43%), 4-12 vjeç (38%), 13-18 vjeç (27%), 19-22 vjeç (20%) dhe 0-3 vjeç (18%).

Kur gratë u pyetën se me kë jetojnë, shumica u përgjigjën se **jetojnë me një partner/bashkëshort** (61%), pasuar nga me fëmijë, më të vegjël se 24 vjeç (43%), me prindër (27%), me fëmijë, më të vjetër se 24 vjeç (20%), me të afërm të tjerë (17%) dhe vetëm 3% jetojnë vetëm.

Ndër gratë e intervistuar, pjesa më e madhe e tyre kanë treguar se pronare të shtëpisë kanë qenë gratë me prindërit e bashkëshortëve/partnerëve të tyre (43%), si dhe partneri/ bashkëshorti i tyre (43%), ndërsa vetëm 6% e tyre janë përgjigjur se apartamenti/shtëpia është në pronësi të grave dhe të bashkëshortëve të tyre, dhe vetëm 5% e tyre kanë në pronësi apartamentin / shtëpinë e tyre. Të dhënat tregojnë se pjesëmarrja e grave në pronësinë e pronës është shumë e ulët në Kosovë, me 15.2% krahasuar me burrat, që është 74.1%. Sidomos në zonat rurale, prona është regjistruar më së shumti në emër të bashkëshortit. Pavarësisht ligjit të trashëgimisë, i cili u jep të drejta të barabarta trashëgimie burrave dhe grave, ekzistenca e traditave diskriminuese dhe normave sociale e dëmtojnë këtë të drejtë, edhe më shumë në rastet e grave që jetojnë në zonat rurale.

Figura 33:
Pronësia

Pastaj, gratë shpesh nuk kanë qasje në udhëzime dhe informacion në lidhje me të drejtat e tyre. Kjo është një pengesë për gratë që të krijojnë një biznes ose të kenë qasje në fonde të jashtme (Banka Botërore, 2017). Shumë gra në Kosovë e shohin të turpshme të kërkojnë të drejtën e trashëgimisë së pronës në familjen e tyre. Në raste të rralla, kur gratë nuk heqin dorë nga të drejtat e tyre pronësore, ato detyrohen ose kërcënohen fizikisht (Kushi, 2015).

4.2 AKTIVITETET E GRAVE GJATË KOHËS SË LIRË

Është shumë e rëndësishme që të ketë një ekuilibër mes punës dhe jetës, në mënyrë që angazhimet familiare, koha e lirë dhe puna të mund të kombinojnë në mënyrë efektive. Studimet tregojnë se në të gjithë botën, meshkujt kanë më shumë kohë për aktivitete të lira. Vetëm në Holandë dhe Norvegji, gratë shpenzojnë më shumë kohë në aktivitete të lira dhe kujdes personal, krahasuar me burrat (OECD, 2020).



Figura 34:
Aktivitetet e grave gjatë kohës së lirë

Figura **lart** tregon se si gratë e kalojnë kohën e tyre. Shumica e tyre raportuan se ato gjithmonë ose shpesh kalojnë kohë **me familjen (84%)**, pasuar nga **biseda në telefon (69%)**, duke përdorur **mediat sociale (63%)** Viber, Facebook, Instagram, etj., si dhe **shikimin e filmave** dhe serialeve në TV ose në internet **(55%)**.

Aktivitetet tjera të preferuara përfshijnë dëgjimin e muzikës (47%), shoppingun (43%), kalimin e kohës me miqtë (41%), relaksim/pushimin (37%), shkuarjen në kafene, bare, restorante (35%), shikimin e programeve informative/arsimore (33%) dhe shfletimin/kërkimin në internet (32%). Gratë treguan se ishin më **pak në favor të leximit të librave (26%), punës krijuese (16%), studimit / edukimit/përmirësimit të vetes (14%), pjesëmarrjes në vende/ngjarje kulturore/argëtuese (10%), vullnetarizmit (9%), ngjarjeve sportive/rekreative (9%) dhe kalimit të kohës në organizatat ku ato janë anëtare (8%)**.

Analiza e korrelacionit bivariat, kundrejt moshës, tregon se aktivitetet e mëposhtme janë proporcionalisht të kundërta me moshën (dmth., bëhen më pak të popullarizuara me moshën): shkuarja në kafene, bare ($r = -.504$, $p < 0.01$); shikimi i filmave ($r = -.191$, $p < 0.01$); shikimi i programeve edukative ($r = -.182$, $p < 0.01$); dëgjimi i muzikës ($r = -.450$, $p < 0.01$); leximi i librave ($r = -.487$, $p < 0.01$); sport dhe rekreacion ($r = -.304$, $p < 0.01$); kalimi i kohës me miqtë ($r = -.380$, $p < 0.01$); shoppingu ($r = -.418$, $p < 0.01$); studimi/mësimi ($r = -.441$, $p < 0.01$); shkuarja në kafene ose bare ($r = -.504$, $p < 0.01$); punë krijuese ($r = -.241$, $p < 0.01$); shfletimi në internet ($r = -.477$, $p < 0.01$); përdorimi i mediave sociale ($r = -.357$, $p < 0.01$); shkuarja në vende/ngjarje kulturore dhe argëtuese ($r = -.310$, $p < 0.01$); anëtarësimi në organizata ($r = -.218$, $p < 0.01$); vullnetarizmi ($r = -.251$, $p < 0.01$); relaksim ($r = -.096$, $p < 0.01$).

Figura 35:
Aktivitetet e grave sipas grupmoshave




Analiza e të dhënave për atë se çfarë bëjnë gratë në kohën e tyre të lirë, bazuar në grupmoshat, thekson faktin se për pothuajse të gjitha pikat e listuara këtu, gratë më të reja kanë shënuar rezultate më të larta se gratë e moshuara. Vetëm në disa pika, gratë në grupmoshën 35-54 vjeç dhe 54 vjeç e më shumë kanë shënuar të njëjtën gjë, siç është rasti i bisedës në telefon, shikimi i filmave dhe serialeve në TV, relaksimi/pushimi dhe shikimi i emisioneve informative/edukative. Çuditërisht, vlera mesatare e të kaluarit kohë me familjen është dukshëm më e lartë për

grupmoshën 18-34 vjeç ($m=4.4$) dhe 35-54 vjeç ($m=4.4$) krahasuar me grupmoshën 54 apo me shumë ($m=4.1$).

Testet jo parametrike tregojnë se, për të gjitha aktivitetet, ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme ($p < 0.001$) sipas statusit të amësisë, me nënat që kanë të ngjarë të zgjedhin kohën me familjen mbi aktivitetet e tjera, krahasuar me jo-nënat, të cilat jo vetëm që favorizojnë kalimin e kohës me familjen, por gjithashtu angazhohen në një sërë aktivitete.


Figura 36:
Koha e lirë sipas statusit të amësisë



Testet jo parametrike regjistruan dallime statistikisht të rëndësishme ($p < 0.05$) midis zgjedhjes së aktivitetit të kohës së lirë dhe vendbanimit (urban/rural).

Gratë në zonat rurale kalojnë më shumë kohë duke folur në telefon, ndërsa gratë në zonat urbane angazhohen më shumë në aktivitete sportive ose kalojnë kohë në organizatat në të cilat ato janë anëtare.

Figura 37:
Aktivitetet e grave sipas zonave urbane-rurale



P4: Dihet që gratë zakonisht kanë më shumë përgjegjësi në familje. Një grua që punon, pas orarit të punës, vazhdon me punët e shtëpisë pas kthimit nga puna, sepse duhet të përgatisë ushqimin, të kujdeset për fëmijët e kështu me radhë, ndërsa zakonisht burrat nuk e ndejnë këtë përgjegjësi si gratë. Të jetosh me vjehërrit e bën çdo gjë më të lehtë, sepse në qoftë se ju keni një punë, ju keni dikë për t'u kujdesur për fëmijët. Por në përgjithësi, edhe nëse gruaja sjell të njëjtat të ardhura si burri, kjo nuk e zvogëlon përgjegjësinë që i bie asaj si grua.

P2: Familjet në zonat rurale karakterizohen më shumë nga papunësia e lartë, dhe kjo sjell me vete mundësi edhe më të kufizuara për arsimimin e hershëm të fëmijëve, gjë që vjen kryesisht për shkak të ideve patriarkale. Ndryshe nga gratë në zonat rurale, ato në zonat urbane kanë mundësi më të mëdha për monitorimin e tregut të punës dhe zhvillimin profesional.

P7: Ndoshta është e rëndësishme të përmendet edhe këtu, që shqetësimi ynë si organizata, është që punët e shtëpisë nuk njihen si punë. Për fat të keq, as nga familja, sepse konsiderohet se punët e shtëpisë u takojnë grave për shkak të gjinisë së tyre. As nga mekanizmat shtetërorë nuk konsiderohet punë, edhe pse kontribuon shumë në ekonomi. Është një informalitet shumë i madh dhe mendoj se është gjithashtu një problem shumë i madh, dhe një ndryshim të cilin unë mund ta artikuloj më lehtë, e ai është se gratë në zonat rurale kanë më pak qasje në jetën publike. Prandaj, mendoj se është shumë e rëndësishme se si organizohen mbledhjet e këshillave në fshatra dhe në qytete. Për shembull, në fshatin tim nuk ka anëtare gra në këshill, kështu që shumica e takimeve mbahen në mbrëmje, kur gratë përgatisin ushqim, dhe si rezultat është e pamundur që ato të kenë qasje në jetën publike ose të kenë një zë në vendimmarrje. Megjithatë, ka gra që udhëtojnë çdo ditë në Prishtinë dhe janë të punësuar aty, por shumica e tyre nuk kanë kontrata pune, pasi punojnë si shërbëtoreshë, kështu që pensionet dhe taksat e tyre nuk paguhen.

4.3 ORGANIZIMI I AMVISËRIVE DHE BARAZIA E PËRGJITHSHME E ROLEVE

Rolet gjinore janë thelbësore për të kuptuar përgjegjësitë e tyre në lidhje me punën dhe shtëpinë. Punët e shtëpisë janë akoma më të ngarkuara për gratë në krahasim me burrat, gjë që nxit konflikt midis tyre. Për më tepër, burrat nuk ndejnë detyrim të kontribuojnë në punët e shtëpisë po aq sa gratë, të cilat e perceptojnë atë si zgjedhje libre e tyre (Cerrato & Cifre, 2018). Duke pasur parasysh normat kulturore dhe besimet në lidhje me ndarjen e punës sipas gjinisë në Kosovë, gratë dhe burrat kalojnë kohën e tyre në mënyra të ndryshme, me rolet dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara fort nga modeli tradicional dhe patriarkal i familjes. Mesatarisht, gratë shpenzojnë 300% më shumë kohë në aktivitete të kujdesit sesa burrat. Këtu, aktivitetet e kujdesit përfshijnë përgjegjësitë e përcaktuara shoqërore produktive dhe riprodhuese brenda shtëpive që kontribuojnë në pjesëmarrjen e ulët të grave në fuqinë punëtore. Aktivitetet e kujdesit janë ndër arsyet kryesore për pasivitetin e grave në tregun e punës. Kjo përkeqësohet më tej nga mungesa e kopshteve për fëmijë që janë financiarisht të përballueshme (UNICEF, 2020).

Në Kosovë, ka rritje të cenueshmërisë ekonomike dhe pabarazisë gjinore për shkak të kërkesës së lartë të kohës për t'u kujdesur që gratë t'u përkushtohen anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe pleqve (Banka Botërore, 2017).

Arsimi parashkollor është niveli i parë i arsimit që përfshin fëmijët deri në gjashtë vjeç dhe ofrohet nga parashkollorët publikë, privatë dhe me bazë në komunitet. Megjithatë, nuk ka një nivel të kënaqshëm të regjistrimit të fëmijëve në arsimin parashkollor përkundër politikave të zbatuara arsimore në Kosovë. Rezultatet nga të dhënat e MASH-it tregojnë se vetëm 6% e fëmijëve të moshës 0-4 vjeç janë të regjistruar në arsimin parashkollor.

Nga ana tjetër, fëmijët e moshës 5-6 vjeç regjistrohen në klasat parafillore me një përqindje të lartë prej 92.4%. Për më tepër, sektori privat në arsimin parashkollor është zhvilluar kohët e fundit, aktualisht numëron 113 objekte parashkollore dhe me kapacitet për të akomoduar 6,500 fëmijë, gjysma e tyre të vendosur në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Një nga arsyet kryesore pse gratë nuk punojnë është sepse ato duhet të kujdesen për fëmijët e tyre, veçanërisht në qytete të tjera përveç Prishtinës, si dhe në zonat rurale (UNICEF, 2020). Kjo tregon se kërkesa për kujdesin ndaj fëmijëve nuk arrin të përmbushet nga shërbimet e kujdesit ndaj fëmijëve. Për më tepër, as kujdesi për të moshuarit nuk është zhvilluar në një nivel të kënaqshëm. Ka një numër të kufizuar të qendrave të kujdesit rezidencial, të cilat janë shumë të shtrenjta. Për më tepër, për shkak të normave sociale, dërgimi i pleqve në kujdesin rezidencial shihet si e papërshtatshme dhe deri diku kon-

siderohet ofenduese që nuk ka njeri që të kujdeset për ta në shtëpi. Gjithashtu, nuk ka infrastrukturë adekuate dhe karakteristika të sigurisë për nevojat e veçanta të kujdesit për personat e moshuar (Banka Botërore, 2017).


Në të vërtetë, gratë në zonat rurale janë më të pafavorizuara se gratë në zonat urbane, për shkak të mundësive të kufizuara për arsim parashkollor dhe shërbime të kujdesit për të moshuarit (Ivanovska dhe Dimitrovska, 2015).

Figura 38:

Punët e shtëpisë

1/2


■ E di se çfarë është më e mira ■ Vendo se çfarë të ha ■ Kujdeset për çështjet e shkollës ■ Kujdeset për disiplinën dhe sjelljen korrekte të fëmijëve ■ Përgjegjës për pastërtinë dhe rendin ■ Përgjegjës për buxhetin e familje



- Shumica e të anketuarave (39%) thanë se të dy prindërit i disiplinojnë fëmijët në mënyrë të barabartë, ndërsa 32% thanë se përgjegjësia është e nënës, 6% thanë se është e babait, 4% thanë se dikush tjetër, 2% thanë djali/vajza dhe 4% thanë të gjitha.
- Më shumë se gjysma (68%) e të anketuarave thanë se gratë janë plotësisht përgjegjëse për punët e shtëpisë, pastërtinë dhe rendin, dhe vetëm 3% thanë se është përgjegjësia e burrave.
- Të dy bashkëshortët/prindërit janë përgjegjës në mënyrë të barabartë në 12% të rasteve, dikush tjetër 6%, djali/ vajza 2%, dhe të gjithë 9%.
- Të dy prindërit/bashkëshortët janë përgjegjës në mënyrë të barabartë për shpenzimet e buxhetit familjar në 39% të familjeve, ndërsa babai/bashkëshorti është përgjegjës vetëm në 30% të rasteve, dhe nëna/bashkëshortja në 13%; 6% thanë dikush tjetër, 4% thanë djali/vajza dhe 7% të gjithë.

Figura 39:
Punët e shtëpisë

2/2



- Pjesëmarrëset në këtë studim deklaruan se babai (34%) dhe të dy prindërit (36%) janë përgjegjës për mbajtjen e familjes financiarisht, ndërsa vetëm 11% deklaruan se nënat duhet ta kenë këtë përgjegjësi.
- Nënat (23%) dhe të dy prindërit (40%) janë përgjegjës për organizimin e aktiviteteve të kohës së lirë dhe kohës së lirë, dhe vetëm 8% thanë se është detyrë e baballarëve.
- 27% e grave besojnë se edukimi fetar është detyrë e nënave dhe 42% thanë se është detyrë për të dy prindërit, ndërsa vetëm 5% deklaruan se është një detyrë për baballarët.
- 25% thanë se nënat kujdesen për personat e sëmurë, në krahasim me 5% të baballarëve, por në 36% të rasteve, të dy prindërit e bëjnë këtë. 25% thanë se nënat kujdesen për personat e sëmurë, krahasuar me 5% për baballarët, por në 36% të rasteve, të dy prindërit e bëjnë këtë.
- Vetëm 15% e nënave e kanë fjalën e fundit, krahasuar me 32% të baballarëve dhe 38% për të dy prindërit/burrin dhe gruan, dhe vetëm 7% deklaruan se të gjithë e kanë fjalën e fundit.


Analiza e ndër-tabulimit të deklaratës “burri/babai ka më shumë gjasa të ketë ‘fjalën e fundit’ në një familje” dhe statusi i gjendjes financiare të gruas/nënës tregon se në përgjithësi fjala e fundit në familje është e burrit/babait, pavarësisht nga statusi financiar i gruas.

- Më shumë gra me status mesatar financiar (mund të përballoj gjithçka që më nevojitet, por duhet të kursej; përballoj të gjitha mallrat e nevojshme pa sakrificë, por nuk mund të kursej për të të ardhmen) mendojnë më së shumti se fjalën e fundit e kanë meshkujt (72%).
- Ato me statusin më të dobët financiar (mezi përballoj të gjitha mallrat e nevojshme, ndonjëherë më mungojnë paratë; Unë nuk mund të përballojë mallrat bazë) më pak mendojnë se burri ka fjalën e fundit (16%).
- Gratë me status më të lartë financiar (mund të përballoj gjithçka unë kam nevojë dhe jam në gjendje të kursej) mendojnë më pak që fjalën e fundit ka mashkulli (10%).

Figura 40.

Statusi financiar i gruas kundrejt "fjalës së fundit" të burrit

- 1: Situatë financiare e lartë
2: Situatë financiare mesatare
3: Situatë financiare e ulët



Të dhënat e mëposhtme kanë të bëjnë vetëm me të anketuarat që janë të martuara/jetojnë me një partner (N=652). Ne i pyetëm ato për statusin e punësimit të bashkëshortëve/partnerëve të tyre. Përafërsisht 52% e partnerëve të tyre janë të punësuar dhe vetëm 8% janë të

vetëpunësuar. 26% janë të papunë dhe 9% nuk janë në gjendje të punojnë. Ato gjithashtu ndanë informacion në lidhje me të ardhurat e partnerëve të tyre, dhe 79% thanë se partnerët e tyre fitojnë më shumë se ato.

Figura 41:



Punësimi i partnerit


Figura 42:

Fitimet e partnerit

Një ndarje e ashpër gjinore në tregun e punës vazhdon ende në Kosovë. Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore, në vitin 2019, vetëm 21.1% e grave ishin ekonomikisht aktive në krahasim me 59.7% të burrave (ASK, 2020). Edhe pse ata kanë një normë shumë më të ulët të aktivitetit, shkalla e papunësisë së grave është më e lartë se ajo e burrave. Ndërsa gratë përfaqësojnë 49.8% të popullsisë

në moshë pune, ato përbëjnë vetëm 22.9% të totalit të individëve të punësuar në Kosovë (ASK, 2020). Kjo është për shkak të shkallës së ulët të punësimit të grave, të regjistruar në 13.9% në 2018, në krahasim me 46.2% për burrat - një normë më shumë se tre herë më e lartë se ajo e grave. Midis 2012 dhe 2019, hendeuku mesatar gjinor në punësim ishte rreth 31 pikë përqindje (Gashi, 2020).

Figura 43:
Gjendja financiare




Ne gjithashtu i pyetëm pjesëmarrëset për gjendjen e tyre financiare. Shumica e të anketuarave raportuan se ato mund të përballojnë gjithçka që u nevojitet, por duhet të kursejnë, ndërsa 35% thanë se pa sakrifica, ato mund të përballojnë gjithçka që u nevojitet, por nuk mund të kursejnë për të ardhmen. Të tjerat raportuan se ato vështirë se mund të përballojnë të gjitha mallrat e nevojshme (13%) dhe 2% thanë se nuk mund të përballojnë as mallrat bazë. Vetëm 12% mund të përballojnë gjithçka që u nevojitet dhe ende mund të kursejnë për të ardhmen.

Shumë faktorë, të vendosur nga legjislativi në pushtet, i kontribuojnë kësaj pozite shqetësuese të grave në tregun e punës. Ndarja e pabarabartë gjinore e punës së paguar të kujdesit rezultojnë në marrëdhënie të pabarabarta, punësim të pasigurt kur gratë marrin pjesë në tregun e punës dhe feminizim të varfërisë gjatë jetës (KGSC, 2021). Ligji i Punës në Kosovë nuk merr parasysh konceptin e riprodhimit shoqëror në kuptimin e marrëdhënieve të punës, duke pasur parasysh se dispozitat e tij për pushimin e lehonisë rregullojnë gjashtë muajt e parë, me 70% të të

ardhurave bazë të kompensuara nga punëdhënësi dhe tre muaj me 50% të të ardhurave mesatare të kompensuara nga qeveria, dhe tre muaj shtesë që janë të papaguara, e drejtë për nënën, dhe vetëm dy deri në tre ditë pushim të paguar dhe dy javë shtesë pushimi opsional të paguar për baballarët. Kjo mund të interpretohet si ngarkesa kryesore për sektorin privat, gjë që ndikon drejtpërdrejt në punësimin dhe promovimin e ulët të grave, si dhe në shfaqjen e diskriminimit me bazë gjinore. Pushimi sipas ligjit aktual, kryesisht përbëhet nga pushimi i lehonisë dhe vetëm 5% e kësaj periudhe kohore mund të përdoret nga baballarët (KGSC, 2021).

Pjesëmarrëset u pyetën se si e organizojnë shtëpinë e tyre dhe shumica e grave (44%) thanë se, “ne grumbullojmë të gjitha paratë dhe secili merr atë që na nevojitet”, pasuar nga deklaratat, “partneri/burri im menaxhon të gjitha paratë dhe më jep pjesën time” (36%). Përafërsisht 6% i mbajnë paratë e tyre të ndara dhe vetëm 4% e grave deklaruan, “Unë menaxhoj të gjitha paratë dhe i jap partnerit/burrit tim pjesën e tij/saj”.

Figura 44:
Si e menaxhojnë ato shtëpinë e tyre




N=652

Studimi tregon se shumica e punëve të shtëpisë janë përgjegjësi e grave. Përafërsisht 91% e grave kryesisht gatuajnë, 83% bëjnë rregullimin, 87% bëjnë pastrimin, 90% larjen, ndërsa detyrat për të cilat kujdesen kryesisht partnerët/burrat përfshijnë mirëmbajtjen, dekorimin dhe

riparimin (54%) dhe që kanë të bëjnë me faturat e shpenzimeve (46%). Për faturat kujdesen të dy (33%) dhe aktiviteti tjetër i përbashkët për të dy është blerja e artikujve ushqimorë (53%).


Figura 45:

Kush në familjen tuaj i kryen këto detyra?

*E anketuara jeton me bashkëshortin/partnerin N=616

Gratë me fëmijë iu përgjigjën pyetjes se kush është përgjegjës për aktivitete të ndryshme. Përgjigjet e tyre tregojnë se shumica e këtyre janë bërë vetëm nga gratë:

Figura 46:

Kush kujdeset për fëmijët

*të anketuarat që kishin fëmijë N=675


- Kujdesi ditor për fëmijët (55%), qëndrimi në shtëpi me fëmijët kur ata janë të sëmurë (46%), marrja e fëmijëve nga shkolla.
- Aktivitetet (37%) dhe dërgimi i fëmijëve në kopsht/ shkollë dhe në shtëpi (36%).

Këto rezultate tregojnë se gratë janë të ngarkuara me këto detyra shtëpiake në një masë shumë më të lartë, por duket se atyre nuk u pengon. Kur u pyetën për ndarjen e përgjegjësisë në lidhje me punët e shtëpisë, 47% e të anketurëve

raportuan se kishte ndarje krejtësisht të drejtë midis tyre, ndërsa 44% thanë mjaft të drejtë, dhe vetëm 9% thanë se ndarja e punëve të shtëpisë nuk ishte aspak e drejtë.

Figura 47:

Dakordimi që ndarja e punëve të shtëpisë të jetë e drejtë




*rastet kur respondentja është e martuar ose në një lidhje N=652

Ky qëndrim që ndarja është mjaft e drejtë, reflektohet në të gjitha rajonet në mënyrë të ngjashme, me rajonin e Gjakovës që shënon më së shumti pikë në përgjigje "krejtë-

sisht të drejtë" (76%). Më shumë gra në Gjiilan besojnë se nuk është aspak një ndarje e drejtë (21%), në krahasim me gratë nga rajonet e tjera, përfshirë Prishtinën (7%).

Figura 48:

Dakordimi që ndarja e punëve të shtëpisë është e drejtë, sipas rajonit




*rastet kur respondentja është e martuar ose në një lidhje N=652

Të dhënat tregojnë se gratë që janë të martuara ose që jetojnë me një partner kanë shumë më pak kohë për angazhime personale, shoqërim ose relaksim sesa bashkëshort/partneri i tyre.


Përafërsisht 55% e grave, në rastet kur partnerët janë të punësuar, thanë se natyra e punës e kufizon kohën që një bashkëshort/partner të kalojë kohë me familjen.

Figura 49:
Puna e burrit/partnerit tuaj ndonjëherë ia kufizon kohën që ai kalon me familjen dhe miqtë




Kjo gjithashtu reflektohet në më pak kohë për jetën shoqërore të grave dhe për të bërë aktivitete që ato duan të bëjnë.

Figura 50:
Koha për të zhvilluar interesimet e tyre, për t'u relaksuar dhe shoqëruar



Kur u pyetën se sa shpesh burrat/partnerët e tyre kanë kohë për to, duket se përkundër faktit se ata janë duke punuar, ata për çdo ditë u kushtojnë mjaft kohë atyre.

Figura 51:
Sa shpesh burri/partneri i juaj ka kohë për ju? Sipas punës së bashkëshortit/partnerit



Të anketuarat gjithashtu vlerësuan shkallën e barazisë gjinore brenda martesës/marrëdhënies së tyre, në një shkallë nga 1 (shumë e ulët) në 5 (shumë e lartë). Përafërsisht 49% raportuan se kishin një shkallë shumë të lartë të barazisë gjinore në marrëdhëniet e tyre (Figura 54).

Kur krahasojmë zonat urbane dhe rurale, përqindja është

pak më e lartë në zonat urbane me 55%, dhe 46% në zonat rurale. Kur krahasohen me gjetjet e mëparshme, të cilat demonstrojnë një ndarje të pabarabartë të punëve të shtëpisë ndërmjet gjinive, nënkuptohet se gratë e pranojnë deri diku ndarjen patriarkale të roleve gjinore në shoqërinë kosovare.

Figura 52:

Shkalla e barazisë gjinore në marrëdhënie




Një vështrim i mëtejshëm tregon se çështjet që shkaktojnë grindje midis bashkëshortëve/partnerëve ndonjëherë kanë të bëjnë me edukimin e fëmijëve (14%), paratë (12%), përgjegjësitë shtëpiake (12%) dhe mënyrën se si dikush po e kalon kohën e lirë dhe (11%), punën/karrierën (10%).

Kjo tregon se çështjet më të vlerësuara nuk shkaktojnë shumë grindje brenda marrëdhënieve të të anketuarave. Nuk kishte dallime të rëndësishme sipas nivelit arsimor, apo vendndodhjes urbane/rurale.

Figura 53:

Çështjet e argumentimit midis bashkëshortëve/partnerëve



Grupimi 1:

Gratë që shprehën barazinë gjinore në një marrëdhënie martesore/marrëdhënie në një shkallë më të lartë janë profilizuar si mëposhtë:

Urban;
Përkatësia etnike shqiptare
Grupmosha 18-34 vjeç
Arsim më i lartë.

Grupimi 2:

Gratë që shprehën barazinë gjinore në marrëdhënien e tyre martesore/ marrëdhënie në një shkallë pak më të ulët janë profilizuar si më poshtë:

Rural;
Përkatësia etnike serbe
Grupmosha 35-54 vjeç Arsim fillor ose i ulët


4.4 GJETJA E PARTNERIT

Në një shkallë nga 1 (shumë e lehtë) deri në 3 (shumë e vështirë), të anketuarat ranë dakord se është më e vështirë për nënat e vetme (63%) të gjejnë një partner serioz për një marrëdhënie intime, pasuar nga të divorcuarat/të vejat (50%). Kjo sugjeron ekzistencën e paragjyqimeve në shoqërinë e Kosovës në lidhje me pranueshmërinë e një gruaje

për një marrëdhënie/partner serioz. Perceptimi i nivelit të lehtësisë për gratë e vetme që kërkojnë një partner është mjaft i lartë, 40%. Analiza e korrelacionit bivariat tregon se ky perceptim nuk është proporcional me moshën e të anketuarave.

Figura 54:

Gjetja e një partneri



4.5 GJENDJA E GRAVE GJATË COVID-19

Studimi i Grave 2022, u kërkoi të anketuarave të vlerësojnë shkallën në të cilën u përballën me probleme, sfida dhe rreze të ndryshme si pasojë e drejtpërdrejtë e krizës me COVID-19, në një shkallë nga 1 (aspak) deri në 4 (shumë e lartë). Çështjet me të cilat u ballafaquan kryesisht si rezultat i drejtpërdrejtë i krizës me COVID-19 përfshijnë socializimin e reduktuar me njerëzit jashtë familjes (21%), uljen e pagës (15%), uljen e buxhetit familjar (11%) dhe të tjera që ishin në një nivel më të ulët. Është e rëndësishme të theksohet se një përqindje e lartë e grave nuk iu përgjigjën çështjeve të mëposhtme, si: humbja e punës (58%), vështirësitë për të mësuar se si të përdorin teknologjinë për punë në distancë (57%), duke punuar nga shtëpia (57%), aftësia për të përparuar në karrierë (55%), askush për të ndihmuar me fëmijën/fëmijët (42%), pamundësia për të përfunduar shkollimin (27%) dhe një numër në rritje i detyrave të punës (27%).

Çështjet me të cilat u ballafaquan më pak si rezultat i drejtpërdrejtë i krizës me COVID-19 përfshijnë: divorci/përfundimi i një marrëdhënie emocionale (1%), çështjet shëndetësore (psikologjike) (3%), pamundësia për të përfunduar arsimin (3%), askush për të ndihmuar me fëmijën/fëmijët (3%), pamundësia për të përparuar në karrierë (3%), çështjet shëndetësore (fizike) (4%), askush për të ndihmuar me drejtimin e amvisërisë (4%), humbja e një pune (4%), vështirësi për të mësuar se si të përdorin teknologjinë për punë në distancë (4%), punë nga shtëpia (5%) dhuna në familje (5%) dhe rritja e numrit të detyrave të punës (6%). Meqenëse pothuajse të gjitha përqindjet e këtyre pikave janë të ulëta, lidhja e përgjithshme e perceptuar me COVID-19 është relativisht e dobët.

Analiza e të dhënave midis rajoneve është e ngjashme me masën që gratë u përballën personalisht me probleme, sfida dhe rreze si pasojë e drejtpërdrejtë e krizës me Covid-19. Megjithatë, ka disa dallime në disa çështje. Në Mitrovicë, vlera mesatare e grave që raportojnë se nuk kanë ndihmë në drejtimin e amvisërisë ($m=2.1$) është më e lartë krahasuar me rajonet e tjera, veçanërisht Gjakovën ($m=1.1$).

Gratë nga rajoni i Pejës hasën një nivel më të lartë të paaftësisë për të përparuar në karrierë ($m=2.2$), ndërsa gratë në Prishtinë raportuan nivelin më të lartë të lëvizshmërisë në karrierë ($m=1.2$).

Gratë në Gjakovë përballen me një numër më të lartë të detyrave të punës ($m=3.0$), me më të ulëtat në Prishtinë ($m=1.2$). Në aspektin kur nuk ka "askush të ndihmojë me fëmijën/fëmijët", mesatarisht gratë nga rajoni i Ferizajt renditen më të lartat ($m=2.1$), ndërsa gratë në rajonin e Gjakovës shënojnë rezultatin më të ulët ($m=1.0$).

Vështirësitë për të mësuar se si të përdorin teknologjinë për punë në distancë janë më të lartat në Mitrovicë ($m=2.1$) dhe Pejë ($m=2.1$), dhe më e ulëta në Prishtinë ($m=1.2$). Problemi i punës nga shtëpia ishte më i spikatur në Gjakovë ($m=3.6$) dhe më i vogli në Prishtinë ($m=1.3$). Problemi i të pasurit më shumë punë te shtëpise u perceptua më i lartë në Gjiilan ($m=2.8$), dhe më i ulët në Prishtinë ($m=1.4$). Gjilani u prek më së shumti nga ulja e buxhetit familjar ($m=3.0$), ndërsa më pak e prekur ishte Gjakova ($m=1.2$).

Ferizaj (m=2.7) dhe Gjakova (m=2.7) u ballafaquan më shumë me ulje të pagave. Për dallim, gratë nga rajoni i Prishtinës ishin më pak të prekura (1.7).

Gjetjet tregojnë se në përgjithësi, gratë në Prishtinë u prekën më pak nga probleme, sfida dhe rreziqe të ndryshme si pasojë e drejtpërdrejtë e krizës nga COVID-19.

Socializimi i reduktuar me njerëzit jashtë familjes ishte më i theksuar në rajonin e Pejës (m=3.2), me rezultatin më të ulët në rajonin e Prishtinës (m=1.7).

Figura 55:
Sfidat gjatë krizës me COVID-19





Figura 56:
Sfidat gjatë krizës me COVID-19, sipas rajonit



Kjo pjesë përfshin një përmbledhje të diskutimit të grupeve të fokusit me gratë e moshës 18-35 vjeç që janë prej rajoneve të ndryshme. Në lidhje me jetën familjare dhe shoqërore, gratë nga fokus grupet deklaruan se familja është shumë e rëndësishme për to. Ka dallime në mes të njerëzve që jetojnë në zonat urbane dhe rurale. Në fshatra, ata zakonisht jetojnë në komunitete dhe vendimarrja bie mbi kryefamiljarin, ndërsa në qytete çiftet e reja zakonisht jetojnë vetë. Për më tepër, një pjesëmarrëse deklaroi se ajo është divorcuar nga burri i saj sepse familja e tij nuk e lejonte të punonte.

Për dallim, një pjesëmarrëse tjetër që jeton në një zonë rurale theksoi se si familja e burrit të saj e përkrahë atë që t'i vazhdojë studimet. Edhe pse edhe ajo është nga një fshat, mund të konkludohet se mentaliteti ndryshon nga familja në familje. Për më tepër, disa gra theksuan se nga burrat pritet të kenë më shumë përgjegjësi financiare, ndërsa gratë të merren me punët e shtëpisë. Një nga pjesëmarrëset (e cila ishte mësuese) tregoi se në shumicën e rasteve është nëna ajo që kujdeset më shumë për detyrat e shtëpisë së fëmijëve.

Gratë gjithashtu raportuan se është e vështirë për çiftet të kalojnë shumë kohë së bashku, kryesisht për shkak të detyrimeve të tjera pas punës, bie fjala, kur kanë mysafirë. Të tjerat raportuan se telefonat përdoren tepër nga të gjithë, duke bërë që bisedimet të jenë më të pakta. Megjithatë, gratë arrijnë në përfundimin se kur don është e mundur të kalosh kohën. Për më tepër, një pjesëmarrëse e divorcuar deklaroi se është e mundur të mbajnë një marrëdhënie/komunikim të shëndetshëm me ish-burrin e e saj për hir të fëmijës, por edhe për faktin se ende ka dashuri mes tyre. (Ajo u divorcua sepse familja e burrit të saj nuk e la të punonte). Të tjerë theksojnë se është e vështirë të mbash komunikim të shëndetshëm me ish-bashkëshortët, për shkak të mentalitetit dhe thashethemeve.

Diskutimi i fokus grupit të dytë është nga gratë e moshës 36-55 vjeç, që ishin prej rajoneve të ndryshme, dhe kjo tregon se shumica e grave mendojnë se është një fakt i ditur se gratë zakonisht kanë më shumë përgjegjësi në familje. Një grua që punon dhe pasi të jetë kthyer nga puna, vazhdon të përgatisë ushqim e të kujdeset për fëmijët, ndërsa burrat zakonisht nuk e ndajnë këtë përgjegjësi. Jetesa me prindërit e bashkëshortit e bën gjithçka më të lehtë, sepse nëse nëna punon ata mund të ndihmojnë duke u kujdesur për fëmijët.

Megjithatë, në përgjithësi, edhe kur gratë i kanë të njëjtat të ardhura si burrat, kjo nuk i zvogëlon përgjegjësitë familjare dhe të kujdesit për fëmijët që si grua i takojnë asaj. Familjet në zonat rurale karakterizohen më shumë nga papunësia më e lartë, dhe kjo rezulton në mundësi edhe më të kufizuara për arsimimin e hershëm të fëmijëve. Ndryshe nga gratë në zonat rurale, ato në zonat urbane kanë mundësi më të mëdha për monitorimin e tregut të punës dhe zhvillimin profesional. Gjithashtu, gratë në qytetet urbane janë më të lira të dalin dhe të angazhohen në aktivitete të lira që u pëlqejnë. Disa pjesëmarrëse deklaruan se në ditët e sotme burrat marrin më shumë përgjegjësi për t'u kujdesur për fëmijët dhe organizimin e jetës familjare. Në të kaluarën, ishte e turpshme për baballarët të luanin me fëmijët, ndërsa sot, kjo nuk perceptohet si problem.

Ende nuk ka një nivel të mjaftueshëm të barazisë gjinore, veçanërisht në zonat rurale, ku shumica e përgjegjëseve për edukimin e fëmijëve, si dhe kujdesin për të moshuarit dhe anëtarët e familjes që kanë nevojë për kujdes specifik, u takojnë grave. Në ditët e sotme, është më e vështirë për bashkëshortët e martuar të kalojnë kohë së bashku, duke marrë parasysh se gratë kanë obligime të tjera në shtëpi pas kthimit nga puna, siç është përgatitja e ushqimit. Pavarësisht nga gjithçka që ka ndodhur, ekziston mundësia e komunikimit të vazhdueshëm midis çifteve të divorcuara, veçanërisht për ata me fëmijë, përveç kur divorci ka ndodhur për shkak të dhunës.

Fokus grupi nga përfaqësuesit e OSHC-ve që merren drejtpërdrejt ose tërthorazi me çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, zbuluan më shumë njohuri për pabarazinë midis grave që lidhet me punët e shtëpisë dhe çështjet tjera. Një nga pjesëmarrëset theksoi se “si vajzë dhe si hulumtuese që jam, mund të them se bazuar në një sondazh të bërë në vitin 2018, gratë shpenzojnë rreth 8 orë në ditë duke i bërë punët e shtëpisë, që përfshin kujdesin për më të moshuarit, kujdesin për fëmijët, gatimin dhe gjithçka tjetër, ndërsa burrat kujdesen më shumë për mirëmbajtjen teknike të shtëpisë”.

Sipas diskutimit, ndarja e detyrave bazohet në rolet që u caktohen grave dhe burrave sipas kulturës kosovare. Shumë gra që jetojnë në zonat rurale nuk kanë qasje në jetën publike. Megjithatë, ka të tjera që udhëtojnë çdo ditë sepse janë të punësuar në qytet; por, shumë prej tyre punojnë pa një kontratë pune. Ka shumë gra, burrat e të cilave i pengojnë ato të punojnë, pavarësisht se gratë duan të punojnë.

Gratë gjithashtu deklaruan se ka shumë diskriminim ndaj grave, veçanërisht në zonat rurale dhe për këtë arsye niveli i dhunës atje është më i lartë. Ato tregojnë se gratë janë më të arsimuara se burrat, dhe kjo ilustron me një numër më të madh të grave që i vijnë studimet universitare. Gratë në këtë diskutim në fokus grupe gjithashtu argumentuan se burri është ofruesi kryesor financiar në shumicën e familjeve, kështu që ai vendos për çështjet financiare, ndonëse gratë janë më të përkushtuara dhe i kushtojnë më shumë vëmendje edukimit të fëmijëve, pasi kanë më shumë kohë të lirë – për sa i përket pagesës.

Pjesëmarrëset argumentuan se në shumicën e rasteve, për shkak se shumë gra nuk janë të punësuar, u takon atyre

që të kujdesen për rritjen e fëmijëve, edukimin dhe detyrat e shtëpisë. Burrat janë më të punësuar se gratë, gjë që ndikon në marrëdhëniet familjare. Ato përmendën disa studime që kanë treguar se gratë që janë përgjegjëse për shpenzimet financiare shpenzojnë më shumë për arsimin dhe shëndetin, ndërsa burrat shpenzojnë më shumë për ushqim, pije dhe artikuj tjerë të konsumit.

Të tjerat thanë se gratë shpenzojnë më shumë për produkte të pastrimit dhe gjërave për fëmijët, dhe rrallë për veten e tyre. Disa pjesëmarrëse thanë se ka një mungesë të ruajtjes së komunikimit midis nënave të vetme dhe ish-bashkëshortëve të tyre. Kur nënat u kërkojnë burrave të tyre të ndihmojnë me financimin e shkollimit të fëmijëve dhe për gjëra tjera, ata zgjedhin të mos ndihmojnë, bile edhe në rastet kur ata mund ta përballojnë këtë. Për më tepër, ata dërgojnë prova të rreme në gjykata për të dëshmuar se nuk kanë të ardhura dhe se nuk mund të mbështesin fëmijët e tyre. Pjesëmarrësja iu referua të dhënave nga 25 nëna të vetme nga Prishtina dhe rrethi i Prishtinës, të dhëna cilat ajo i konsideron alarmante.

Një pjesëmarrëse tjetër deklaroi se në lidhje me marrëdhëniet pas divorcit, nëse gratë kanë përjetuar dhunë, është shumë e vështirë të përmirësohet një lidhje që është prishur, prandaj gjithçka varet nga shkaqet e divorcit. Shumica e rasteve të divorcit që janë vendosur në gjykatë janë për shkak të dhunës dhe në disa raste edhe për shkak të tradhtisë. Përfaqësuesit e institucioneve publike në lidhje me barazinë gjinore argumentuan se vajzat dhe gratë në zonat rurale, ndryshe nga ato në zonat urbane, janë më të ndrojtura dhe më pak të guximshme në paraqitjen e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Ato gjithashtu argumentuan se ndarja e përgjegjësisë brenda familjes kosovare është një mentalitet i instaluar në të kaluarën, kështu që gratë kanë përgjegjësi që nuk u delegohen nga askush, por ato i marrin vetë. Edhe në rastet kur gratë punojnë, ato vazhdojnë ta ndiejnë këtë përgjegjësi të punëve si, kujdesi për fëmijët, gatimi, pastrimi, kujdesi për të moshuarit, etj., në këtë rast sikur kalojnë në turnin e dytë të punës. Në të kaluarën dallimet gjinore në familje janë trashëguar nga brezi në brez dhe për të ndryshuar një traditë, duhet të kaloj një shekull. Ato gjithashtu deklaruan se është më pak e mundshme që burrat të bëjnë punën e kujdesit të papaguar

KONKLUDIME

- Në këtë kapitull është diskutuar rreth jetës familjare dhe shoqërore, në kontekstin kombëtar të Republikës së Kosovës. Kosova ende konsiderohet të ketë një shoqëri patriarkale të ngurtë, në të cilën për çështje të ndryshme burrat e kanë fjalën e fundit, si dhe kanë qasje në burime sociale dhe ekonomike. Kapitulli vazhdon me aktivitetet e kohës së lirë, sfidat gjatë COVID-19, organizimin e familjes dhe rolet e përgjithshme të barazisë, gjetjen e partnerëve për marrëdhënie/martese, si dhe gjetjet nga fokus grupet.
- Gratë e intervistuar raportuan se aktivitetet e tyre të kohës së lirë kryesisht përfshijnë gjithmonë ose shpesh kalimin e kohës me familjen, biseda në telefon, përdorimi i mediave sociale si Viber, Facebook, Instagram, etj, si dhe shikimin e filmave dhe serialeve në TV ose në internet. Nëse krahasojmë aktivitetet e kohës së lirë bazuar në grupmoshat, rëndësia/shpeshtësia e kohës së tyre të lirë është më e lartë për gratë më të reja sesa për gratë e moshuara.
- Gratë vërejtën se socializimi i kufizuar me individë jashtë familjes, si dhe një pagë e ulët dhe një buxhet më i ulët familjar, ishin të gjithë faktorë që kontribuan tek problemet, sfidat dhe rreziqet me të cilat u përballën gjatë krizës me COVID-19. Gjetjet tregojnë se, në krahasim me vendet e tjera, kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, ishte më pak i prekur me probleme, sfida dhe rreziqe të ndryshme, si rezultat i drejtpërdrejtë i pandemisë me COVID-19.
- Shumica e grave raportuan se jetojnë me një partner/bashkëshort dhe me fëmijë. Shumica e tyre ose kanë një pronë të përbashkët me prindërit e burrit/partnerit të tyre, ose pronarë është vetëm partneri/burri.
- Të anketuarat gjithashtu raportuan se kishin përgjegjësi familjare, pavarësisht nga marrëdhënia ose statusi i amësisë. Ato më së shumti u pajtuan se prindërit/bashkëshortët pothuajse në mënyrë të barabartë e dinë se çfarë është më e mira për familjen; nëna/gruaja merr vendime për ushqimin, nëna është përgjegjëse për detyrat që lidhen me shkollimin e fëmijëve të tyre, të dy prindërit i dispiplinojnë fëmijët në mënyrë të barabartë, gratë janë plotësisht përgjegjëse për punët e shtëpisë, pastërtinë dhe rendin, burri/babai është përgjegjës i vetëm për mirëqenien e përgjithshme financiare të familjes, prindërit/bashkëshortët marrin përgjegjësi të barabartë për organizimin e aktiviteteve të kohës së, si dhe prindërit/bashkëshortët marrin përgjegjësi të barabartë për edukimin fetar të fëmijëve.

- Nga të anketuarit e martuar, shumica e tyre raportojnë se kanë 3-4 fëmijë. Moshë e fëmijëve në shumicën e rasteve është më e lartë se 23 vjeç. Për më tepër, shumica e të anketuarve raportuan se mund të përballojnë gjithçka që u nevojitet, por duhet të kursejnë, ndërsa vetëm një përqindje e vogël thanë se mund të përballojnë gjithçka dhe ende kursejnë.
- Të anketuarit e intervistuar ishin kryesisht të martuar, të pasuar nga beqarë, të ve, në një lidhje por jo bashkëjetuese dhe të divorcuar. Paragjykimet ekzistojnë në shoqërinë kosovare, pasi nënat beqare dhe të divorcuara/vejusha janë raportuar të kenë vështirësinë më të madhe për të gjetur sërish një partner për një marrëdhënie intime. Për gratë e martuara, bashkëshortët/partnerët janë kryesisht punonjës me pagë. Shumica e grave të martuara raportuan se puna e burrit/partnerit e kufizon plotësisht kohën që ai kalon me familjen dhe miqtë. Për sa i përket të ardhurave familjare, shumica prej tyre raportuan se ose i bashkojnë të gjitha paratë dhe secili merr atë që u nevojitet, ose burri/partneri i tyre menaxhon të gjitha paratë dhe ua jep pjesën e tyre.
- Rezultatet gjithashtu tregojnë se shumica e grave kanë kohë çdo ditë për aktivitete personale, relaksim ose shoqërim, të ndjekura nga të tjerat që kanë kohë 1-2 herë në muaj ose më pak, 3-4 herë në javë dhe 1-2 herë në javë. Më pak se gjysma e tyre raportuan se kishin burra/partnerë që punonin dhe kalonin kohë çdo ditë me gratë e tyre. Përndryshe, burrat/partnerët që nuk janë në gjendje të punojnë kryesisht kanë kohë të dedikuara për grate e tyre.
- Sa i përket përgjegjësi shtëpiake, është interesante të theksohet se shumica e grave raportuan se plotësisht ekziston një ndarje të drejtë ose bukur të drejtë midis tyre. Niveli i drejtësisë është më i lartë në rastin e Gjakovës, Prishtinës dhe Ferizajt, krahasuar me Gjilanin, Mitrovicën, Pejën dhe Prizrenin. Shumica e aktiviteteve shtëpiake bëhen nga gratë, ndërsa riparimet dhe marrja me fatura bëhet nga burrat. Për më tepër, shumica e grave me fëmijë raportojnë se këto detyra bëhen vetëm nga gratë, si kujdesi i përditshëm për fëmijët, qëndrimi në shtëpi me fëmijët kur ata janë të sëmurë, çuarja e fëmijëve në aktivitete pas shkollës dhe marrja e fëmijëve nga kopshti/shkolla. Disa thanë se këto përgjegjësi janë të përbashkëta, por shumë pak u përgjigjën se këto përgjegjësi kryhen vetëm nga burrat.
- Disa çështje që mund të shkaktojnë diskutime/grindje midis bashkëshortëve/partnerëve përfshijnë edukimin e fëmijëve, paratë, përgjegjësitë shtëpiake, mënyrën se si dikush po shpenzon kohën e lirë dhe punën/karrierën.
- Rreth gjysma e tyre, madje ende më shumë në zonat urbane raportuan se ekziston një shkallë shumë e lartë e barazisë gjinore në marrëdhëniet e tyre. Megjithatë, punët e shtëpisë nuk janë të ndara në mënyrë të barabartë midis burrave dhe grave. Kjo mund të jetë një indikator për pranimin e ndarjes patriarkale në rolet.
- Rezultatet nga fokus grupet tregojnë se ndarja e përgjegjësi brenda familjes kosovare është pjesë e një mentaliteti cili i përket të kaluarës por që mund të ndryshohet vetëm me kohë. Edhe gratë e punësuar, vazhdojnë të kenë një barrë më të lartë të punës së paguar të kujdesit, gjë që rezultojnë në detyrimin e tyre për të vazhduar punën pasi të kthehen në shtëpi. Problemi kryesor është se gratë e pranojnë punën e paguar të kujdesit dhe detyrimeve shtëpiake si normale. Megjithatë, disa të anketuara raportuan se në ditët e sotme, është mjaft e zakonshme që babai të luajë me fëmijët dhe gjërat po ndryshojnë, por shumë ngadalë. Të anketuarat deklaruan se nënat e divorcuara dhe ato beqare nuk mund të mbajnë marrëdhënie të shëndetshme, veçanërisht kur kanë përjetuar dhunë nga partneri i tyre. Në raste të tjera, çiftet përpiqen të kenë një marrëdhënie të mirë për hir të fëmijëve. Në përgjithësi, baballarët nuk i mbështesin financiarisht nënat beqare, dhe në disa raste, ata u japin gjykatave prova të rreme lidhur me pasurinë dhe të ardhurat e tyre.

REKOMANDIME

- Të gjithë aktorët e shoqërisë duhet të promovojnë marrjen përsiper të një pjese të barabartë të punëve të shtëpisë dhe kujdesit për fëmijët. Familjet duhet të përfshijnë djemtë dhe vajzat në mënyrë të barabartë në punët e kujdesit dhe në punët e shtëpisë, që nga faza e fëmijërisë.
- Të gjithë aktorët, veçanërisht fëmijët, duhet të përpiqen të ndryshojnë normat gjinore.
- Institucionet shtetërore duhet të sigurojnë përputhjen me dispozitat ekzistuese të Ligjit të Punës dhe me Direktivën e BE-së për ekuilibrin mes punës dhe jetës.
- Mbështetja e sektorit privat që ofron shërbime për kujdesin e fëmijëve.
- Krijimi i kushteve që u mundësojnë prindërve të kujdesen për fëmijët e tyre në tre vitet e para të jetës së tyre dhe rritja e numrit të kopshteve.
- Ofrimi i programeve të edukimit parashkollor për fëmijët mbi moshën tre vjeç.
- Palët e interesuara përkatëse duhet të krijojnë aktivitete më të larmishme arsimore, kulturore dhe rekreative në nivel lokal dhe qendror.
- Palët e interesuara përkatëse duhet të rrisin qasjen në (informacion, transport, mundësi, hyrje falas) dhe lëvizshmëri të grave në aktivitete edukative, kulturore dhe rekreative.
- Në më pak se gjysmën (40%) të rasteve, prindërit/bashkëshortët marrin përgjegjësi të barabartë për organizimin e aktiviteteve të kohës së lirë; 23% thanë se nëna/gruaja merr një përgjegjësi të tillë, pasuar nga babai/burri (8%), të gjithë (19%), dikush tjetër (4%) dhe djali/vajza (4%). Duhet të ketë më shumë bashkërendim midis institucioneve shtetërore dhe organizatave të ndryshme, agjencive dhe komuniteteve lokale për të rritur aktivitetet arsimore, kulturore dhe rekreative.


5.

ARSIMI DHE PUNËSIMI

Legjislacioni i arsimit në Kosovë siguron mundësi të barabarta për vajzat, djemtë, gratë dhe burrat për të pasur qasje në arsim në të gjitha nivelet. Në mënyrë të barabartë, Ligji i Punës, siguron qasje të barabartë në mundësitë e punësimit, avancimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe ngacmimi. Në dekadën e fundit ka pasur edhe disa iniciativa të diskriminimit pozitiv për të rritur numrin e grave në postet menaxheriale dhe përfaqësimin politik. Pavarësisht nga këto ndërhyrje legjislative dhe politike, pozita e grave

në tregun e punës mbetet e ulët (Avdullahi, Ademi, Salihu, & Krasniqi, 2022). Të dhënat e mbledhura për këtë studim tregojnë se vetëm 24% e grave që marrin pjesë në sondazh janë duke punuar (21% të punësuar, 2% të vetëpunësuar dhe 1% të pavarura), ndërsa pjesa tjetër e pjesëmarrëseve janë të papuna (15% të papuna, 10% të pensionuara, të paafta për punë 1% dhe duke studiuar 12%).

Figura 57:
Punësimi



Raportet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (2022), për tremujorin e tretë (TM3) dhe tremujorin e katërt (TM4) të vitit 2021, tregojnë një shkallë papunësie prej 25% dhe 24%, e cila mund të interpretohet si një rënie e lehtë. Studimi i GAP-it³ në vitin 2021, raporton se vetëm 1,954 (33%) nga 5,695 punonjës janë gra në administratën komunale të Kosovës dhe vetëm 3,189 (41%) nga gjithsej 7,855 punonjës janë gra në administratën e institucioneve qendrore. Ndërkohë vetëm 89 (9%) nga të punësuarat janë në pozita të larta drejtuese dhe vetëm 501 (32%) në pozita drejtuese. Sipas studimit të Institutit GAP (2021), 21% e emërimeve në pozita qeveritare në vitin 2020 janë ndarë për gratë, krahasuar me 14% në qeverinë e

mëparshme, duke raportuar se gratë kanë mbajtur rreth një të tretën e pozitave në pozita drejtuese, në shërbimin civil dhe stafin akademik. Një raport tjetër i publikuar nga HERAS Plus (2022), për barazinë gjinore në institucionet e arsimit të lartë, gjithashtu zbulon se burrat dominojnë në pozitat e larta drejtuese në krahasim me gratë.

Gratë e këtij studimi të cilat punojnë janë kryesisht në sektorin publik (49%), pasuar nga sektori privat (45%) dhe sektori i OJQ-ve (6%). Pothuajse 90% e grave që punojnë deklarohen se kontributojnë dhe taksojnë të tyre paguhen nga punëdhënësit e tyre dhe 81% e tyre marrin pagën e tyre me transferta bankare. Shumica e grave që punojnë kanë relativisht pak përvojë (1-5 vjet) dhe 16% e tyre kanë një përvojë të gjatë pune (mbi 15 vjet).

³https://www.institutigap.org/documents/22080_Employment%20of%20women%20and%20their%20representation%20in%20Kosovo2020.pdf

Në këtë kapitull shqyrtohet pozita e grave në lidhje me punësimin dhe arsimin paraqitet duke prekur çështje si qëndrimet e grave ndaj mjedisit të punës, diskriminimit të perceptuar në vendin e punës, mundësitë për avancimin në pozita menaxheriale, qëndrimet ndaj karrierës, çështjet e papunësisë dhe vetëpunësimit, qëndrimet ndaj arsimit, roli i arsimit në promovimin e shembujve model dhe vlerave.


5.1 QËNDRIMET PËR MJEDISIN E PUNËS

Të dhënat për pozitën e grave në vendin e punës dhe qëndrimet e tyre ndaj mjedisit të punës në përgjithësi mungojnë në Kosovë. Kjo kapitull ofron njohuri të rëndësishme rreth perceptimeve dhe qëndrimeve të grave ndaj mjedisit të punës, edhe pse numri i grave të punësuar në Kosovë mbetet i ulët. Të gjitha gratë i janë përgjigjur të gjitha pyetjeve në lidhje me mjedisin e punës. Për ato që nuk punojnë, ne i llogarisim qëndrimet e tyre të perceptuara dhe shumica e tyre janë në përgjithësi pozitive për mjedisin e punës, duke përfshirë respektin e ndërsjellë, pa diskriminim dhe pa raportime për trajtim të papërshtatshëm. Pesëdhjetë e dy përqind e grave pajtohen plotësisht dhe 22.88% pajtohen me deklaratën, “në organizatën


ku punoj ka besim dhe respekt të ndërsjellë” dhe vetëm 16.95% raportuan një pozicion neutral. Gratë gjithashtu raportuan një përqindje të përafërt pajtimi dhe mospajtime deklarator, “trajtimi i papërshtatshëm i grave në organizatën time është i kundërligjshëm dhe ndëshkohet rëndë”, ku 38.14% nuk pajtohen plotësisht, 3.81% nuk u pajtuan, 28.39% u pajtuan plotësisht dhe 11.44% u pajtuan dhe 10.59% ishin neutrale. Këto gjetje sugjerojnë se mjedisi i punës perceptohet në përgjithësi si i sigurt dhe i barabartë, kështu që zbatimi i rregullores dhe adresimi i trajtimit të papërshtatshëm në vendin e punës ka nevojë për promovim dhe zbatim të vazhdueshëm.

Mospajtimi më i madh shprehet me deklaratat në lidhje me pozitën e burrave në vendin e punës ku 69.49% nuk ishin dakord me deklaratën “Unë shpesh nuk kërkoj ditë pushimi sepse kam frikë se mbikëqyrësi im...” dhe 72.88% nuk ishin dakord me deklaratën, “Në mënyrë që gratë të përparojnë ato duhet të punojnë më shumë se burrat”. Në mënyrë të ngjashme, 61% e të anketuarave nuk pajtohen me deklaratën se, “mendimi mbizotërues në organizatën ku punoj është se burrat janë më të përshtatshëm për pozita menaxheriale sesa gratë. Këto përgjigje tregojnë se gratë perceptojnë trajtim të barabartë dhe adekuat në vendin e punës.

Figura 58:
Dakordimi me deklaratat në lidhje me vendin e punës




Lidhur me **pagën**, ato paguhen për punën që bëjnë, përgjithësisht gratë mbeten indiferente (40.25%), përgjithësisht të kënaqura (28.81% deri diku të kënaqura dhe 15.68% shumë të kënaqura).⁴



Gratë nga të gjitha rajonet raportojnë kënaqshmëri mesatare ($m=3$) me pagat e tyre, përveç në Prishtinë ku gratë raportuan se ato janë shumë të kënaqura ($m=5$).

Kjo mund të jetë për faktin se Prishtina, si kryeqendër ofron më shumë mundësi, veçanërisht në sektorin e shërbimeve, ku pagat janë mjaft konkurrense.




Një hendek gjinor i pagave nuk u raportua nga gratë në këtë studim gjatë sondazhit ose në grupet e fokusit. Vetëm një grua raportoi se hendeku gjinor i pagave është i pranishëm në sektorin privat dhe jo në sektorin publik. Raporti për hendekun gjinor të pagave i publikuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në Kosovë (2020)⁵, tregon për një hendek gjinor të pagave prej 8% në sektorin publik dhe 20% në sektorin privat me përqindjet më të larta në profesionet bazike dhe zejtarinë dhe profesionet e lidhura me tregtinë. Problemi kryesor mbetet numri i ulët i grave të punësuar në përgjithësi dhe veçanërisht në sektorët me pagë më të ulët dhe punë afatshkurtër, kryesisht në industrinë e shërbimit (Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, 2021).

Qëndrimet e grave ndaj punësimit u hulumtuan gjithashtu me deklarata të synuara që përcillnin qëndrimet lidhur me kushtet e punës. Dakordimi më i lartë u raportua për deklaratat, “burri duhet të ketë një pagë më të lartë nëse të dy janë të punësuar” (53%), dhe “nëse burri fiton mirë, gruaja nuk duhet të kërkojë punë, sepse ajo ka mjaft për të bërë në shtëpi dhe të kujdeset për fëmijët” (46%), “është më e përshtatshme që organizata të punësojë një burrë, sesa një grua me të njëjtat kualifikime” (41%) dhe “gjatë intervistës për punësim, unë jam diskriminuar për shkak se jam grua” (44%). Kryesisht nuk janë pajtuar me deklaratën, “Gjatë një interviste për punësim, menaxherët janë të lirë t’i pyesin gratë se sa fëmijë kanë, sa vjeç janë dhe kush është kujdestari kryesor për ta” (22%). Këto deklarata ofrojnë një perspektivë ndryshe nga ato të raportuara në Figurën 2, veçanërisht në lidhje me trajtimin e barabartë të grave dhe burrave.

⁴ Vlera e përqindjes në figurë është rrumbullakosur lart.

⁵ https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Gender%20Pay%20Gap%20RKS%20_compressed.pdf

Figura 61:
Qëndrimet ndaj punësimit




5.2 DISKRIMINIMI NË VENDIN E PUNËS

Kur u pyetën drejtpërdrejt, a jeni ndjerë ndonjëherë të diskriminuara në vendin e punës, vetëm 5.08% e të anketuarave raportuan se janë ndjerë të diskriminuara në vendin e punës, ndërsa 94.91% thanë se kurrë nuk janë ndjerë të diskriminuara. Megjithatë, hulumtimet e konsiderueshme të bëra në këtë fushë⁶

dëshmojnë fenomenin e diskriminimit dhe paparazisë së papranuar edhe në vendin e punës. Hulumtimi tregon se ndërsa⁷ kuadri legjislativ tashmë është gjithëpërfshirës dhe i orientuar në mënyrë progresive, “zbatimi mbetet i dobët”⁸.

Figura 62:
Diskriminimi në vendin e punës



Sipas studimit hulumtues të bërë nga RrGK për Diskriminimin Gjinnor dhe Punën në Kosovë (RrGK, 2022) argumentohet se Ligjit të Punës i mungojnë masat thelbësore të

mbrojtjes për kontratat e punës, detyrat për gratë shtatzëna dhe diskriminimi specifik në punësim. (KWW, 2022, fq.39)⁹.

⁶ (Jose et al., 2017[13]; Komisioni Evropian, 2019[7]).

⁷ <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/d85c7786-en/index.html?itemId=/content/component/d85c7786-en>

⁸ https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/country_level_implementation_plan_gap_iii_kosovo_eng.pdf

⁹ https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2022/04/GBD-La-bour-Kosovo_2022_FINAL-1.pdf

I njëjti raport arrin në përfundimin se:

“Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) nuk ka një përkufizim të qartë të ngacmimit seksual sipas Direktivës së rishkruar; përcaktimet se format e rënda të diskriminimit do të marrin gjoba më të larta; dhe qartësi në lidhje me shkeljen e procedurës për vendosjen e sanksioneve. Ligji për Barazi Gjinore nuk ndalon në mënyrë të qartë format e ndryshme të diskriminimit me bazë gjinore ose nuk vendos sanksione të mjaftueshme për ndalimin e individëve ose punëdhënësve që të përfshihen në diskriminim me bazë gjinore. Në Kosovë mund të gjendet pak jurisprudencë në lidhje me diskriminimin me bazë gjinore dhe punën, gjë që shpjegon mungesën e çdo diskutimi të jurisprudencës në këtë seksion” (f39).

Për të eksploruar më thellë pabarazinë dhe çështjet e diskriminimit, studimi bëri disa pyetje të tjera të synuara.


Përgjigjet tregojnë një mungesë të perceptuar të mbështetjes në krahasim me burrat, ku:

- 7 gra raportuan se kanë marrë më pak mbështetje nga menaxherët në krahasim me kolegët që janë burra,
- 5 raportuan se ato u trajtuan si të papërshtatshme për shkak të gjinisë së tyre,
- 5 raportuan që nuk arrijnë punësohen për shkak se janë gra,
- 4 raportuan se paguheshin më pak se burrat në të njëjtat pozita në punë.

Pak gra (3) gjithashtu raportuan se ishin pushuar nga puna, duke u ndjerë të izoluar dhe duke marrë një detyrë më pak të rëndësishme vetëm për shkak se janë gra. Meqenëse vetëm disa gra deklaruan se kanë përjetuar diskriminim, ne i raportojmë ato në grafikun e mëposhtëm, sipas numrave dhe jo përqindjes. Kjo i referohet gjithsej 5% të grave që deklaruan se ishin të diskriminuara në vendin e punës.

Figura 63:

Raportimet e përvojës së diskriminimit



Deklaratat e diskriminimit u analizuan sipas nivelit të arsimit, duke konfirmuar se sa më i ulët është arsimimi i grave, aq më i lartë është diskriminimi. Fokus grupi

gjithashtu zbuloi diskriminimin e raportuar gjatë punësimit dhe avancimit.

P1: Ka ende shumë pabarazi. Kam studiuar dizajnin industrial dhe kur aplikova për një vend pune, ata nuk më pranuan edhe pse kisha arsimin e kërkuar, por ata punësuan një djalë nga jashtë, të cilin pastaj e dërguan për trajnim. Pra, kjo u kushtoi atyre më shumë punësimin e tij, por ata e preferuan atë, sepse ai ishte një burrë.


P3: Ka shumë diskriminim, edhe personalisht kur shikoj konkurset për vende të lira të punës, sidomos pozitat që lidhen me logjistikën, kompanitë kosovare në përshkrimet për vendin e punës gjithmonë synojnë burrat. Nga ana tjetër, në organizatat e huaja, p.sh., USAID, UNDP, gjithmonë theksohet se nuk ka diskriminim gjinor.

(Fokus Grupi Gjakova, Peja, Deçan, Prizren, Mitrovica, 2022)

Lidhur me institucionet ose personat të cilëve do t'u drejtoheshin për ndihmë dhe mbështetje, shumica e grave thanë se nuk do t'i drejtoheshin askujt të përmendur në

listë (26.69%), 18.64% mund të kërkonin ndihmë nga menaxheri dhe 16.95% do t'i drejtoheshin komisionit për parandalimin e diskriminimit.

Figura 64:
Raportimi i diskriminimit




5.3 AVANCIMI NË POZITAT MENAXHERIALE

Për avancimin në vendin e punës dhe pozitat menaxheriale për gratë, përgjithësisht perceptimi është se kërkojnë shumë mbështetje nga familja dhe institucionet, për shkak të pengesave që gratë përballen në këtë proces. Stili patriarkal pasqyrohet në institucionet publike, si në jetën politike dhe llojin e detyrave që lidhen me 49.25% do të dëshironin të avancoheshin në pozita menaxheriale

dhe arsytet për këtë vetë-kufizim nuk janë të lidhura fort me ngarkesën e rëndë që ato e kanë pozitat drejtuese si, udhëtimi, takimet jashtë orarit të punës, trajnimet dhe pushimet, darkat dhe llojet e tjera të aktiviteteve përgjithësisht shihen si barriera për gratë, pasi ato duhet të kujdesen për të gjitha detyrat që lidhen me shtëpinë, familjen dhe fëmijët, dhe shpesh edhe kujdesin për të moshuarit.


Figura 65:
E gatshme për të avancuar në pozita drejtuese



Përgjigjet nga gratë në këtë studim janë të habitshme, pasi vetëm në përkujdesjen për familjen dhe fëmijët, mungesën e vetëbesimit dhe mungesën e aftësive.


Arsyeja më e zakonshme e deklaruar nga 74.51% e të anketuarave, është "Nuk jam e interesuar për atë lloj të punës"

Figura 66:

Arsyet për të mos marrë pozita drejtuese

Sa më të moshuara bëhen gratë, aq më pak interesim tregojnë për pozita drejtuese.


Figura 67:

Interesimi për t'u bërë menaxhere

Gratë në këtë studim gjithashtu nuk pajtohen se detyrat e kujdesit ndaj fëmijëve janë një nga faktorët që pengojnë gratë që të duan poste të larta, sepse ky faktor i pengon gratë e reja në përgjithësi që të punësohen dhe normalisht do të ishin gratë e reja që dëshirojnë pozita më të larta,

por do të pengoheshin sepse duhet të ndërprisnin punën gjatë pushimit të lehonisë. Të dhënat nga fokus grupet gjithashtu nuk ofrojnë më shumë njohuri për hezitimin e grave për të marrë pozita menaxheriale.

Figura 68:

Ndikimi i pushimit të lehonisë në pozitat drejtuese

5.4 GRATË DHE QËNDRIMET PERSONALE PËR KARRIERËN


Karriera mund të përkufizohet si një udhëtim që një individ bën përmes arsimit formal, informal, joformal dhe punës. Orientimi në karrierë i referohet "informacionit, orientimit dhe këshillimit që synon përgatitjen e studentëve dhe punëkërkuarëve për të menaxhuar karrierën e tyre dhe për të marrë vendime të informuara" (Zel- Loth, 2011, fq. 1; OECD, 2004, fq. 19). Nga perspektiva individuale, zhvillimi i karrierës i referohet aktiviteteve të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të arritur qëllimet personale dhe profesionale. Nga perspektiva institucionale ajo i referohet aktiviteteve të ndërmarra nga akterët në shoqëri për të organizuar orientimin në karrierë, këshillimin dhe zhvillimin. Tre aftësitë më të rëndësishme për zhvillimin e karrierës janë:

- 1) vetëvlerësimi dhe reflektimi;
- 2) kërkimi i mundësive për zhvillim dhe punë (kërkimi

dhe analiza e vendeve të lira të punës, përgatitja e dokumenteve të aplikimit dhe 3) aftësitë e menaxhimit të karrierës që përfshin marrjen e vendimeve dhe veprimeve të informuara për të arritur qëllimet e karrierës.

Gratë në këtë studim raportuan zhvillim të moderuar të karrierës dhe mundësi promovimi në vendin e punës ($m=3.1$). Për sa i përket gatishmërisë për mësim gjatë gjithë jetës me qëllim të aftësimit për t'iu përgjigjur nevojave të vendit të punës, 24.15% e të anketuarave u pajtuan plotësisht, dhe 18.2% u pajtuan me këto deklaratë, ndërsa 22.9% nuk u pajtuan fuqishëm dhe 8.8% nuk u pajtuan me deklaratën, që do të thotë se numri i grave të gatshme për t'u arsimuar për nevojat e vendit të punës është më i lartë se i grave që nuk duan të marrin arsimim të mëtejshëm për nevojat e vendit të punës. 17.5% e grave ishin neutrale në këtë pyetje.


Figura 69:
Gatishmëria për arsimim të mëtejshëm



Më shumë gra **nuk kanë plane** për karrierën e tyre për 5 vitet e ardhshme (25.8% nuk pajtohen aspak dhe 10.2% nuk pajtohen) sesa

ato që kanë një plan karriere për 5 vitet e ardhshme (21.6% pajtohen plotësisht dhe 11% pajtohen), ndërsa 22.6% ishin neutrale.


Figura 70:
Planet e Karrierës



Më shumë gra nuk janë të gatshme të sakrifikojnë veten, me 28.8% që nuk pajtohen aspak dhe 11% nuk pajtohen që nuk pajtohen me deklaratën, "Unë jam e gatshme të sakrifikoj veten në mënyrë që të përparoj në karrierën

time". Gjithsej 17.8% pajtohen plotësisht dhe 9.4% pajtohen me deklaratën. 23.3% ishin neutrale në lidhje me këtë pyetje.

Figura 71:
Gatishmëria për të sakrifikuar për avancimin në karrierë




5.5 E PAPUNË DHE NË KËRKIM TË PUNËS

Sipas Anketës së Fuqisë Punëtore (ASK, 2021), shkalla e aktivitetit në mesin e popullsisë së grave të moshës 15-65 vjeç ishte 22%, ndërsa shkalla e pasivitetit ishte 78%. Të dhënat më shqetësuese nga ky studim janë përqindja e grave me arsim të lartë (32%) që janë të papuna dhe që kërkojnë punë. Të dhënat tregojnë se 52% e grave që kanë 1-5 vjet përvojë duke treguar një pozitë të fundit të punës në këtë periudhë. Këto të dhëna në krahasim me të dhënat e tjera që pritet të publikohen nga ASK do të japin

më shumë informacion në lidhje me shkallën e punësimit dhe punësimin e qëndrueshëm të grave gjatë kësaj periudhe. Një gjetje tjetër e habitshme është se vetëm 6.26% e grave të anketuara kanë ndjekur arsimin joformal gjatë vitit të kaluar, ndërsa 90.44% nuk e kanë ndjekur.

Figura 72:
Dakordimi me deklarata lidhur me gatishmërinë për arsimim të mëtejshëm

1 - fuqimisht nuk pajtohem
5 - fuqimisht pajtohem




Shumica e grave të moshës 30-39 vjeç në vendbanimet urbane (51.72%) pohojnë se kanë njohuri, aftësi dhe shkathtësi të mjaftueshme për të gjetur punë në profesion, pasuar nga ato të moshës 18-29 vjeç (45.1%), ato të moshës 50-59 vjeç (37.5%) dhe më në fund nga ato të moshës 40-49 vjeç (20%). Gjithashtu, gratë e moshës 30-39 vjeç janë të vetëdijshme për dobësitë e tyre dhe janë të gatshme të përmirësohen për të gjetur një punë (61%), pasuar nga gratë e moshës 18-29 vjeç (50%), 40-49 vjeç

(39%) dhe ato të moshës 50-59 vjeç (33%). Numri i grave që shkojnë në trajnime shtesë për të përmirësuar aftësitë e tyre është simbolik për moshat 18-29 vjeç (2%) dhe nuk është fare i pranishëm në pjesën tjetër të grupmoshave. Gratë e moshës 18-29 vjeç prijnë për të pasur një CV të përgatitur mirë (36%), pasuar nga ato të moshës 50-59 vjeç (33.3%), 30-39 vjeç (20.2%) dhe ato të moshës 40-49 vjeç (5.8%).

Figura 73:

Niveli i proaktivitetit sipas moshës në zonat urbane




Në zonat rurale, situata duket të jetë pak më ndryshe sesa në zonat urbane, ku gratë e moshës 18-29 vjeç janë më të përgatitura për të kërkuar punë. Gjithsej prej 67.4% e grave të moshës 18-29 vjeç pretendojnë të kenë njohuri, aftësi dhe shkathtësi të mjaftueshme për të gjetur punë në profesion, pasuar nga 58.3% e grave të moshës 30-39 vjeç, nga ato të moshës 60-65 vjeç (50%), pasuar nga gratë e moshës 40-49 vjeç (37.9%) dhe më në fund ato të moshës 50-59 vjeç (31.25%). Megjithatë, gratë e grupmoshës 30-39 vjeç prijnë në njohjen e dobësive të tyre dhe janë të gatshme të përmirësohen për të gjetur një punë (56.25%). Ato ndiqen nga gratë e moshës 18-29 vjeç (46%), ato të moshës 40-49 vjeç (38%) dhe më në

fund, ato të moshës 50-59 vjeç (28%).

Një numër simbolik i grave shkojnë në trajnime shtesë për të rritur aftësitë e tyre, me ato të moshës 18-29 vjeç që kryesojnë me 9.5% që ndjekin trajnimein, pasuar nga gratë e moshës 30-29 vjeç (6.2%). Gratë e moshës 40-65 vjeç nuk marrin pjesë në asnjë trajnim të lidhur me punën. Shumica e grave të moshës 18-29 vjeç deklarojnë se kanë një CV të përgatitur mirë (64.9%), pasuar nga gratë e moshës 30-39 dhe 60-65 vjeç (50%) dhe më në fund gratë e moshës 40-49 vjeç (26.5%) dhe ato të moshës 50-59 vjeç (18.75%).


Figura 74:
Niveli i proaktivitetit sipas moshës në zonat rurale



Sa i përket vetë-perceptimit të proaktivitetit në kërkimin e punës, 44.28% pajtohen fuqimisht se kanë një CV të përgatitur mirë dhe përgatitje të mirë profesionale, dhe 17.1% pajtohen me këtë pretendim. Vetëm 5% shkojnë në trajnime shtesë për të rritur kapacitetet e tyre profesio-


nale, ndërsa 64% pajtohen plotësisht se i dinë dobësitë e tyre dhe janë të gatshëm të përmirësohen për të gjetur një punë. Së fundi, 55,98% pajtohen plotësisht dhe 20,57% pajtohen se njohuritë, aftësitë dhe shkathtësitë e tyre janë të mjaftueshme për të gjetur një punë.

Figura 75:
Vetë-perceptimi i proaktivitetit në kërkimin e punës



Shumica e grave (62.1%) janë të gatshme të investojnë (në aspektin e financave dhe kohës) në arsimin dhe trajnimin e mëtejshëm, në krahasim me 37.57% që nuk janë gati për investime të tilla.


Figura 76:
Gatishmëria për të investuar në arsimimin e mëtejshëm



Shumica e grave besojnë se nuk ka mundësi të mjaftueshme të trajnimit në Kosovë (39.41%), ndjekur nga ato që nuk kanë njohuri për këtë (31.78%), dhe së fundi,

ato gra që mendojnë se ka shumë mundësi të trajnimit në Kosovë (28.81%).


Figura 77:
Perceptimi për mundësitë e trajnimit



Vetëm 11.44% e të anketuarave përdorin lidhjet politike për të gjetur një punë, ndërsa 16.53% përdorin kontaktet dhe rrjetin e tyre personal. Gjithsej 20.34% dërgojnë CV-të e tyre në organizatat përkatëse dhe 29.24% kërkojnë ndihmë nga njerëzit që janë të suksesshëm në këtë fushë.

Gjithsej 19.49% kërkojnë punë përmes agjencive të punësimit dhe 25.85% e bëjnë këtë duke treguar interesim për kompanitë/punëdhënësit që janë të rëndësishëm për kërkimin e tyre të punës. Shumica e grave (30.53%) përdorin internetin për të kërkuar punë në profesionin e tyre.


Figura 78

Burimet e përdorura për të gjetur një punë

Sa i përket faktorëve që mundësojnë punësim më të lehtë, të anketuarat kanë identifikuar tre faktorët e mëposhtëm të bazuar në meritë dhe jo meritë: niveli i arsimit (62.87%), ndjekur nga ekspertiza (59.93%) dhe kontaktet me njerëzit në pushtet (58.1%). Pjesa tjetër e fakteve përfshi-

jnë të njohurit (familja dhe miqtë) (51.47%), anëtarësimi në një parti politike (49.26%), arsimimi ndërkombëtar ose përvoja e punës (49.16%), fati (43.38%), pamja (28.31%) dhe prejardhja statusi sociale (27.21%).


Figura 79:

Faktorë të rëndësishëm në gjetjen e një pune

Gjithsej 77.2% e grave shqiptare të Kosovës e konsiderojnë sektorin publik si vendin më të përshtatshëm të punës për gratë, pasuar nga 5.6% që zgjedhin sektorin privat

dhe 0.8% zgjedhin sektorin joqeveritar. 8.8% e grave serbe të Kosovës do të preferonin sektorin publik, pasuar nga 0.9% që do të preferonin sektorin privat.

Figure 80:

Sektori më i përshtatshëm i punësimit

5.6 VETËPUNËSIMI


Përqindja e grave që do të fillonin biznesin e tyre është e ulët (28%). Vetëm 3% e të anketuarave kanë raportuar se e kanë tashmë një biznes. Gratë me arsim të lartë (34%)

janë më të gatshme të fillojnë biznesin e tyre sesa gratë me një nivel fillor dhe më të ulët të arsimit.

Figura 81:

Gatishmëria për të filluar një biznes sipas nivelit arsimor


■ Po ■ Jo ■ Unë tashmë kam biznesin tim



Shumica e të anketuarave do të fillonin ose do të kishin filluar një biznes për të përmirësuar statusin financiar të familjes (79.49%), pasuar nga ato që duan pavarësi financiare (76.07%), ato që duan të përmirësojnë gjendjen e tyre financiare (75.21%) dhe ato që duan të rrisin punësimin dhe që duan të kenë liri dhe pavarësi në qasjen

e tyre ndaj punës së tyre (71.79%). Arsye të tjera pse të anketuarat do të ose kanë hapur një biznes përfshijnë ato që duan të përdorin aftësitë, përvojën dhe idetë e tyre (66.67%) dhe ato që hapin një biznes privat e shohin këtë si një sfidë personale (55.56%).


Figura 82:

Arsyet për të filluar një biznes

Të anketuarat u pyetën gjithashtu se si do të financonin biznesin e tyre nëse do të fillonin një. Shumica e të anketuarave (49.88%), do të financonin biznesin e tyre përmes një kredie bankare, pasuar nga përdorimi i fon-

deve familjare (23.08%), kursimet personale (15.38%), programet nga fondet dhe agjencitë e mikro-kredive (14.53%) dhe më së paku, hua prej miqve (5.13%).


Figura 83:

Financimi i biznesit tuaj

Kur u pyetën për renditjen e barrierave që ato i parashikojnë për biznesin e tyre, pengesa me rrezikun më të lartë të identifikuar ishte mungesa e financimit dhe aseteve, si dhe mungesa e masave afirmative për gratë në biznes (49.55%), ndjekur nga mungesa e gatishmërisë për të marrë përsipër rrezikun sipërmarrës (28.57%); mungesa e përvojës (28.07%), mungesa e përvojës

sipërmarrëse dhe mosnjohja me tregjet (25%), mungesa e aftësive sipërmarrëse dhe menaxhuese (24.78%) dhe së fundi, mungesa e njohurive, aftësive, shkathësisë për drejtimin e biznesit të tyre (20.87%). Vlen të theksohet se mungesa e mbështetjes nga bashkëshorti dhe familja e ngushtë u identifikua si pengesa më e ulët me rrezik të lartë për fillimin e një biznesi (10.19%).

Figura 84:
Pengesat për fillimin e një biznesi



5.7 GJENDJA NË ARSIM

Vijueshmëria në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë është e lartë me 100% për arsimin fillor, 91% për arsimin e mesëm të ulët dhe 79.6% për arsimin e mesëm të lartë (MASHTI, 2022). Ka një normë braktisjeje prej 3.4% në arsimin e detyrueshëm që vlen si për vajzat ashtu edhe për djemtë. Ka pjesëmarrje të ulët në arsimin parashkolor për fëmijët pesëvjeçarë me 89% dhe për fëmijët 3-5 vjeç me 37%. Sipas të dhënave të njëjta, 57% e nxënësve në shkollë të mesme janë femra dhe 42% në TAP janë meshkuj. Të dhënat e ASK-së gjithashtu tregojnë një shkallë më të lartë të regjistrimit në nivelin bachelor, master dhe doktoraturë për gratë dhe po ashtu shkallë më të lartë të diplomimit sesa për burrat (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2022).

Të anketuarat në këtë studim u pyetën për pikëpamjet e tyre për arsimin si gra.


Në këtë seksion analizohen pikëpamjet e përgjithshme në lidhje me arsimin, përvojën dhe vlerat e arsimit, si dhe rolet që promovon sistemi arsimor.

5.8 QËNDRIMET PËR ARSIMIN

Për të zbuluar pikëpamjet e përgjithshme mbi arsimin, të anketuarave iu kërkua të vlerësojnë nivelin e tyre të pajtimit në shkallën nga 1 (aspak nuk pajtohem) në 5 (pajtohem plotësisht).

Niveli më i lartë i pajtimit u shpreh për deklaratën, "arsimi është i rëndësishëm për të ardhmen e një gruaje dhe për një jetë më të mirë" ($m=4.32$), pa asnjë ndryshim statistikor për sa i përket vendbanimit, nivelit të arsimit, moshës dhe gjendjes financiare.

Figura 85. .
Pikëpamjet mbi arsimin



Gjithsej 60.3% pajtohen plotësisht dhe 20% pajtohen se arsimi është i rëndësishëm për të ardhmen e një gruaje dhe për një jetë më të mirë. Një pjesë e vogël e grave nuk ishin dakord me këtë deklaratë (6.1%), ndërsa 13.6% ishin neutrale në përgjigjet e tyre. Ekziston një dallim i vogël në lidhje me përkatësinë etnike ku gratë shqiptare kanë një mesatare më të ulët të pajtimit ($m=3.2$) në krahasim me gratë serbe dhe RAE ($m=4.2$). Të dhënat e zbërthyer sipas vendbanimit tregojnë se gratë që jetojnë në zonat rurale (1.6) nuk pajtohen më pak me deklaratën se arsimi është më i rëndësishëm për burrat, sesa për gratë, dhe sesa gratë që jetojnë në zonat urbane (1.2).

Të dhënat e zbërthyer sipas nivelit të arsimit tregojnë se sa më pak të arsimuara të jenë të anketuarat, aq më pak ato nuk pajtohen me këtë deklaratë dhe anasjelltas, aq më shumë të jenë të arsimuara, aq më shumë ato nuk pajtohen me këtë deklaratë. Për shembull, të anketuarat me nivel fillor ose më të ulët të arsimit regjistrojnë një vlerë prej 1.8, ndërsa vlera për të anketuarat me arsim të lartë është 1.3, dhe vlera për të anketuarat me universitet ose nivel më të lartë është 1.2.

Lidhur me deklaratën, “Unë kisha mundësi të përshtatshme për t’u arsimuar” ($m=3.18$), gratë urbane kanë pasur pak më shumë mundësi të përshtatshme për t’u arsimuar ($m=3.39$) sesa gratë rurale ($m=3.06$). Të dhënat ndara sipas moshës tregojnë se mundësitë më të përshtatshme për t’u

arsimuar kishin gratë e moshës 60-65 vjeç (32%), pasuar nga ato të moshës 50-59 vjeç (27.2%), ato të moshës 40-49 vjeç (20.4%), ato të moshës 30-39 (13.6%) dhe më në fund, ato të moshës 18-29 (6.8%). Kjo tregon një rënie të kënaqëshmërisë me mundësitë e arsimit midis brezave të rinj. Gjithsej 7.64% e atyre që kanë përfunduar një diplomë master kanë thënë se kanë pasur mundësi të përshtatshme për arsimim. Përafërsisht 27.07% e atyre që kanë diplomuar thanë të njëjtën gjë, pasuar nga 2.24% e atyre me arsim profesional, 41.08% me shkollë të mesme, 12.74% e atyre që kanë përfunduar arsimin fillor, 3.50% që nuk kanë përfunduar arsimin fillor dhe 5.3% që nuk kanë arsim fare. Të dhënat e zbërthyer për nga përkatësia etnike tregojnë se mundësitë më adekuate për arsim ishin për gratë shqiptare të Kosovës (84%), pasuar nga gratë serbe të Kosovës (10.4%), dhe gratë rome, ashkali dhe egjiptiane të Kosovës (4.8%).

Të dhënat e zbërthyer sipas situatës financiare të të anketuarave nxjerrin në pah trendin e mëposhtëm: 37.6% e atyre që mund të përballojnë mallrat bazike, por kanë nevojë të kursejnë, kanë pasur mundësi adekuate arsimore, pasuar nga ato që mund të përballojnë mallrat bazike, por nuk mund të kursejnë për të ardhmen (28.8%), ato që vështirë mund të përballojnë për të blerë mallra bazike (16.4%), ato që mund të përballojnë gjithçka dhe janë në gjendje të kursejnë (14%) dhe më në fund ato që nuk mund të përballojnë për të blerë mallra bazike (3.7%).





Figura 88:
Pikëpamjet për arsimin sipas nivelit të arsimit





Figura 89:
Pikëpamje për arsimin sipas gjendjes financiare


- ◆ Unë mund të siguroj gjithçka që kam nevojë, dhe mund të kursej
- ◆ Unë mund të përballoj gjithçka që kam nevojë, por duhet të kursej/ekonomizoj
- ◆ Unë mund të përballoj të gjitha të mirat e nevojshme pa sakrificë, por nuk mund të kursej për të ardhmen
- ◆ Mezi i siguroj të gjitha mallrat e nevojshme, ndonjëherë më mungojnë paratë



Të dhënat e ndara sipas situatës financiare tregojnë se të gjitha grupet nuk pajtohen se arsimi është më i rëndësishëm për burrat sesa për gratë. Grupi që më së paku nuk pajtohet me këtë deklaratë është ai që mezi mund të përballojë të gjitha mallrat e nevojshme dhe nganjëherë

mbesin pa para (1.55), ndërsa grupi që kryesisht nuk pajtohet me këtë deklaratë është grupi që mund të përballojë të gjitha mallrat e nevojshme, por nuk mund të kursejë për të ardhmen (1.4).

Figura 90:
Rëndësia e arsimit




5.9 ÇFARË NA MËSON SISTEMI ARSIMOR PËR ROLIN E GRAVE?

Sistemi arsimor luan një rol të rëndësishëm në formimin e vlerave dhe praktikave në shoqëri. Format më të drejt-përdrejta të ndikimit janë kurrikula, tekstet shkollore dhe praktikat mësimore. Kurrikula përkufizohet si "një përzgjedhje nga kultura e shoqërisë", ku njohuritë, qëndrimet, vlerat dhe aspekte të tjera të rëndësishme të jetës shoqërore përzgjidhen nga vendimmarrësit për t'u transmetuar në gjeneratat e ardhshme (Lawton, 1975, fq. 7).

Kurrikula e Kosovës adreson qartë qasjen e të drejtave të njeriut duke përfshirë barazinë gjinore; megjithatë, tekstet shkollore dhe metodologjitë dhe praktikat e mësimdhënies konsiderohen si faktori kryesor në promovimin e vlerave patriarkale. Për shembull, një analizë e teksteve shkollore nga Qendra për Barazi Gjinore, identifikoi praktikën e stereotipizimit tek të gjithë aktorët e angazhuar në shkrimin e teksteve shkollore, duke përfshirë autorët, ilustruesit, recenzentët dhe zyrtarët e ministrisë, duke argumentuar se tekstet shkollore si burimi kryesor për mësuesit kanë ndikim të drejtpërdrejtë në atë se cilat mesazhe transmetohen tek popullata. Në mënyrë të ngjashme, një nga shqetësimet kryesore në lidhje me zbatimin e kurrikulës janë praktikat e mësimdhënies që mbështeten shumë në tekstet shkollore.

Gratë në këtë studim u pyetën se çfarë lloj mesazhesh u ishin imponuar gjatë arsimit të tyre formal. Ato u prezantuan me 11 deklaratë që përmbajnë stereotipe për gratë duke u kërkuar atyre të vlerësojnë dominimin e deklaratës në shkallën prej 1-3, ku 1 nuk është aspak dominues, 2 është mesatarisht dominues dhe 3 është shumë dominues. Rezultatet janë paraqitur duke treguar renditjen e mesazheve më dominuese të raportuara nga gratë.

Figura 91:
Mesazhet e imponuara nga institucionet arsimore Friedman Mean Rank



Mesazhi më dominues i imponuar ishte se “gratë duhet të martohen dhe të kenë fëmijë në vend të një karriere” (45% e grave e vlerësuan deklaratën si shumë dominuese). Ekziston një ndryshim i rëndësishëm në mes moshave, me 62% të atyre të moshës mbi 54 vjeç (shkalla më e lartë)

krahasuar me 32% të grave të moshës 18-29 vjeç (shkalla më e ulët). Gratë me arsimim fillor kanë raportuar se e kanë dëgjuar këtë mesazh më shumë (56%), krahasuar me gratë me arsimim të mesëm (43%), dhe gratë me arsimim të lartë (29%).

Figura 92:
Një grua duhet të martohet dhe të ketë fëmijë në vend të karrierës





Figura 93:

Një grua duhet të martohet dhe të ketë fëmijë në vend të karrierës




Mesazhi i dytë më dominues është, “një grua duhet të jetë e bukur dhe tërheqëse” (40% raportuan se deklarata ishte dominuese) dhe “gratë janë ato që duhet të kujdesen për shtëpinë dhe fëmijët” (39%). Diferenca statistikore u

tregua sipas përkatësisë etnike, me 43% të shqiptareve të Kosovës që thanë se ky ishte mesazh shumë dominues (shkalla më e lartë) krahasuar me përkatësitë etnike tjera të Kosovës RAE (29%), serbet e Kosovës (25%).

Figura 94:

Mesazhet dominuese sipas grupeve etnike



Mesazhi i tretë ishte “gratë nuk duhet të ndryshojnë partnerët” (39% thanë se kjo ishte shumë dominuese dhe 21% disi dominante). Gratë e grupmoshës

mbi 54 vjeç, raportuan se e dëgjonin këtë mesazh në shkallën më të lartë (58%) krahasuar me grupmoshat e tjera.

Figura 95:
Një grua nuk duhet të ndryshojë partnerët ose të ketë shumë, sipas grupmoshës





Figura 96:
Mesazhet dominuese sipas grupmoshës




E katërta është, “gratë duhet të kujdesen për shtëpinë dhe fëmijët”, ku 39% e grave thanë se ky ishte një mesazh shumë dominues dhe 23% e grave thanë se ky ishte një mesazh disi dominues.

Një dallim statistikor vërehet tek gratë e moshës mbi 54 vjeç (57%) dhe gratë me arsim fillor (53%) krahasuar me grupmoshat dhe nivelet e tjera të arsimit.

Figura 97:

Gruaja është ajo që duhet të kujdeset për shtëpinë dhe fëmijët, sipas grupmoshës



Mesazhi i pestë është, “gratë duhet të jenë pasive dhe të qeta” dhe për 32% të grave ky ishte një mesazh shumë dominues. Diferenca statistikore sipas moshës dhe përkatësisë etnike është vërejtur ku gratë e grupmoshës 54+ vjeç raportojnë se e dëgjojnë këtë mesazh në një shkallë

më të madhe (47%), krahasuar me grupmoshat e tjera 18-34 vjeç (25%) dhe 35-54 vjeç (26%). Shqiptaret e Kosovës raportojnë shkallë më të larta për këtë mesazh (34%) krahasuar me serbet e Kosovës (26%) dhe gratë RAE të Kosovës (20%).

Figura 98:

Një grua duhet të jetë pasive dhe e qetë, sipas grupmoshës





Figura 99:

Një grua duhet të jetë pasive dhe e qetë, sipas përkatësisë etnike




Mesazhi i gjashtë ishte “gratë nuk duhet të ndërmarrin rreze” dhe 32% e grave raportuan se mesazhi ishte shumë dominues. Diferenca statistikore vërehet

sipas moshës ku gratë e grupmoshës 54+ vjeç e raportojnë këtë mesazh si shumë dominues (51%) në krahasim me grupmoshat e tjera.

Figura 100:

Një grua nuk duhet të rrezikojë, sipas grupmoshës




Gjithsej 30% e grave u ishte thënë se nuk duhet të flasin për seksin, ndërsa karakteristika më së paku dominuese (49%) është se burrat duhet të kenë/fitojnë më shumë para se gratë. Për 46% të grave, mesazhi që burrat duhet të marrin vendime në marrëdhënie nuk ishte një qëndrim

dominues i inkurajuar, ndërsa për 29% ishte një mesazh shumë dominues. Në fund, vetëm 28% e grave besojnë se qëndrimi që një grua duhet të jetë e zgjuar, por jo shumë e zgjuar ishte një qëndrim i inkurajuar nga sistemi arsimor, kundërt 46% që nuk mendojnë se ky ishte një mesazh dominues.

Figura 101:

Mesazhet e imponuara gjatë arsimimit formal



KONKLUDIME

- **Vetëm 24%** e grave që marrin pjesë në sondazh janë të punësuar (21% të punësuar, 2% të vetëpunësuar dhe 1% të pavarura), ndërsa pjesa tjetër e pjesëmarrëseve janë të papuna (15% të papuna, 10% të pensionuara, të paafta për punë 1% dhe studiojnë 12%).
- Gratë në këtë studim në përgjithësi tregojnë **qëndrime pozitive** ndaj vendit të tyre të punës, sa i përket trajtimit të tyre duke mos raportuar diskriminim dhe se janë mesatarisht të kënaqura me pagat.
- Shumica dërmuese e grave në këtë studim **(95%) treguan se kurrë nuk ishin ndjerë të diskriminuara**.
- Gratë raportuan indiferencë se sa **janë të kënaqura me pagat (40.25%)**, nuk raportuan diskriminim specifik në lidhje me pagat në sektorin publik ose privat, por më të kënaqura me pagat ishin gratë në Prishtinë (m=5) krahasuar me rajonet e tjera (m=3).
- Gratë tregojnë **pak besim në kërkimin e ndihmës në lidhje me diskriminimin** ku më shumë gra (26.69%) nuk do t'i drejtoheshin askujt, 18% do të kërkonin ndihmë nga menaxherët dhe 16% do t'u drejtoheshin komisioneve kundër diskriminimit.
- **Vetëm 49.25% e grave dëshirojnë të avancojnë në pozita menaxheriale**, duke treguar kryesisht pak interes, por pa arsye specifike të identifikuar dhe duke mos rënë dakord që detyrat e kujdesit për fëmijët i pengojnë ato të angazhohen në pozita më të larta.
- Gratë tregojnë **gatishmëri të moderuar për të mësuar gjatë gjithë jetës**. 42.17% e grave pajtohen plotësisht dhe pajtohen në lidhje me gatishmërinë e tyre, 35.8% nuk kanë plane të karrierës për pesë vitet e ardhshme, 32.6% kanë plane për karrierën e tyre në pesë vitet e ardhshme, dhe 39% nuk janë të gatshme të bëjnë sakrifica për avancimin në karrierë.
- Duke parë proaktivitetin e punës, 30.53% përdorin internetin për të kërkuar punë, 25.85% kontaktojnë drejtpërdrejt kompanitë, 29% kërkojnë ndihmë nga njerëz të suksesshëm, 19.49% kërkojnë punë përmes agjencive të punësimit dhe 11.44% përdorin lidhje politike.
- Gratë **nuk janë të informuara dhe nuk kanë pasur qasje në mundësitë e trajnimit** të ofruara në Kosovë. 39.41% besojnë se nuk ka mundësi të mjaftueshme trajnimi, 31.78% nuk kanë informacion për mundësitë e trajnimit, por 62.1% janë të gatshme të investojnë në arsim dhe trajnim të mëtejshëm.
- **Vetëm 6.26% e grave** kanë ndjekur arsimin joformal gjatë vitit të kaluar.
- Tre faktorët më të rëndësishëm (nga 9) për të gjetur një punë janë niveli i arsimit, (62.87%), ekspertiza (59.93%) dhe raportet me njerëzit në pushtet (58%).
- Gratë në përgjithësi preferojnë të punësohen në sektorin publik.
- Vetëm 28% e grave shprehin **interestin për të pasur një biznes**, duke identifikuar barrierat më të larta si, mungesa e financave dhe e masave afirmative për

gratë, pasuar nga mungesa e përvojës dhe mungesa e njohurive dhe aftësive.

- Gratë kanë **qëndrim pozitiv ndaj arsimit** me pajtueshmëri të lartë (m=4.32) se "arsimi është i rëndësishëm për të ardhmen dhe jetën më të mirë të dikujt" me një ndryshim të vogël sipas përkatësisë etnike me gratë shqiptare që raportojnë pajtueshmëri më të ulët (m=3.2) në krahasim me gratë serbe dhe RAE (m=4.2).
- **Gratë urbane kishin mundësi pak më adekuatë të arsimimit** (m=3.6) në krahasim me gratë rurale (m=3.06) me rritje të kënaqëshmërisë për mundësitë e arsimimit në mesin e grave të moshuara.
- Sistemi arsimor formal vazhdon të japë role tradicionale dhe tre mesazhet më të renditura janë: **"gratë duhet të jenë të bukura dhe tërheqëse (40.02%)", "gratë duhet të kujdesen për shtëpinë dhe fëmijët" (39.9%), "gratë duhet të jenë pasive dhe të qeta" (32.1%)**.
- Mesazhet që imponojnë rolet dhe vlerat tradicionale raportohen kryesisht nga gratë më të reja të moshës 18-29 vjeç dhe gratë më të moshuara të moshës 60-65 vjeç, duke treguar praninë e imponimit të mesazhit në sistemin arsimor aktual.
- Mesazhi që gratë duhet të jenë të bukura dhe tërheqëse raportohet më së shumti nga gratë e reja të moshës 18-29 vjeç (30.32%), pasuar nga gratë e moshës 60-65 vjeç (20.45%).
- Ngjashëm, mesazhi që gruaja duhet të kujdeset për shtëpinë dhe fëmijët, është më i përhapur për gratë më të reja (18-29 vjeç, 24.11%) dhe (gratë e moshuara (60-65 vjeç, 22.84%) dhe për gratë rurale (58%) 42% e grave mendonin se gratë duhet të jenë të bukura dhe tërheqëse.

REKOMANDIME

- Rekomandohet **përmirësimi i statistikave** për punësimin e grave në përgjithësi dhe caktimin e tyre në pozita drejtuese dhe borde në sektorin publik dhe privat.
- **Përmirësimi i punësimit** dhe informacionit rreth **mundësive të zhvillimit të karrierës** që synon gratë.
- Krijimi i **programeve të këshillimit të karrierës** që synon gratë.
- Inkurajimi i **sjelljes proaktive për kërkimin e punës** dhe zhvillimin e karrierës.
- Identifikimi i grave për **trajnim të avancimit në karrierë** duke përfshirë edhe pozitën e liderit dhe menaxhimit.
- Informimi i grave **për diskriminimin dhe mekanizmat e mbrojtjes** nga diskriminimi.
- **Sigurimi i trajnimeve** për menaxherët dhe këshillin kundër diskriminimit për të promovuar anti-diskriminimin dhe për të trajtuar rastet e diskriminimit.
- **Sigurimi i mekanizmave** për ndihmë juridike falas në lidhje me diskriminimin në vendin e punës.

- **Monitorimi i** kuotës së **punësimit të** grave sipas Ligjit për Barazi Gjinore, në të gjitha institucionet.
- **Zhvillimi i programeve arsimore formale dhe joformale** me synim fushat për punësimin e grave.
- **Financimi për fillimin e start-up bizneseve** të themeluara dhe në pronësi të grave.
- **Sigurimi i programeve të mentorimit** për gratë sipërmarrëse.
- Të analizohen kurrikulat dhe tekstet shkollore me metodologji specifike dhe mekanizma të miratimit për të **shmangur stereotipizimin gjinor**.
- Kryerja e **hulumtimeve të mëtijshme në institucionet** arsimore në lidhje me politikat dhe praktikat e tyre të barazisë gjinore.
- **Prezantimi i projekteve shkollore** duke u fokusuar në barazinë gjinore dhe parandalimin e stereotipeve me bazë gjinore.

6.

POLITIKA DHE PJESËMARRJA

Një parakusht themelor për barazinë gjinore dhe demokracinë e vërtetë është pjesëmarrja e grave në politikë, e cila çon në angazhim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen publike dhe siguron llogaridhënien. Ekzistojnë kufizime në udhëheqjen e grave dhe pjesëmarrjen politike në nivel lokal dhe global. Ato janë të nënpërfaqësura si votuese dhe nuk marrin pjesë në mënyrë të barabartë në qeverisjen demokratike. Rruga që gratë të mbajnë poste të zgjedhura është arritur përmes përpjekjeve të punës kolektive nga organizatat, dhe jo individët. Për shembull, klubet sociale të grave janë themeluar në shekullin XIX, dhe deri në fund të shekullit, ka pasur një rritje në grupet e grave për politikë (Beckwith, 2000). Organizatat e grave kanë evoluuar kohët e fundit duke u fokusuar në përvojat gjinore të grave, me qëllimin për të rritur ndërgjegjësimin rreth të drejtave të grave dhe për t'i mbështetur ato për të kandiduar.

Në vitin 2021, Republika e Kosovës shënoi fillimin e një kapitulli të ri me zgjedhjet parlamentare me një parti politike që fitoi shumicën në Kuvend. Vjosa Osmani-Sadriu, ishte politikanja më e votuar në historinë e Kosovës. Për më tepër, ka një rekord prej 43 përfaqësuesesh gra në Kuvend nga 120 deputetë, që e ka kaluar kuotën gjinore prej 30%. Përveç kësaj, Atifete Jahjaga ishte gruaja e parë që u zgjodh Presidente në vitin 2011. Pastaj në vitin 2013, në komunën e Gjakovës u zgjodh një grua kryetare, Mimoza Kusari-Lila. Znj. Osmani-Sadriu u zgjodh Presidente nga Kuvendi për një mandat pesëvjeçar. Kjo tregon rolin gjithnjë e më aktiv të grave udhëheqëse në politikë, pa varësisht pranisë së pabarazisë gjinore (Balcani & Transeuropa, 2002).

Edhe pse Kosova deri më tani ka pasur dy gra presidente, mbeten ende çështje për t'u adresuar për të rritur pjesëmarrjen e grave në proceset politike dhe vendimmarrëse. Partitë politike ende përfshijnë në listën zgjedhore gra me qëllim që të përmbushin kuotat, dhe jo t'i fuqizojnë ato si udhëheqëse të ardhshme. Për më tepër, gratë nuk janë të kënaqura me mjedisin politik armiqësor dhe sfidat që lidhen me qasjen në financa dhe mbështetjen politike (NDI, 2021). Prandaj, duhet të bëhen më shumë përpjekje për përparimin demokratik të shoqërisë moderne, duke rritur numrin e grave me role në vendimmarrjen dhe politikëbërjen publike.

6.1 PERCEPTIMET PËR GJENDJEN AKTUALE TË BARAZISË SË GRAVE

Ky studim analizon perceptimin e të anketuarave mbi statusin e barazisë së grave në Kosovë, duke përfshirë shprehjen e pikëpamjeve të tyre politike, interesin për çështjet politike dhe në përgjithësi ndërgjegjësimin e tyre mbi legjislacionin e barazisë gjinore. Të dhënat tregojnë se besimi i grave në ndikimin e proceseve politike në vend është shumë i ulët. Mund të ndodhë që nivelet e ulëta të besimit ose pjesëmarrja e ulët në partitë politike të jenë një cikël i pafund; ose nivelet e ulëta të besimit në lidhje me aftësinë e tyre për të ndikuar në politikë i pengojnë gratë të bashkohen në parti ose shumë pak gra u bashkohen partive politike (p.sh., sepse pa infrastrukturë për kujdesin e fëmijëve dhe të moshuarve, gratë nuk kanë kohë të dalin vullnetare në partitë politike), gjë që mund të rezultojë që ato të kenë pak besim në aftësitë e tyre për të ndikuar në politikë. Aktiviteti politik i grave në Kosovë është shumë i ulët në mesin e të anketuarave të intervistuar të këtij studimi, (3%), ndërsa 97% e tyre kanë deklaruar se nuk janë politikisht aktive. Këto shifra janë shqetësuese duke pasur parasysh se është rritur numri i grave që zgjidhen në parlament pa pasur nevojë për një kuotë gjinore. Votuesit po votojnë më shumë për gratë candidate në zgjedhjet kombëtare. Në zgjedhjet kombëtare të vitit 2022 kishte komuna si Kamenica dhe Gjilani ku më shumë se 42% e numrit të përgjithshëm të votave të hedhura ishin për gratë candidate.

Shumë pak gra theksuan se janë të interesuara apo shumë të interesuara në politikën lokale (11%), pasuar nga politika rajonale (9%), politika kombëtare (8%), politika e Serbisë (8%), politika në përgjithësi (6%), politika e BE-së (7%) dhe politika e SHBA-së (7%). Se interesimi i grave në politikën lokale është më i madh në krahasim me politikën kombëtare apo edhe atë ndërkombëtare, mund të konfirmohet nga pjesëmarrja më e madhe e grave në zgjedhjet lokale sesa zgjedhjet kombëtare. Angazhimi i grave në çështjet publike është në kufijtë e 30%. Gjetjet tona tregojnë se gratë janë pak më aktive në anëtarësimin në organizata joqeveritare, dhe më pak në partitë politike apo edhe shoqatat e biznesit. Anëtarësimi në një parti politike ka një potencial të ulët për t'u rritur, pasi në këtë studim kur kemi pyetur të anketuarat për gatishmërinë e tyre për t'u bashkuar me partitë politike numri doli të jetë shumë i ulët (3%).

Figura 102:
Anëtarësimi në organizata






Figura 103:
Perceptimi për pikëpamjet e veta politike



Rreth 26% e grave i shprehin pikëpamjet e tyre politike brenda familjes, 9% në lagje, dhe me miqtë dhe të njohurit (9%), në rrjetet sociale (4%), në vendin e punës (3%), në partinë politike (2%) dhe në mediat tradicionale, si TV, radio, programe televizive (2%). Është interesante të theksohet se në lidhje me shprehjen e pikëpamjeve politike në vendin e punës dhe në një parti politike, shumica e të anketuarave (midis 73-78%), refuzuan të përgjigjen

ose thanë se nuk ishte e zbatueshme. Këto të dhëna tregojnë se gratë janë më të hapura për të shprehur pikëpamjet e tyre politike në qarqet e ngushta familjare, ku frika nga paragjyrimi është më pak e mundur - sesa në qarqet e jashtme me audiencë më të madhe. Ky hezitim mund të jetë për shkak të frikës së paragjykimit nga të tjerët, ose standardit të lartë që ato ia caktojnë vetes për të paraqitur publikisht mendimet e tyre politike.

Figura 104:

Ku i shprehni më shpesh pikëpamjet tuaja politike?

Shumica e grave të intervistuar (70%) nuk mendojnë se mund të ndikojnë politikën e vendit duke shprehur pikëpamjet e tyre. Ky rezultat tregon interesimin e tyre të ulët për shprehjen e pikëpamjeve politike, pasi ato nuk besojnë se mund të bëjnë një ndryshim. Vetëm 11% e grave mendojnë se duhet të shprehin pikëpamjet politike, pasi ato mund të ndikojnë në politikë në mënyrë efektive. Gjetjet për këtë pyetje gjithashtu mund të interpretohen si përgjigje në pyetjen e mëparshme, lidhur me ngurrimin e grave për të shprehur publikisht mendimin e tyre politik, pasi ato nuk mendojnë se shprehja e pikëpamjeve politike është një masë efektive për të ndikuar në politikë.


Gjetjet rreth ndërgjegjësimit për Ligjin për Barazi Gjinore nuk janë befasuese, pasi gratë që jetojnë në zonat urbane janë pak më të vetëdijshme për ekzistencën e një ligji të tillë, krahasuar me ato në zonat rurale, dhe ngjashëm, gratë me arsim të lartë janë më të vetëdijshme se ato me arsim të ulët. Duhet të theksohet një ndryshim midis të qenit të vetëdijshme për ekzistencën e një ligji të tillë, meqë shumica e grave raportuan (72%) që ishin të vetëdijshme, dhe që kanë njohuri për atë që legjislacioni synon të rregullojë, pasi vetëm më pak se gjysma (42%) raportuan se e kishin njohuri me të ashtuquajturën platformë politike "50/50". Kur i zbërthejmë të dhënat në bazë të nivelit të arsimit, të dhënat tregojnë se sa më i lartë të jetë arsimi, aq më i lartë është ndërgjegjësimi për ekzistencën e Ligjit për Barazi Gjinore, 87% në rastin e grave me diplomë universitare ose më të lartë, 78% e atyre me arsim të lartë, dhe 58% e atyre me arsim fillor ose më të ulët.

Lidhur me vlerësimin e performancës së grave dhe burrave politikanë, gratë raportuan se ato pajtohen plotësisht me këto deklarata:

- Gratë politikanë janë më të paragjykuara, se burrat politikanë (55%);
- Nëse do të kishte më shumë gra në politikë, shoqëria do të ishte më e drejtë (48%);
- Rritja e përfshirjes së grave në politikë ka pasur një ndikim pozitiv në ekonominë e vendit.
- Gratë politikanë janë më të zellshme dhe më punëtore se burrat politikanë (46%);
- Gratë politikanë janë më të ndershme se burrat politikanë (45%);
- Gratë politikanë janë më të guximshme se burrat politikanë (42%); dhe
- Përfshirja e politikanëve femra ka ndikuar në reduktimin e korrupsionit dhe nepotizmit (34%).

Studimi ynë tregon për një mjedis jo miqësor për gratë që janë të përfshira në politikë, pasi rreth 2/3 e tyre mendojnë se gratë janë më të paragjykuara se burrat politikanë. Por nga ana tjetër, ata besojnë se përfshirja më e madhe e grave në politikë do të kontribonte në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe do të kishte një ndikim më të madh në zhvillimin e vendit. Edhe nëse mjedisi politik rezulton të mos jetë i favorshëm për gratë në politikë, ato besojnë se ky mjedis mund të përmirësohet me përfshirjen më të madhe të grave dhe kjo mund të shërbejë për të inkurajuar institucionet që të ndërmarrin masa afirmative që mundësojnë përfshirje më të madhe të grave në politikë.

Figura 105:

Qëndrimet për gratë kundrejt performancës politike të burrave

Edhe pse rezultatet e vlerësimit të performancës së grave kundrejt burrave politikanë janë të ngjashme sipas rajonit, gratë nga zonat urbane raportuan se kanë tendencë të bien dakord më shumë se gratë në zonat rurale për secilën nga këto deklarata. Kur krahasohen gratë me nivele të

ndryshme arsimore, rezultatet për performancën e grave kundrejt burrave politikanë janë të ngjashme. Vlerat janë pak më të larta në rastin e grave më të arsimuara në krahasim me ato më pak të arsimuara.

“Mendoj se duhet të ketë më shumë përfshirje në mënyrë që interesat e grave të përfaqësohen në nivel kombëtar, ndërsa pjesëmarrja është shumë e vogël në nivel lokal”. (Mitrovicë, 28)

“Në një botë ideale, do të doja të mos kishte kuota gjinore fare. (...) “Larg jemi për të arritur në një pikë kur mund të themi se po i heqim kuotat. (Të punësuar në Sektorin e OJQ-ve)

“Unë mendoj se përfaqësimi nuk duhet të kufizohet në 30%, por duhet të jetë 50% sepse mendoj se gratë janë më të guximshme në politikë. Dhe gjithashtu, ne që jemi më pak të përfaqësuar, ende duhet të rrisim nivelin e përfaqësimit.” (Punonjëse e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Gjakovë)

6.2 INTERESIMI PËR POLITIKË DHE PJESËMARRJE POLITIKE


Pas rritjes së nivelit demokratik në kapërcyell të shekullit, autokracitë janë ngadalë në ngritje me rënien e regjimeve demokratike që ndodh edhe në demokracitë më të rrënosura (Bertelsman Transformation Index, Polity IV, V-Dem etj.). Besimi tek institucionet është në rënie. Sa më shumë arsim të kenë qytetarët, aq më pak u besojnë institucioneve.

Cinizmi ndaj politikës po rritet dhe partitë politike nuk shihen si tërheqëse nga të rinjtë për angazhim politik. Kosova nuk bën përjashtim nga këto trende globale. Studiimi ynë tregon nivelin e ulët të pjesëmarrjes politike të grave dhe mungesën e vullnetit për t'u anëtarësuar në një parti politike. Pikëpamjet dhe bindjet politike të grave ndahen ngushtë me burrat në familjen e tyre. 35% e tyre raportuan pikëpamjet dhe bindjet e ngushta ose shumë të

ngushta politike me bashkëshortin/partnerin e tyre, dhe rreth 21% raportuan se nuk kishin pikëpamje dhe bindje të ngushta politike. Në mënyrë të ngjashme, 30% e grave raportuan se kishin pikëpamje dhe besime të ngushta politike me vëllezërit e tyre, ndërsa 30% e tjerë raportuan se nuk kishin pikëpamje dhe besime të ngushta për politikën. 27% e femrave raportuan se ndanin pikëpamje

dhe besime të ngushta politike me babain e tyre, ndërsa 24% thanë jo. 11% raportuan pikëpamje dhe besime të ngushta politike me vjehrrin e tyre, ndërsa 18% raportuan se nuk kanë pikëpamje të afërta. 59% e grave nuk u përgjigjën ose refuzuan t'i përgjigjen pyetjes në lidhje me këtë deklaratë.


Figura 106:

Pikëpamjet politike në krahasim me anëtarët e familjes

Në lidhje me përfaqësimin e interesave të grave në komunitetin lokal, politikën lokale dhe politikën kombëtare, rezultatet nuk janë të kënaqshme. Vetëm 19-20% e grave raportuan se janë të përfaqësuara mirë, ndërsa 24-28% mendonin se interesat e tyre nuk janë të përfaqësuara

mirë. Këto gjetje nuk janë befasisuese duke marrë parasysh nivelin e ulët të përfaqësimit të grave në qeverisjen lokale dhe mungesën e politikave specifike për gratë, si dhe mundësitë për të mbuluar koston e projekteve për gratë nga autoritetet lokale ose komunitetet.

Figura 107:

Interesat e grave të përfaqësuara në nivele të ndryshme

Shumica e të anketuarave (85%) besojnë se duhet të ketë më shumë gra në pozita politike, ndërsa 86% besojnë se duhet të ketë më shumë gra kryetare të komunave; 88% thonë se vendi duhet të ketë një grua kryeministre dhe 91% raportuan se duan një grua presidente.

Gjetjet tregojnë se ka mbështetje të fortë për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë. Mbështetja për gratë në politikën lokale duket të jetë pak më e ulët në krahasim me politikën kombëtare, edhe pse rezultatet zgjedhore të grave nuk janë të kënaqshme në zgjedhjet lokale në kraha-

sim me zgjedhjet kombëtare. Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, në 38 komuna të Kosovës, janë zgjedhur vetëm dy gra kandidatë, edhe pse 86% e të anketuarave në studimin tonë thanë se mbështesin më shumë gra për kryetare të komunave.

Sa i përket zgjedhjes së presidentit të vendit, duket se të të pasurit dy gra në atë pozitë ka ndikuar në nivelet e mbështetjes.

Figura 108:

Qëndrimet për më shumë gra në pozita të larta





Figura 109:

Nëse bëhem anëtare e partisë politike



Gratë në Republikën e Kosovës tregojnë një nivel jashtëzakonisht të ulët të motivimit për pjesëmarrje politike, të pasqyruar në gjetjet se deri në 70% “nuk u intereson fare politika” dhe 16% janë shumë rrallë aktive. Vetëm 1% e grave raportuan një nivel të lartë të pjesëmarrjes politike dhe 13% patën një vetë-perceptim të pjesëmarrjes me performancë të moderuar. Kjo tregon se mungon kultura politike e pjesëmarrjes dhe ekziston ndjenja se ato nuk janë të afta të bëjnë ndryshime në shoqërinë e tyre.

mendojnë se pjesëmarrja e tyre ka rëndësi ose ka shumë rëndësi, dhe së fundmi, 20% raportuan se nuk ka rëndësi nëse ato marrin pjesë apo jo në politikë.

Gjetjet tregojnë se përkundër besimit të fuqishëm se pjesëmarrja e grave në politikë do të kishte një zhvillim pozitiv në vend, ato nuk po marrin pjesë në jetën politike, që është një lloj abstenimi nga përpjekja e barabartë e burrave dhe grave për të zhvilluar vendin.

Më pak se gjysma e të anketuarëve (44%) raportuan se mesatarisht rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë ka një ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit, ndërsa 36%

Figura 110:
Pjesëmarrja e grave ka ndikim pozitiv




Figura 111:
Nëse bëhem anëtare e partisë politike, do ta bëj





Figura 112:
Votimi në zgjedhjet e fundit parlamentare



Shumica e pjesëmarrësve raportuan se arsyeja kryesore pse gratë politikanë janë të përfshira në politikë është për shkak të nevojës së tyre për të ndryshuar shoqërinë për të mirë, ndërsa vetëm 13% besojnë se ato janë të angazhuara për përfitime personale materiale. Gjetjet janë mjaft në kundërshtim me perceptimin e përgjithshëm të politikanëve, të cilët shihen më shumë si njerëz të angazhuar në politikë për qëllime të përfitimit personal sesa për të mirën e përgjithshme. Këto të dhëna janë një tregues shtesë që konfirmon qëndrimin se gratë përgjithësisht shihen si më

pak të korruptuara se burrat.

Vetëm 17% e grave raportuan se do të merrnin pjesë në një protestë në mënyrë që të tregonin mospajtimin e tyre me një politikë të caktuar. Kjo tregon se gratë ndiejnë se nuk kanë fuqi të ndikojnë në ndryshimet për zhvillimin e politikave dhe nuk janë të gatshme të demonstrojnë kundërshtimin e tyre në një formë më të fuqishme. Sipas këtyre të dhënave, gratë kanë më shumë gjasa të arrijnë qëllimet e tyre përmes metodave më të buta.

Figura 113:
A do të pranonit një pozitë politike?





Figura 114:

A do të merrnit pjesë në protestë për të treguar mospajtimin tuaj me disa politika të caktuara?



Shumica e grave raportuan se nëse bëhen anëtare të një partie politike, ato do të angazhoheshin për një ndikim pozitiv në shoqëri (87%), ndërsa vetëm 13% e tyre raportuan se do të bashkoheshin për përfitime materiale personale.


Shumica e të anketuarave (63%) raportuan se nuk do të ishin anëtare të një partie politike dhe vetëm 3% thanë se do të ishin. Kjo tregon se ato ose nuk duan të shpenzojnë kohën dhe energjinë e tyre në një parti politike, ose dyshojnë se zëri i tyre do të dëgjohet.

Niveli i ulët i gatishmërisë së grave për t'u bashkuar me një parti politike ka rezultuar në një hapësirë politike të mbizotëruar nga burrat dhe me këta të fundit që mbajnë shumicën e pozicioneve politike. Nga ana tjetër, partitë politike nuk ofrojnë një mjedis miqësor për gratë dhe nuk kanë ndërmarrë ndonjë masë ose fushatë të veçantë për të tërhequr më shumë gra për t'u bërë anëtare të partive të tyre politike.

Një nivel i ulët i pjesëmarrjes së grave në partitë politike ka dobësuar partitë politike, në kuptimin e formulimit gjithëpërfshirës të politikave të tyre dhe përfaqësimit politik.

Figura 115:

Pse gratë politikane përfshihen në politikë



Shumica e grave raportuan se votuan në zgjedhjet e fundit parlamentare (76%), ndërsa vetëm 23% nuk morën pjesë në procesin votimit të fundit.

Kjo tregon një interes të fortë në mesin e grave që zëri i tyre të dëgjohet, por vetëm në mënyrë anonime.


Shumica e grave që nuk votuan dhanë arsyen se nuk janë të interesuara për politikë (58%), pasuar nga gratë që mendonin se vota e tyre ishte e parëndësishme dhe nuk do të ndryshonte asgjë (21%) dhe ato që raportuan se asnjë ofertë politike nuk i përmbush shpresat dhe kriteret e tyre (10%).

Shumica e tyre (60%) raportuan se votojnë vetëm në bazë të besimit të tyre personal politik dhe vlerave politike, pasuar nga ato që votojnë në të njëjtën mënyrë si anëtarët meshkuj të familjes së tyre (11%), dhe disa të tjera votojnë për përfitime personale (punësim, biznes, etj.) (4%). Vetëm 9% e grave votojnë në mënyrë që çështjet e grave të trajtohen në institucione.

Lidhur me pikëpamjet e grave mbi të drejtën e votës, se 42% raportuan se është një mjet jashtëzakonisht i rëndësishëm për ndikimin politik, pasuar nga ato që e mendojnë atë si një procedurë formale (35%), pastaj ato që e shohin atë si të parëndësishëm (11%) dhe ato që besojnë se është një mundësi e vogël për të shprehur një preferencë politike (12%).

Numri i grave që do të pranonin poste politike është shumë i ulët. Vetëm 1% kanë tashmë një pozitë politike, ndërsa vetëm 7% e tyre njoftuan se do ta pranonin një pozitë të tillë me kënaqësi. Shumica (66%) nuk do ta pranonin një pozitë të tillë.

Figura 116:
Arsyet për të mos votuar



Kjo shkallë e lartë e refuzimit të pozitave politike lidhet me të dhënat e mëposhtme, ku promovimi i grave në politikë shihet të arrihet vetëm me mbështetjen e dikujt të fuqishëm, jo nga merita e tyre.

Rezultatet e deklaratave për qëndrime politike tregojnë dakordim më **të lartë** të raportuar për deklaratat e mëposhtme:

- Kapacitetet dhe cilësitë personale dhe profesionale janë thelbësore për të pasur një pozitë politike (43%);
- Promovimi i grave në arenën politike është rezultat i cilësive të tyre personale dhe profesionale (43%);
- Pozitat politike u jepen ekskluzivisht njerëzve që janë anëtarë të një partie politike (45%);
- Për të pasur një pozitë politike duhet të keni mbështetjen e dikujt shumë të rëndësishëm politikisht (40%); dhe
- Nuk ndjehem kompetente të kem ndonjë qëndrim politik (42%).

- Nga ana tjetër, për këto deklarata janë raportuar mospajtimet më të larta:
- Nxitja e grave në politikë është rezultat i marrëdhënieve familjare (49%);
- Politika është një gjë e "burrave" dhe kjo është arsyeja pse gratë nuk duhet të përfshihen në politikë (62%).
- Një grua duhet të jetë "e pamoralshme" në mënyrë që të jetë pjesë e një pozite politike (68%);
- Promovimi i grave në politikë është rezultat i "favoreve seksuale" të tyre ose dukjes së tyre (69%); dhe unë jam shumë e përfshirë në politikë (71%).

Këto rezultate tregojnë se gratë besojnë se duhet të kenë kapacitetet dhe aftësitë për të pasur një pozitë politike, dhe shumë prej tyre mendojnë se nuk janë të afta. Për më tepër, ato nuk ishin dakord se gratë duhet të jenë të pamoralshme ose të kërkojnë favore seksuale në mënyrë që të kenë një pozitë politike.

Figura 117:
Mendimet për të drejtën e votës




Figura 118:
Kur votoj në zgjedhje





Figura 119:
Deklarata për pozitat politike për gratë




Lidhur me besimin, më shumë se gjysma (53%) e respondenteve raportuan se u besojnë në mënyrë të barabartë politikanëve burra dhe gra. 20% raportuan se nuk u besojnë as burrave dhe as grave politikanë. Megjithatë, 14% treguan se u besojnë më shumë grave në politikë, krahasuar me 3% që u besojnë më shumë burrave.

Kur bëhet fjalë për burimet e informacionit, gjetjet janë

interesante. Gratë po përdorin mediat tradicionale si burim informacioni për ngjarjet politike. Më shumë se dy të tretat e grave përdorin TV (81%) si burim informacioni për ngjarjet politike, pasuar nga Interneti (43%), rrjetet sociale në internet (32%), diskutimet në familje (31%), bisedat me miqtë (21%), gazetat e përditshme (5%), radio (4%), partneri (3%) dhe të tjera (2%).

Figura 120:

Burimet e informacionit për ngjarjet politike



Të dhënat kualitative nga diskutimet e Fokus grupit

“Sapo të hapni Facebook-un ose një portal, do të keni lajme politike në të gjithë botën, gjithashtu edhe në televizion”. (Prizren, 34)

“Si shoqëri, ne jemi jashtëzakonisht të ekspozuar ndaj ngjarjeve të përditshme që ndodhin në politikë, e gjithë kjo për shkak të shumë debateve politike që ndodhin çdo ditë. Dhe në ditët e sotme atyre u jepet mundësia të informohen për zhvillimet në rajon dhe e botë, siç është rasti me luftën Ukrainë-Rusi.” (Prizren, 51).

“Edhe pse jo të gjithë merren me politikë, ne kemi shumë informacion për zhvillimet politike si shoqëri, e gjithë kjo si rezultat i portaleve të ndryshme, debateve televizive, etj., ndaj të cilave jemi jashtëzakonisht të ekspozuar”. (38, Pejë).


Një mendim tjetër nga një pjesëmarrëse ishte se “Ajo që shfaqet në media zakonisht është propagandë e bërë nga partitë politike dhe nuk ka të bëjë me njohuri për politikën, kështu që unë konsideroj se në thelb si shoqëri ne nuk dimë sa duhet për politikën”. (Ferizaj, 44).

6.3 DEMOKRACIA, IDEOLOGJIA DHE VLERAT

Kodifikimi i profilit ideologjik është i vështirë të bëhet në Kosovë meqenëse as partitë politike nuk janë definuar ideologjikisht në mënyrë të qartë, e as fushatat e zgjedhjeve nuk janë fokusuar në ofrimin e zgjidhjeve për problemet shoqërore përmes prizmit ideologjik (D4D, 2021).

Përkundër këtij fakti, analiza tregon se gratë janë të vetë-pozicionuara në qendër (10%). Sidoqoftë, duhet të raportohet se më shumë se gjysma e të anketuarave (57%), nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje, gjë që është një shenjë e qartë e pasigurisë së tyre ideologjike.

Figura 121:
Pikëpamjet politike në lidhje me ideologjinë



Pavarësisht nga vetë-identifikimi ideologjik qendror, humlumtimi është në kundërthënie me disa nga mbështetjet dominuese për politikat e krahut të majtë. Në këtë drejtim, gratë tregojnë dakordësi të fortë për deklaratat e mëposhtme:

“Shteti duhet të marrë përgjegjësi më të madhe për të siguruar të gjithë” (57%);

“Pronësia shtetërore e biznesit dhe industrisë duhet të rritet” (47%), dhe


“Të ardhurat e të varfërve dhe të pasurve duhet të jenë të barabarta” (41%).

Një përqindje më e ulët e grave raportuan se ato pajtohen plotësisht me dy deklaratat e tjera, duke përfshirë:

“Në aspektin afatgjatë, puna e vështirë zakonisht sjell një jetë më të mirë” (31%).

“Konkurrenca është e dëmshme, ajo nxjerr në pah më të keqen tek njerëzit” (25%).

Figura 122:
Pozicionimi ideologjik



Në përgjithësi, gjysma e të anketuarave raportuan një kënaqshmëri të moderuar me demokracinë. Të tjerat rapor-

tuan se janë të kënaqura ose plotësisht të kënaqura (23%), ose tregojnë pakënaqësi të lartë (26%).

Figura 123:
Kënaqshmëria me demokracinë



Në vijim janë disa deklarata me të cilat gratë kanë raportuar pajtim.

Ekzistojnë pajtime dhe pajtime të forta për deklaratat e mëposhtme:

- "Në Kosovë, në këtë moment, ne kemi nevojë për një parti të fortë që do të përfaqësojë popullin e zakonshëm në përgjithësi" (70%);
- "Votimi është një detyrë për çdo qytetar në një shoqëri demokratike." (75%);
- "Ne duhet të kemi një udhëheqëse femër që do ta udhëheqë vendin në drejtimin e duhur" (74%);

- "Opozita politike është esenciale për një demokraci të shëndetshme" (51%); dhe


- "Ne duhet ta kemi një udhëheqëse femër e cila do udhëheq me vendin në drejtimin e duhur (68%).

Megjithatë, të dhënat tregojnë se ka një mospajtim të lartë midis këtyre dy deklaratave të fundit:

- "Në çdo shoqëri ka konflikte që mund të zgjidhen vetëm përmes dhunës" (62%); dhe

- "Në rrethana të caktuara, diktatura është një formë më e mirë e qeverisjes se demokracia" (70%).

Figura 124:
Dakordimi me deklaratat në lidhje me çështjet politike



Kur u pyetën nëse kishin provuar ose do të provonin disa nga angazhimet politike të listuara më poshtë, shumica e grave thanë 'jo':

- "Pjesëmarrje në aktivitete politike online/në rrjete sociale" (jo, 88%);
- "Puna në një parti politike ose grup politik" (jo, 89%);


- "Pjesëmarrja në demonstrata/protesta" (jo, 85%);

- "Nënshkrimi i një liste të kërkesave të politikave/mbështetja e një peticioni online" (jo, 83%);

- "Pjesëmarrja në aktivitetet e vullnetarëve apo shoqërisë civile/organizatat" (jo, 83%); dhe

- "Ndaloni blerjen e gjërave/produkteve për qëllime politike ose mjedisore" (jo, 83%);


Pjesëmarrëset u pyetën gjithashtu për dakordimin me deklaratat e mëposhtme që theksojnë pjesëmarrjen në formate dhe lloje të ndryshme të angazhimit politik.



6.4 PRITJET E ARDHSHEME

Kjo pjesë e studimit analizon pritshmërinë e grave për pozitën e tyre në vend, në 10 vitet e ardhshme. Gjetjet tregojnë optimizëm për përmirësim pasi 70% e të anketuarave besojnë se pozicioni i grave do të përmirësohet,

ndërsa vetëm 4% janë më pesimiste, se do të përkeqësohet dhe 23% janë më neutrale duke besuar se do të mbetet ashtu siç është.



Megjithatë, përmirësimet e gjendjes së grave në vend janë më të lidhura me përparimin e Kosovës drejt aspiratës së saj për t'u bërë anëtare e BE-së. Për më tepër, më shumë se gjysma e respondenteve besojnë se do të ketë një përmirësim për pozitën e grave në vend, kur Kosova të anëtarësohet në BE (53%). Ndërsa 31% u përgjigjën se mesatarisht besojnë, dhe vetëm 9% nuk mendojnë se një përmirësim i tillë do të ndodhë.

Pritshmëritë për zhvillim ekonomik dhe barazi gjinore janë të larta, në rast se Kosova bëhet anëtare e BE-së. Të anketuarat janë dakord se do të ketë një efekt pozitiv në ekonomi (64%), barazi gjinore (64%) dhe në sistemin politik (54%).

Shumë pak (4%) raportuan se efektet negative mund të vijnë nga anëtarësimi i Kosovës në BE dhe disa nuk raportuan asnjë efekt (18-21%). Të dhënat gjithashtu mund të interpretohen si një nivel i lartë i

mbështetjes për integrimin në BE, i cili nuk është vetëm një besim në të njëjtat vlera, por edhe një mundësi për të përmirësuar mirëqenien dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Këto gjetje duhet të trajtohen me shumë kujdes, pasi Kosova ende po lufton për

liberalizimin e vizave brenda Zonës Shengen, duke mbetur vendi i vetëm në Evropë që ende përballet me regjimin e vizave. Përveç kësaj, janë pesë vende të BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, gjë që e bën rrugëtimin e saj edhe më të vështirë.

Figura 127:



Efektet e anëtarësimit të vendit në BE

Figura 128:

Vlerat më të rëndësishme për shoqërinë

Gratë në Kosovë rendisin vlera të ndryshme sa i përket rëndësisë së tyre për shoqërinë. Ndërsa vlerat më të larta

në jetën e tyre personale janë të lidhura me familjen dhe fëmijët, ato mendojnë ndryshe për atë që është e rëndësishme për shoqërinë.

KONKLUDIME

- Analiza e të dhënave tregon rezultatet nga të anketuarat lidhur me politikën. Mund të konkludohet se gratë në Republikën e Kosovës nuk janë të përfaqësuara në politikë në nivel të kënaqshëm, vetëm 3% deklaruan se janë aktive në politikë. Duke marrë parasysh se pjesëmarrja e grave në politikë është parakusht për barazi gjinore dhe demokraci të vërtetë, ky hulumtim tregon se gratë nuk kanë angazhim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen publike dhe zhvillimin e politikave.
- Ka pjesëmarrje shumë të ulët në politikë nga gratë e intervistuar. Gratë e anketuara nuk kanë interesim për shumicën e çështjeve politike. Midis 7-11% e grave theksuan se kanë interesim për politikën lokale, politikën rajonale, politikën kombëtare, etj. Vendet ku gratë kryesisht shprehin pikëpamje politike janë brenda familjes dhe shumë pak në vendin e punës, media apo edhe në parti të politike. Kjo mund të ndikojë në konstatimin se gratë nuk besojnë se mund të ndikojnë në politikë në vendin e tyre duke shprehur pikëpamjet e tyre (70%).
- Sidoqoftë, shumica e grave të anketuara janë të vetëdijshme për ekzistencën e Ligjit për Barazi Gjinore, duke qenë pak më e lartë në mesin e grave që jetojnë në zonat urbane. Gjithashtu, gratë me arsimim më të lartë treguan vetëdije më të lartë për ekzistencën e Ligjit për Barazi Gjinore, krahasuar me ato me arsimim të ulët.
- Ka një interesim të ulët për situatën globale të barazisë së grave në mesin e grave, dhe vetëm 33% ndjekin atë që po ndodh. Rreth 42% njohin "platformën politike 50/50". Gjithashtu, më pak se gjysma raportuan se ato i kanë të njohura kuotat obligative ligjore për pjesëmarrjen e grave në politikë në parlament.
- Shumica e grave pajtohen se performanca politike e grave është më e paragjykuar se e politikanëve burra; por ato mendojnë se shoqëria do të jetë më e mirë me më shumë gra në politikë dhe do të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit; gratë politike shihen si më të zellshme, punëtore, të ndershme dhe të guximshme sesa burrat politikanë; gjithashtu, zvoglimi i korrupsionit dhe i nepotizmit arrihet kur ka më shumë përfshirje të grave politike. Edhe pse rezultatet janë të ngjashme, gratë nga zonat urbane kanë raportuar se ato kanë tendencë të jenë më shumë dakord, se ato në zonat rurale për secilën nga këto deklarata. Vlerat janë pak më të larta në rastin e grave më të arsimuara në krahasim me ato më pak të arsimuara.
- Shumica e grave refuzuan t'i përgjigjen pyetjes rreth nivelit të afërsisë së pikëpamjeve dhe besimeve politike të grave me njerëzit në komunitetet e tyre.
- Megjithatë, disa raportuan pikëpamje dhe besime të afërta politike me burrin/partnerin, vëllain dhe babanë e tyre. Për më tepër, respondentet mendojnë se interesat e grave janë të nënpërfaqësuara në komunitetin lokal, politikën lokale dhe politikën kombëtare. Për më tepër, shumica e respondentëve besojnë se më shumë gra duhet të angazhohen në politikë, më shumë gra duhet të jenë kryetare komunash, si dhe kryeministre dhe presidente.
- Lidhur me votimin në zgjedhjet e fundit parlamentare, shumica e tyre deklaruan se kanë votuar, që do të thotë se mendojnë se ky është obligim i secilit qytetar, dhe për faktin se është një proces anonim. Arsyeja kryesore pse ato votojnë në zgjedhje është vetëm në bazë të besimit të tyre personal politik dhe vlerave politike. Të tjera që nuk votuan thanë se nuk janë të interesuara për politikë. Për më tepër, gratë raportuan pikëpamjet e tyre mbi të drejtën e votës dhe shumica e tyre deklaruan se ajo është një mjet jashtëzakonisht i rëndësishëm për ndikimin politik.
- Shumica e respondentëve deklaruan se nuk do ta pranonin ndonjë rol politik. Ato mendojnë se për të pasur një rol politik duhet të kenë mbështetjen e dikujt shumë të rëndësishëm politikisht dhe nuk ndihen se janë të afta për të mbajtur një pozicion të tillë politik. Këto rezultate tregojnë se gratë kanë pritshmëri të larta nga njerëzit që mbajnë poste politike, duke besuar se duhet të kenë kapacitetet dhe aftësitë për rolin, dhe shumë prej tyre mendojnë se nuk janë të afta.
- Shumica e respondentëve deklaruan se u besojnë burrave dhe grave në politikë në mënyrë të barabartë. Burimet kryesore të informacionit për ngjarjet politike që gratë raportuan janë TV-ja, interneti, rrjetet sociale online dhe diskutimet në familje.
- Shumica e respondentëve nuk iu përgjigjën pyetjes se ku pozicionohen, dhe vetëm 10% janë vetë-pozicionuar në qendër. Për më tepër, shumë gra ranë dakord se duhet të ketë një përgjegjësi më të madhe në vend për t'i siguruar të gjithë; rritje të pronësisë shtetërore të biznesit dhe industrisë; si dhe më shumë të ardhura të barabarta midis të pasurve dhe të varfërve. Gjysma e respondentëve raportuan për një kënaqëshmëri të moderuar me demokracinë.
- Shumica e respondentëve besojnë se pozita e grave mund të përmirësohet në 10 vitet e ardhshme, si dhe kur Kosova të anëtarsohet në BE. Efektet e anëtarësimit të Kosovës në BE do të ishin pozitive për ekonominë, barazinë gjinore, si edhe sistemin politik.

REKOMANDIME

- Partitë politike duhet të krijojnë një mjedis më miqësor për gratë, duke i promovuar ato në pozita ekzekutive brenda partive, duke futur kuota gjinore për pozitë kyçe të partive, duke ofruar trajnime për të rritur aftësitë e komunikimit dhe udhëheqjes, dhe duke organizuar fushata specifike për gratë e interesuara për t'u bashkuar me partitë politike.
- Partitë politike duhet të zhvillojnë politika të brendshme për shpërndarje të drejtë të burimeve financiare midis kandidatëve që garojnë në zgjedhje, ku duhet të parashikohen veprime afirmative për gratë candidate (D4D, 2021)¹⁰.
- Programet dhe manifestet politike të partive politike duhet të parashikojnë politika të veçanta për avancimin dhe promovimin e grave në shoqëri, derisa të arrihet barazia gjinore. Gjatë hartimit të politikave, gratë duhet të përfshihen në të gjitha fazat e konsultimit.
- Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve publike dhe organizatave që nxisin fuqizimin e gruas.
- Duhet të merret parasysh organizimi i takimeve periodike për bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe shkëmbimin e përvojave.
- Forcimi i rrjetëzimit midis organizatave të grave, shoqërisë civile, si dhe qeverive lokale dhe qendrore për të zhvilluar dhe shpërndarë mesazhe të ndjeshme gjinore.
- Të garantohet që ka një kornizë ligjore të përshtatshme që siguron pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në politikë; Futja e kuotës gjinore 50/50 në listën e kandidatëve të partive politike duhet të merret parasysh në reformën zgjedhore krahas 30% të vendeve të garantuara në parlament.
- Mediat duhet të angazhohen për të siguruar më shumë hapësirë për gratë në debatet politike. Asnjë debat politik televiziv nuk duhet të mbahet me të gjithë të ftuarit burra.

¹⁰ D4D, Kostoja e pabarazisë: Financimi për fushatat zgjedhore të grave candidate; https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2021/09/2021-07-27-D4D_Raporti-02-ENG.pdf

7.

TË QENIT E SIGURT DHE SIGURIA

Është e njohur se roli dhe kontributi i grave në të gjitha dimensionet e jetës shoqërore është i rëndësishëm, duke përfshirë edhe mbrojtjen dhe sigurinë. Pjesëmarrja kuptimplotë e grave si agjente aktive në hartimin dhe zbatimin e politikave të sigurisë është thelbësore pasi ato përfaqësojnë 50 përqind të popullsisë. Kjo i bën ato një pjesë vitale të shoqërisë dhe pa to, siguria reale dhe e qëndrueshme në nivel lokal dhe kombëtar nuk mund të arrihet. Për më tepër, gratë sjellin përvoja dhe pikëpamje të ndryshme të një pjese më të gjerë të shoqërisë, të cilat mund të çojnë në zhvillimin e kornizave të forta rreth barazisë gjinore. Megjithatë, ky kontribut shpesh është i nënvlerësuar dhe jo mjaft i shfrytëzuar, pasi gratë mbeten ende të nënpërfaqësuar në pozitat politike dhe vendimmarrëse, përfshirë sektorin e sigurisë.

Kjo u theksua më tej në raportin global të matjes - Indeksi i Grave, Paqes dhe Sigurisë (WPS, George Town Institute for Women, Peace and Security; Peace Research Institute Oslo., 2021), i cili lidh njohuritë nga indekset gjinore dhe të zhvillimit me ato nga paqja dhe siguria. Për herë të parë, Kosova u përfshi edhe në raportin e fundit të indeksuar të rangimit të 2021/2022¹¹, i cili analizoi mirëqenien sociale dhe fuqizimin ekonomik të grave në 170 vende të botës. Kosova u rendit në vendin e 77-të në renditjen e përgjithshme të kësaj liste, që është një tregues se nevojitet përparim i fuqishëm për të përmirësuar këtë pozicion në lidhje me barazinë gjinore dhe mirëqenien sociale.

Një studim mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave i kryer nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (2019) zbuloi se shpeshësia e rasteve të dhunës ndaj grave në Kosovë mbetet kritike. Siç dëshmohej në raport, dhuna psikologjike ishte forma më e përhapur e dhunës ndaj grave në marrëdhëniet intime, ku 53% e respondenteve të anketuara raportuan se kanë

qenë viktimë e kësaj dhune. Sa i përket ngacmimit seksual, 29% e respondenteve të anketuara pohuan se kishin përjetuar këtë formë të dhunës që nga moshën 15 vjeç. Ndërsa 14% treguan se ato kanë përjetuar një lloj dhune fizike ose seksuale nga partnerët e tyre ose individë të tjerë që nga moshën 15 vjeç¹².

Sipas të njëjtit studim, 48% e grave të anketuara ende i konsiderojnë këto forma të dhunës dhe veçanërisht dhunën në familje, një çështje private, kështu që dhuna me bazë gjinore shpesh vazhdon të fshihet dhe të mos raportohet kurrë. Ka pasur gjithsej 1,986 raste të dhunës në baza gjinore të raportuara nga Policia e Kosovës në vitin 2021. Ndërsa, në gjysmën e parë të vitit 2022, u regjistruan gjithsej 1,324 raste të dhunës me bazë gjinore. Kjo situatë kërkon një përgjigje sistematike dhe të harmonizuar nga autoritetet përkatëse në vend, përmes ndërtimit të politikave që parandalojnë dhunën me bazë gjinore.

Lufta kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave është renditur si prioritet në programin katërvjeçar të qeverisë së Kosovës. Ndërsa programi i Ministrisë së Drejtësisë ka përcaktuar parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si një nga 5 objektivat strategjike. Si përgjigje, janë parashikuar disa nisma si politikat kombëtare për përmirësimin e kornizës ligjore me veprime konkrete dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të tjera strategjike që synojnë të përafrohen me standardet përkatëse ndërkombëtare dhe instrumentet e tyre të ratifikuara. Më konkretisht, veprimet e parashikuara në Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare 2022-2026 për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave (Ministria e Drejtësisë, Republika e Kosovës, 2022) mbështesin fuqimisht zbatimin e neneve dhe dispozitave të standardeve që rrjedhin nga Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur si “Konventa e Stambollit”, e cila është gjithashtu pjesë e kushtetutës së vendit që nga viti 2020. Megjithatë, një nga boshllëqet kryesore të identifikuar në strategjinë kombëtare, Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për mbrojtjen nga dhuna në familje nuk zbatohen plotësisht, kryesisht për shkak të mungesës së koordinimit midis institucioneve.

¹¹ Indeksi kap dhe përcakton tre dimensionet e përfshirjes së grave (ekonomike, sociale, politike), drejtësisë (ligjet formale dhe diskriminimi informal) dhe sigurisë (në nivel individual, komunitet dhe shoqëror) përmes 11 treguesve për të ndërtuar një renditje globale të 170 shteteve.
<https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2021/11/WPS-Index-2021.pdf>

¹² Anketa për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë, Misioni i OSBE-së në Kosovë, 2019.
www.osce.org/files/f/documents/d/c/439781.pdf


Sa i përket sigurisë, gratë në Kosovë pavarësisht përkatësisë etnike ndihen më të sigurta në shtëpitë e tyre përkatëse, ndërsa rezultatet ndryshojnë shumë në kategoritë tjera midis etnive, ku gratë serbe ndihen më pak të sigurta në rrugë dhe në përgjithësi në vend. Kjo gjithashtu lidhet me të dhënat e Pulsit Publik të kryera në prill 2022, ku u raportua se kishte një rritje të perceptimit të sigurisë në aspektin e dhunës dhe krimit në mesin e grave shqiptare, por një rënie të lehtë në perceptimin e sigurisë në mesin e grave serbe¹² (UNDP, 2022). RAE, ndihen të pasigurta kur udhetojnë jashtë vendit. Gjithashtu, shkalla e sigurisë

ndryshon midis grupmoshave të ndryshme, ku gratë e moshës 54 vjeç e lart shprehin ndjenjë më të lartë të sigurisë në vendet përkatëse, sesa gratë e moshës 18-34 vjeç.

Kërcënimet më të mëdha të perceptuara të sigurisë për gratë e Kosovës, sipas respondenteve konsiderohen sulmet terroriste dhe lufta, pasuar nga grabitja e shtëpive dhe sulmi fizik apo i armatosur jashtë shtëpive të tyre. Kërcënimet më të ulëta të perceptuara janë dhuna në familje, grabitja jashtë shtëpisë së tyre dhe ngacmimi në vendin e punës.

Figura 129:

Kërcënimet më të mëdha të perceptuara për sigurinë




Perceptimi i kërcënimit të sigurisë ndryshon shumë midis individëve që në fakt janë përballur ose kanë qenë dëshmitarë të një konflikti të armatosur dhe atyre që nuk kanë pasur një përvojë të tillë. Të dhënat tregojnë një korrelacion midis përballjes ose të qenurit dëshmitar i një konflikti të armatosur me perceptimin e luftës dhe terrorizmit si

kërcënimin më të madh të sigurisë. Kosova përjetoi një konflikt të armatosur në vitet 1998-1999 dhe shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008. Rrjedhimisht, 29.40% e grave të Kosovës thanë se janë përballur ose kanë qenë dëshmitarë të një konflikti të armatosur.

Figura 130:

Dëshmitarë ose e ballafaquar me një konflikt të armatosur




*rezultatet për pakicat e tjera janë vetëm indikative

Një përvojë e konfliktit të armatosur ishte e shprehur më shumë midis grave shqiptare, e ndjekur nga gratë e etnisë serbe, ndërsa një përvojë e ngjashme ishte më e ulët

për gratë e komuniteteve të tjera etnike. Më shumë gra që i përkasin grupmoshës 54 vjeç e lart kanë përjetuar konflikt të armatosur.

Figura 131:


Kërcënimet më të mëdha të perceptuara për sigurinë/ Dëshmitare e konfliktit të armatosur sipas moshës



Pjesëmarrëseve iu kërkua të rendisnin aspektet/vendet/ situatën më të sigurt për gratë në Kosovë.

Figura 132:

Vendet më të sigurta të perceptuara



**rezultatet për pakicat e tjera janë vetëm indikative*

Mund të shihet se ka një dallim midis grupeve etnike të ndryshme në lidhje me vendin ku ato konsiderohen pak a shumë të sigurta. Komuniteti serb duket se ndihet më pak i sigurt në pothuajse të gjitha vendet, përveç në vendin e punës, ndërsa shqiptarët e Kosovës duket se ndihen mjaft të sigurt, në pothuajse të gjitha vendet dhe më të sigurtë në shtëpitë e tyre.

Përgjigjet ndaj pyetjeve të hapura, "sa të sigurta mendojnë se janë gratë në Kosovë?", dhe "cila është situata më kërcënuese në aspektin e sigurisë për gratë në Kosovë?" në diskutimet në fokus grupe me gratë përfaqësuese të profesioneve dhe institucioneve të ndryshme, ato e specifikojnë ekzistimin e dhunës me bazë gjinore si një nga kërcënimet më të mëdha për popullsinë femërore, kryesisht në shtëpitë e tyre, në rrugë dhe më pas në vendin e punës.

“Do të vazhdoja me këtë renditje: shtëpi, punë, pastaj rrugë, lagje, transport, i shoh më shumë njëkohësisht” (P1, 2022).

“Unë mendoj se gratë nuk janë aspak të sigurta, duke filluar nga mjediset familjare deri te rrugët publike. Vajzat që fillojnë shkollën e mesme, kur arrijnë në një moshë të caktuar, mendoj se nuk janë të sigurta” (P6, 2022).

“Mendoj se problemi kryesor është dhuna në familje. Në vendin e punës mund të ndodhë këtë ngacmim, por më shumë në kompanitë private. Dhe mendoj se nuk është e kufizuar vetëm në vendin e punës. Duhet të krijohet një mjedis më i sigurt që i lejon të gjithë të raportojnë një rast dhune ose ngacmimi.

Megjithatë, jo të gjitha shtëpitë e grave janë vende të sigurta dhe kjo tregohet nga statistikat. Vetëm vitin e kaluar, 54 gra vuajtën nga dhuna në familje që përfundoi me fatalitet. Ka shumë raste që nuk raportohen, për shkak të stigmës që ndodh në shoqëri, dhe mungesës së besimit në institucione për shkak të mosmarrjes në mënyrë më serioze me rastet e paraqitura. Sa i përket ngacmimit seksual, ne si gra jemi të ekspozuara duke filluar nga lagjia, shkolla, rruga, vendi i punës” (P2, Prishtinë, 2022).

Gratë, si në rrugë ashtu edhe në shtëpi, nuk janë të sigurta në vendin tonë. Edhe vajzat e reja, kemi pasur vajza të reja që janë dhunuar, shfrytëzuar në të gjitha aspektet” (P5, Prizren, 2022).


“Personalisht, u ndjeva mjaft e kërcënuar në punë, derisa m'u desh të blija një unazë për ta mbajtur për të lënë përshtypjen se jam e fjuar dhe kështu anashkaloj ngacmimet seksuale” (P1, Prishtinë, 2022).

Ky informacion është në përputhje me rezultatet e studimit të OSBE-së 2019, mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë, në bazë të të cilit të paktën 53% e grave të anketuara përjetuan dhunë psikologjike nga partneri i tyre intim dhe 29% përjetuan ngacmim seksual. Sipas një studimi global nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin e kryer në vitin 2019, pothuajse 3 në 5 gra të vrara janë vrarë nga partnerët ose anëtarët e familjes së tyre në vitin 2017¹⁴ (UNODC, 2019).

Ndërsa OBSH raporton se në mbarë botën, 1 në 3 gra kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale, zakonisht nga një partner intim¹⁵ (WHO, 2013). Gjithashtu verifikuam rajonet e ndryshme, se si ndihen gratë nga rajone të ndryshme për sigurinë e vendeve/situatave të ndryshme. Ka dallime, për shembull, gratë nga Ferizaji ndihen më pak të sigurta në pothuajse të gjitha vendet e listuara, në krahasim me rajonet e tjera.

Figura 133:

Vendet më të perceptuara të sigurta sipas rajonit



¹⁴ Studimi Global mbi Vrasjet 2019, UNODC, 2019
<https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/gsh/Booklet1.pdf>


¹⁵ Vlerësime globale dhe rajonale të dhunës ndaj grave, OBSH, 2013

Në pyetjen: Cila nga situatat e mëposhtme mendoni se është një kërcënim/rrezik potencial për mbrojtjen /sigurinë tuaj dhe deri në çfarë mase..?, gratë e vlerësuan atë ndryshe, bazuar në përkatësinë etnike dhe rajonin. Frika e një

lufte të mundshme dhe sulmi terrorist dominon, veçanërisht për gratë nga Prishtina. Duke krahasuar pikëpamjet e grave bazuar në përkatësinë etnike, gratë serbe gjithashtu i tremben një lufte të mundshme.

Figura 134:

Cila nga situatat e mëposhtme mendoni se është një kërcënim/rrezik potencial për sigurinë tuaj dhe në çfarë mase?



7.1 MBROJTJA FIZIKE DHE SIGURIA

Një përqindje shumë e vogël (5%) e 36 prej 1000 grave në këtë studim raportuan se kishin përjetuar një lloj lëndimi, ku dominon lëndimi fizik (63%), pasuar nga lëndimi emocional (61%), lëndimi psikologjik (48%) dhe dëmi financiar (17%). Ndërsa 96% e grave të anketuara deklaruan se nuk kanë frikë nga dikush që përpiqet t'i lëndojë.


Lidhur me dhunën në familje, 42 respondente (5%) kanë pranuar se kanë qenë viktimë të dhunës në familje, nga këto gra 81% nuk e kanë raportuar atë. Përqindja më e lartë e atyre që deklaruan se ishin viktimë të dhunës në familje ishin ato nga komuniteti RAE (3%) dhe përqindja më e ulët është tek gratë shqiptare dhe serbe me (2%). Rezultatet janë

të ngjashme kur krahasohen me grupmosha të ndryshme.

Për më tepër, vetëm tri respondente kanë qenë viktimë të dhunës seksuale, nga të cilat vetëm njëra e ka raportuar atë. Sipas kësaj, raportimi i rasteve të dhunës seksuale ka qenë në rënie në vitet e fundit. Ndërsa raportimi mbi përpjekjet e rasteve të sulmeve seksuale është edhe më i ulët sipas një studimi mbi reagimin e policisë të kryer nga disa organizata joqeveritare nën udhëheqjen e Koalicionit për të Drejtat e Barabarta (KDB). I njëjti raport thekson një prirje të ngjashme të raportimit për sulmet e përdhunimit dhe tentativat për përdhunim.

Figura 135:


A është përpjekur dikush ndonjëherë t'ju lëndojë fizikisht?



Kjo sipas të njëjtit studim është kryesisht për shkak të "stigmatizimit të gjerë dhe fajësimit të viktimave nga Policia e Kosovës, mungesës së konfidencialitetit mbi identitetin e viktimave, mungesës së shërbimeve të specializuara


që çojnë në mbështetje të tepruar në mostrat dhe testet e ADN-së, dhe mungesës së udhëzimeve dhe mekanizmave bashkëndues të ngjashëm me ata për dhunën në familje"¹⁶ (KDB, 2019, fq. 14).

Figura 136:
Si është përpjekur ai/ajo t'ju lëndojë?



* shumëfisht opsione

Figura 137:
A keni frikë se dikush mund t'ju lëndojë?



Vetëm 5% e grave të reja deklaruan se kanë frikë se dikush mund t'i lëndojë. Dy dekada më parë, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (i referuar si UNSCR 1325). Rezoluta është një instrument ligjor që njeh rolin vendimtar të grave në përpjekjet për ndërtimin e paqes dhe në ruajtjen e sigurisë në nivel lokal dhe kombëtar duke synuar përfshirjen e grave në të gjitha aspektet dhe praktikatat e sektorit të sigurisë. Më e rëndësishmja, ajo gjithashtu promovon barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si një faktor vendimtar për paqen dhe sigurinë në mbarë botën.

Që atëherë, autoritetet kosovare kanë ndërmarrë disa veprime për të siguruar barazinë gjinore, si për shembull

miratimin e Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjit Kundër Diskriminimit dhe vetë ndryshimin e Kushtetutës, dhe kanë ngritur institucione për të promovuar pjesëmarrjen e grave në proceset vendimmarrëse.

Në nivel të kuvendit, ekziston një komision përgjegjës për trajtimin e barazisë gjinore, ndërsa Institucioni i Avokatit të Popullit angazhohet në çështjet e diskriminimit me bazë gjinore. Programi për Barazi Gjinore 2020-2024, përcakton barazinë gjinore si një e drejtë themelore dhe një nga faktorët e rëndësishëm për rritjen ekonomike, zhvillimin dhe stabilitetin në shoqëri¹⁷.

¹⁶ DHUNA NË BAZË GJINORE NË KOSOVË, Një rishikim kritik i reagimit të policisë, 2019. https://kgscenter.net/site/assets/files/1742/gender_base_violence_eng-1.

¹⁷ Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/AGE%20Kosovo%20Program%20for%20Gender%20Equality%202020-2024.pdf>

Më e rëndësishmja, në vitin 2014, Qeveria e Kosovës gjithashtu miratoi Planin Kombëtar të Veprimit (PKV)¹⁸ për zbatimin e Rezolutës 1325¹⁹ të KS të OKB-së, e cila synon të përmirësojë dhe të sigurojë pjesëmarrjen aktive të grave në vendimmarrje dhe forcat e sigurisë në të gjitha nivelet, së bashku me sigurimin e qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës.

Megjithatë, ende nuk është e qartë se cili institucion është përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të planit. Për më tepër, plani u hartua fillimisht për të mbuluar periudhën 2014-2017, dhe një plan i ri ose i modifikuar ende nuk është hartuar.


Përpjekjet për të promovuar barazinë gjinore dhe për të siguruar pjesëmarrjen e grave në proceset e përditshme të ndërtimit të paqes dhe sigurisë janë për t'u admiruar, por mbetet shumë për t'u bërë. Bazuar në raportin vjetor nga Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes, 2020,²⁰ nga Agjencia për Barazi Gjinore, përfaqësimi i grave në pozita të larta udhëheqëse në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes është përmirësuar, megjithatë, mbetet shumë i ulët në krahasim me numrin e burrave të caktuar në pozita udhëheqëse në sektor.

Nga gjithsej 48 pozita udhëheqëse në Ministrinë e Mbrojtjes (MM), vetëm dhjetë (10) prej tyre janë gra, 2 prej të cilave udhëheqin departamentet ndërsa shtatë (7) udhëheqin njësitë. Mbi 10.91% e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë gra dhe vajza kosovare në uniformën e Ushtrisë së Kosovës. Në vitin 2020, kishte një femër që mbante gradën më të lartë ushtarake si një gjeneral brigade, katër gra në rangun e nënkolonelit dhe pesë majore që tregon përmirësim përmirësim gjatë viteve.

Shumica e të anketuarave (71%) janë dakord se gratë duhet të kenë një përfaqësim më të madh në ushtri. Këto të dhëna lidhen me ndjenjën e sigurisë së respondenteve për vendosjen e grave në pozita kyçe të sigurisë kombëtare dhe 48.10% e respondenteve u përgjigjën se do të ndiheshin më të sigurt me përfshirjen e grave në pozita të tilla të sigurisë, duke treguar se politikat e sigurisë të Kosovës varen nga përfaqësimi gjinor i grave dhe kontributi i tyre i rëndësishëm në zgjidhjen e konflikteve, paqen dhe proceset e sigurisë. Të njëjtin nivel besimi për përfaqësim më të madh të grave në ushtri, polici dhe institucione të tjera të sigurisë e kanë edhe gratë e bashkësive të ndryshme etnike dhe grupmoshave të ndryshme.

Figura 138:

A do të ndiheshit më të sigurt nëse gratë do të vendoseshin në pozicione vendimtare që lidhen me sigurinë e vendit (mbrojtja, ushtria, policia, CMC, etj.)



**rezultatet për pakicat e tjera janë vetëm indikative*

Gratë nga të gjitha grupmoshat janë në favor të vendosjes së grave në pozita vendimtare në institucionet e sigurisë.


¹⁸Plani Kombëtar i Veprimit i Kosovës 2014 <https://www.wpsnaps.org/app/uploads/2019/09/Kosovo-NAP-2013-2015.pdf>

¹⁹Resolution 1325, 2000. Adopted by the Security Council https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/SC_Resolution-WomenPeaceSecurity_SRES1325%282000%29%28english_0.pdf

²⁰ Raporti Vjetor i Njësies për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes, 2020. Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit.

Figura 139:

A do të ndiheshit më të sigurt nëse gratë do të vendoseshin... sipas grupmoshave



KONKLUDIME

- Pothuajse të gjitha gratë e anketuara në këtë studim (m=4.6 ose 90%) theksuan **ndjenjën e sigurisë në shtëpitë e tyre përkatëse**, pavarësisht nga të dhënat nga burimet dytësore që tregojnë një shkallë të lartë të abuzimit familjar dhe psikologjik të shkaktuar nga partnerët e tyre. Dhuna me bazë gjinore, kryesisht dhuna në familje, është ende e përhapur.
- Gratë shqiptare raportuan siguri më të madhe në qytetin e tyre, në vendin e punës, në rrugë, në objektet arsimore, në transportin publik ose gjatë udhëtimit jashtë vendit. Kjo ndryshon për gratë nga etnitë e tjera, me gratë serbe që ndihen më pak të sigurta në të gjitha vendet e tjera jashtë shtëpive të tyre, ndërsa gratë RAE ndihen më pak të sigurta kur udhëtojnë jashtë vendit.
- Gratë e Kosovës e **perceptojnë luftën dhe sulmet terroriste si kërcënimet më të mëdha për sigurinë e tyre**. Ky perceptim është shumë i lidhur me përvojën e tyre nga konflikti i armatosur. Ajo është gjithashtu më e shprehur në mesin e grave të moshës së mesme që dëshmuar ose u përballën me konfliktin e armatosur të Kosovës në vitet 1998-1999.
- Shumica e respondenteve **(71%) besojnë se gratë duhet të përfaqësohen më mirë në ushtri** dhe afërsisht gjysma (48.10%) janë dakord se pjesëmarrja e grave në sektorin e sigurisë së vendit do të kishte një ndikim në ndjenjën e tyre të sigurisë.

REKOMANDIME

- Vazhdimi i sigurimit të pjesëmarrjes aktive të grave në vendimmarrje dhe udhëheqje për një kontribut më të mirë në zgjidhjen e konflikteve dhe proceset e paqes në mjedise të ndryshme shoqërore.
- Të vazhdohet përmirësimi i përfaqësimit të grave në forcat e armatosura duke zbatuar promovimin në grada përmes një përzgjedhjeje të bazuar në merita.
- Rishikimi i Planit Kombëtar të Veprimit dhe caktimi i një institucioni përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të tij.
- Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave dhe praktikave publike që lidhen me sigurinë, veçanërisht në rishikimin e planeve kombëtare të veprimit.
- Intensifikimi i fushatave ndërgjegjëse në lidhje me të drejtat dhe mundësitë e grave jashtë marrëdhënieve të dhunshme në familje. Ofrimi i informacionit të duhur në lidhje me mbështetjen dhe mbrojtjen e të mbijetuarave të dhunës.
- Krijimi i mekanizmave të duhur të bashkërendimit midis institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e dhunës me bazë gjinore.

8.

SHËNDETI DHE MIRËQENIA E GRAVE

8.1 ÇËSHTJET PERSONALE DHE SHËNDETËSORE

Shëndeti është një fenomen kompleks dhe shumëdimensional që përfshin mirëqenien fizike, njohëse, emocionale dhe sociale (Grad, 2002)²¹, i ndikuar nga kushtet personale dhe shoqërore ose faktorët si: stili i jetës personale dhe familjare, mjedisi, kultura dhe mirëqenia socio-ekonomike, kujdesi personal dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor

Është përgjithësisht e njohur se shëndeti, paqja dhe siguria janë të ndërlidhura, sepse “sëmundjet e shoqëruara me varfëri dhe vështirësi të tjera sociale destabilizojnë qeveritë dhe shoqëritë” dhe “arritja e çdo shteti në promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit është e vlefshme për të gjithë” (Grad, 2002, fq. 898).

